

PHILIPS

AMBILIGHT tv

6951 Series

Manual përdorimi

32PQS6951

Përmbajtja

1 Përmbledhja e Kryefaqes	4	9 Videot, fotografitë dhe muzika	28
2 Merrni mbështetje	5	9.1 Nga një lidhje USB	28
2.1 Identifikimi dhe regjistrimi i televizorit	5	9.2 Nga kompjuteri ose NAS	28
2.2 Ndihma për televizorin dhe manuali i përdorimit	5	9.3 Fotografi	28
2.3 Diagnostikimi i televizorit dhe Vetëdiagnostikimi	5	9.4 Videot	29
2.4 Kujdesi për klientin / Riparimi	6	9.5 Muzikë	29
3 Udhëzuesi i shpejtë	7	9.6 Aplikacioni "Moments"	30
3.1 Telekomanda	7	10 Hapja e menysë së cilësimeve të televizorit	31
3.2 Sensori infrakuq	8	10.1 Menyja e shpejtë dhe Cilësimet e shpeshta	31
3.3 Bateritë dhe pastrimi	8	10.2 Të gjitha cilësimet	31
4 Konfigurimi	10	10.3 Cilësimet Eco	45
4.1 Lexoni udhëzimet mbi sigurinë	10	11 Asistenca	47
4.2 Vendosja televizive	10	11.1 Cilësimet e asistencës	47
4.3 Ndezja e televizorit	10	11.2 Më shumë cilësime aksesi	47
5 Lidhjet	12	12 Smart TV and Aplikacionet	49
5.1 Udhëzuesi i lidhjeve	12	12.1 Konfigurimi i "Smart TV"	49
5.2 Antena	12	12.2 Dyqani i aplikacioneve	49
5.3 Satelit	12	13 "Netflix"	50
5.4 Pajisja e videos	12	14 Amazon Prime Video	51
5.5 Pajisja e zërit	12	15 YouTube	52
5.6 Pajisja celulare	13	16 Alexa	53
5.7 Pajisje të tjera	14	16.1 Rreth "Alexa"	53
5.8 Kompjuteri	15	16.2 Përdorimi i "Alexa"	53
6 Ndërrimi i burimit	16	16.3 Komandat zanore të "Alexa"	53
6.1 Lista e burimeve	16	17 Google Assistant	55
6.2 Riemërtimi i pajisjes	16	18 Softueri	56
7 Kanalet	17	18.1 Përditëso softuerin	56
7.1 Rreth kanaleve dhe ndërrimit të tyre	17	18.2 Versioni i softuerit	56
7.2 Instalimi i kanalit	17	18.3 Përditësimi automatik i softuerit	56
7.3 Lista e kanaleve	23	18.4 Shfaqja e historikut të përditësimeve të softuerit	56
7.4 Kanalet e preferuara	24	19 Mjedisore	58
7.5 Teleteksti	25	19.1 Etiketa evropiane e energjisë	58
7.6 Kanalet e transmetimit	26	19.2 Numri i regjistrimit i EPREL	58
8 Guida televizive	27		
8.1 Çfarë ju duhet	27		
8.2 Përdorimi i guidës televizive	27		

19.3 Fundi i përdorimit	58
20 Specifikimet	59
20.1 Energjia	59
20.2 Marrja	59
20.3 Rezolucioni i ekranit	59
20.4 Rezolucioni i mbështetur i hyrjes	59
20.5 Tingulli	59
20.6 Multimedia	59
20.7 Lidhja	60
21 Diagnostikimi	61
21.1 Këshilla	61
21.2 Aktivizimi	61
21.3 Telekomanda	61
21.4 Kanalet	61
21.5 Satelit	62
21.6 Figura	62
21.7 Tingulli	63
21.8 HDMI	64
21.9 USB	64
21.10 Wi-Fi dhe Internet	64
21.11 Gjuhë e gabuar e menysë	64
22 Siguria dhe kujdesi	65
22.1 Siguria	65
22.2 Kujdesi për ekranin	66
23 Kushtet e përdorimit	67
24 Të drejtat e autorit	69
24.1 HDMI	69
24.2 HEVC Advance	69
24.3 Dolby Audio	69
24.4 Wi-Fi Alliance	69
24.5 Markat e tjera tregtare	69
25 Burim i hapur	70
25.1 Softueri me burim të hapur	70
25.2 Licenca e burimit të hapur	70
26 Mohim në lidhje me shërbimet dhe/ose softuerët e ofruar nga palët e treta	74
Tregues	75

1. Përmbledhja e Kryefaqes

Për të shfrytëzuar "Televizorin Inteligent", lidhni televizorin me internetin. Shtypni **🏠 (Home)** në telekomandë për të hapur Kryefaqen. Si në një celular inteligjent ose në një tabletë, "Kryefaqja" është qendra e televizorit. Nga faqja kryesore mund të vendosni se çfarë të shihni duke shfletuar opsionet e argëtimit nga aplikacionet.

Faqja kryesore është e organizuar në rreshta që të mundëson të zbulosh përmbajtje të shkëlqyera nga aplikacionet e tua të preferuara. Aplikacionet mund ta plotësojnë rekomandimin e tyre (nëse ka) sipas zgjedhjes së tyre, si rresht individual në faqen kryesore.

Spikatjet në faqen kryesore

Me disa skeda si **Kreu**, **Kanale/Falas***, **Aplikacionet** dhe **🔍 Kërko**, mund të zbuloni filma dhe shfaqje nga shërbimet dhe aplikacionet e njohura. Skeda **Kanalet/Falas** është një koleksion përmbajtjesh që ofrohen falas online, duke përfshirë lajme, shfaqje televizive dhe filma, stile jetese, argëtim, sporte, muzikë, kanale për fëmijë dhe komedi. Skeda **Aplikacionet** është një koleksion aplikacionesh që ju lejon të merrni me qira filma në internet, të lexoni gazeta, të shikoni video dhe të dëgjoni muzikë, si dhe të bëni pazar në internet apo të shikoni programe televizive kur të dëshironi me "Televizorin në internet". Ju gjithashtu mund të aktivizoni fushën e hyrjes për të kërkuar me skedën **🔍 Kërko**.

* Skeda **Falas** është e vlefshme vetëm për disa vende të caktuara.

Aplikacionet e preferuara

Aplikacionet e preferuara ndodhen në rreshtin e parë. Ky rresht përmban një numër aplikacionesh të instaluar paraprakisht. Renditja e këtyre aplikacioneve është sipas marrëveshjeve të biznesit me ofruesit e shërbimit të përmbajtjeve. Në këtë rresht do të gjeni edhe aplikacionet për televizor, si p.sh **Watch TV**, **Shfletuesi i Internetit**, **Media** dhe të tjera.

YouTube dhe Netflix

Ky rresht përmban videot tuaja të rekomanduara, abonimet ose ato në tendencë në YouTube dhe Netflix.

Hapni cilësimet nga "Kryefaqja"

Menynë Të gjitha cilësimet mund ta hapni nëpërmjet ikonës në skajin e sipërm djathtas. Ju mund të gjeni gjithashtu **Cilësimet e shpeshta** dhe **Menynë e shpejtë** me cilësime të zakonshme në menynë e televizorit "Philips", të cilat mund të aksesohen drejtpërdrejt nga telekomanda.

Guida televizive

Zgjidhni **Guida televizive** për të hapur guidën televizive të kanaleve të instaluar televizive.

Burimet

Zgjidhni **📺 SOURCES** për të parë dhe kaluar te burimet e disponueshme në këtë televizor.

Shënim:

- Nëse shteti juaj i instaluar është Gjermania, do të ketë skedë shtesë **Vlera publike** e kryefaqja për të listuar **Aplikacionet** e spikatura.
- Nëse vendi juaj i instaluar është MB, do të ketë skedë shtesë **Guide TV** në ekranin bazë për të lidhur Udhëzuesin TV të kanaleve televizive të instaluar.

2. Merrni mbështetje

2.1. Identifikimi dhe regjistrimi i televizorit

Identifikoni televizorin - modelin e televizorit dhe numrin e serisë

Mund t'ju kërkohet të jepni numrin e modelit dhe numrin e serisë së televizorit. Këta numra gjenden në etiketën e paketimit ose në etiketën e llojit, e cila ndodhet në pjesën e pasme ose të poshtme të televizorit.

Regjistrimi i televizorit

Regjistrojeni televizorin dhe shijoni një sërë përfitimesh, duke përfshirë mbështetje të plotë (duke përfshirë ngarkimet), hyrje të privilegjuar në informacionet mbi produktet e reja, uljet e çmimeve dhe ofertat ekskluzive, mundësinë për të fituar çmime, madje dhe për të marrë pjesë në anketime të posaçme për produktet e reja.

Shkoni te www.philips.com/tvsupport

2.2. Ndhimja për televizorin dhe manuali i përdorimit

☰ Menyja e shpejtë > Ndhimja

Mund të përdorni funksionin "Ndhimë" për të diagnostikuar dhe për të marrë më shumë informacione rreth televizorit.

- **Informacioni i televizorit** - Shikoni emrin e modelit, numrin e serisë, versionin e softuerit dhe orët e funksionimit të televizorit tuaj.
- **Udhëzime për** - Mund të shihni udhëzime për instalimin e kanaleve, renditjen e kanaleve*, përditësimin e softuerit të televizorit, lidhjen e pajisjeve të jashtme dhe përdorimin e funksioneve inteligjente në televizor.
- **Diagnostikimi i televizorit** - Ekzekutoni diagnostikimin e televizorit për të kontrolluar gjendjen e tij.
- **Vetëdiagnostikim** - Mund të kontrolloni nëse figura, zëri, rrjeti dhe cilësimet e tjera po funksionojnë si duhet.
- **Përditësimi i softuerit** - Kontrolloni për përditësime të disponueshme të softuerit.
- **Manuali i përdorimit** - Lexoni manualin e përdorimit për informacion rreth televizorit.
- **Diagnostikimi** - Gjeneroni një zgjidhje për pyetjet e shpeshta.
- **Cilësimet e fabrikës** - Rivendosni të gjitha cilësimet

në vlerat e fabrikës.

- **Instalo sërish TV** - Kryeni sërish instalimin e plotë të televizorit.
- **Informacioni i kontaktit** - Shfaqni numrin e telefonit ose adresën e internetit për shtetin apo rajonin ku ndodhni.

* Renditja e kanaleve është e zbatueshme vetëm për disa shtete.

** Cilësimi "Ambilight" ofrohet vetëm për modelet që mbështesin funksionin "Ambilight".

2.3. Diagnostikimi i televizorit dhe Vetëdiagnostikimi

Diagnostikimi i televizorit

Ju mund të ekzekutoni diagnostikimin e televizorit për të kontrolluar gjendjen e tij. Në përfundim të diagnostikimit, televizori pastron memorien e përkohshme dhe mbyll aplikacionet e papërdorura për të vazhduar me funksionimin e butë të tij.

Për të ekzekutuar testin diagnostikues të televizorit:

- 1 - Zgjidhni ☰ **Menyja e shpejtë** > **Ndhimja** > **Diagnostikimi i televizorit** dhe shtypni **OK**.
- 2 - Zgjidhni **Fillo** për të ekzekutuar një seri testesh diagnostikuese.
- 3 - Kur testimi të përfundojë, mund të shihni statusin e pikave të mëposhtme.
 - Energjia
 - Figura
 - Zëri
 - Lidhni pajisjet e jashtme
 - Rrjeti
 - Sintonizuesi
 - Pastrimi i memories së përkohshme
 - Aplikacionet
- 4 - Zgjidhni **OK** për ta mbyllur faqen e rezultateve dhe për t'u kthyer tek eksperti **Diagnostikimi i televizorit**.
- 5 - Shtypni ← **Kthehu** për të dalë nga **Diagnostikimi i televizorit**, zgjidhni **Vetëdiagnostikimi** për të bërë kontrolle të tjera diagnostikuese, zgjidhni **Shiko rezultatet** për të parë sërish faqen e rezultateve.

Vetëdiagnostikimi

Vetëdiagnostikimi ju ndihmon të zgjidhni vetë problemet me televizorin duke kontrolluar konfigurimet e televizorit.

Për të ekzekutuar vetëdiagnostikimin:

- 1 - Zgjidhni ☰ **Menyja e shpejtë** > **Ndhimja** > **Vetëdiagnostikim** dhe shtypni **OK**.
- 2 - Zgjidhni pikat e mëposhtme për të kontrolluar konfigurimet.

- **Kontrollo televizorin** – Mund të kontrolloni nëse figura, zëri dhe cilësimet e tjera po funksionojnë si duhet.
 - **Kontrollo rrjetin** – Kontrolloni lidhjen me rrjetin.
 - **Kontrollo telekomandën** – Kryeni testin për të verifikuar funksionalitetin e telekomandës së pajisur me televizorin.
 - **Shfaq historikun për sinjalin e dobët** – Shfaqni listën e numrave të kanaleve që janë ruajtur automatikisht kur sinjali kishte fuqi të dobët.
-

2.4. Kujdesi për klientin / Riparimi

Për mbështetjen dhe riparimin e televizorit, telefononi kujdesin për klientin në vendin tuaj. Teknikët tanë të shërbimit do të kujdesen për riparimin, nëse nevojitet.

Gjeni numrin e telefonit të printuar në dokumentacionin e pajisur me televizorin.

Ose konsultohuni me faqen tonë të internetit www.philips.com/tvsupport dhe zgjidhni shtetin nëse nevojitet.

Numri i modelit dhe numri i serisë i televizorit

Mund t'ju kërkohet të jepni numrin e modelit dhe numrin e serisë së televizorit. Gjejini këta numra në etiketën e paketimit ose në etiketën e llojit në pjesën e pasme ose të poshtme të televizorit.

▲ Paralajmërim

Mos u përpiq ta riparosh vetë televizorin. Kjo mund të shkaktojë lëndime të rënda, dëmtime të pariparueshme në televizor ose mund të zhvlerësojë garancinë.

3. Udhëzuesi i shpejtë

3.1. Telekomanda

Përmbledhje e tasteve

Pjesa e sipërme

Veçoria e butonave të fshehur

Duke shtypur butonin 123, do të shfaqen butonat e fshehur për të mundësuar më shumë funksione kontrolli. Butoni 123 në mes të telekomandës përdoret për të aktivizuar/çaktivizuar modalitetin e butonave të fshehur. Kur modaliteti i butonave të fshehur aktivizohet, butonat me numra 0 deri në 9 dhe butonat e kontrollit të luajtjes së medias do të shfaqen me dritë në sfond dhe do të aktivizojnë funksionet. Kur modaliteti i butonave të fshehur çaktivizohet duke shtypur përsëri butonin 123 ose kur çaktivizohet automatikisht, telekomanda punon me butonat normalë.

⚠ Paralajmërim

Rrezik mbytjeje! Kjo telekomandë televizori përmban pjesë të vogla që nuk janë të përshtatshme për fëmijë më të vegjël se 5 vjeç.



1 - (Gjendje pritjeje / Aktiv)
Për të ndezur televizorin ose për ta kthyer në gjendje pritjeje.

2 - **AMBILIGHT**
Për të zgjedhur një nga stilet Ambilight.
* Cilësimi Ambilight ofrohet vetëm për modelet që mbështesin funksionin Ambilight.

3 - (SOURCES)
Për të hapur ose mbyllur menynë "Burimet".

4 - (Menyja e shpejtë/MENYJA)

Për të hapur Menynë e shpejtë me funksionet e zakonshme të televizorit.

5 - (Kërko)

- Për të hapur skedën Kërko në ekranin Kreu.
- Për të nisur ndërfaqen e kërkimit për disa nga aplikacionet e mbështetura.

Mesatar



1 - Guida televizive

Për të hapur ose mbyllur guidën televizive.

2 - Tasti OK

Për të konfirmuar zgjedhjen ose cilësimin. Për hapjen e listës së kanaleve ndërsa jeni duke parë televizor.

3 - Tastet me shigjeta / të navigimit

Për të lëvizur lart, poshtë, majtas ose djathtas.

4 - OPSIONET

Për të hapur ose mbyllur menynë e opsioneve.

5 - (Pas)

Për t'u kthyer te kanali i mëparshëm i zgjedhur.

Për t'u kthyer te menyja e mëparshme.

Për t'u kthyer te faqja e mëparshme e aplikacionit/internetit.

6 - Volumi / (Hiq zërin)

Lëvizni poshtë ose lart për të rregulluar nivelin e volumit. Shtypni butonin në mes për të hequr zërin ose për ta rikthyer atë.

7 - Tasti 123

Për të aktivizuar ose çaktivizuar tastet e funksioneve të fshehura dhe për të ndryshuar tastet midis grupeve të ndryshme të veprimeve.

8 - INFO

Për të hapur ose mbyllur informacionet mbi programin.

9 - Tastet me numra (taste të fshehura, të

disponueshme pasi shtypet tasti 123)
Për të zgjedhur direkt një kanal.

10 - SUBTITLE

Për të hapur faqen e titrave. Mbani shtypur për të hapur ose mbyllur funksionin Teletekst.

11 - TV / DIL

Për t'u kthyer te shikimi i televizorit ose për të ndaluar një aplikacion interaktiv televizori. Megjithatë, mund të mos funksionojë në disa aplikacione; kjo varet nga aplikacionet televizive të palëve të treta.

Ky buton do të ndryshohet në butonin numerik 0 pasi të shtypet butoni 123.

12 - 🏠 Home

Për të hapur menyë kryesore.

13 - ☰ (Kanali)

Lëvizni poshtë ose lart për të kaluar te kanali vijues ose i mëparshëm në listën e kanaleve. Për të hapur faqen vijuese ose të mëparshme tek Teksti/Teleteksti. Shtypni butonin në mes për të hapur listën e kanaleve.

Nga poshtë



1 - 🟠 🟢 🟡 🟦 Butonat me ngjyra

Zgjedhje direkte e opsioneve. Shtypni butonin blu 🟦 për të hapur ose mbyllur Ndhim.

2 - NETFLIX

• Nëse keni një abonim anëtarësimi në Netflix, mund të shijoni Netflix në këtë televizor. Televizori duhet të jetë i lidhur me internetin.

• Për të hapur Netflix, shtypni **NETFLIX** për të hapur aplikacionin Netflix. Netflix mund ta hapni menjëherë nga një televizor në pritje.

www.netflix.com

3 - Disney+

Për të hyrë në aplikacionin Disney+.

4 - 🌿 Butoni Eco/I gjelbër

Shtypeni për të aksesuar mesazhin për t'ju kujtuar të hyni në menyë Cilësimet Eco mbajeni shtypur për të aksesuar direkt menyë Cilësimet Eco. Pasi të aktivizohet menya Cilësimet Eco duke mbajtur shtypur disa herë butonin, mesazhi nuk do të shfaqet

më.

5 - Playback (taste të fshehta, disponohen pas shtypjes së 123 key)

- Play ▶, për të luajtur.
- Pauzë ⏸, për ta vënë në pauzë luajtjen
- Pas ⏪, për ta kthyer mbrapsht
- Shpejt përpara ▶▶, për të ecur shpejt përpara

6 - prime video

Për të hapur aplikacionin Amazon prime video.

7 - Channels

Për të hapur aplikacionin Titan Channels.

8 - Butonat e shpejtë

Shtypni butonin e shpejtë për të hapur direkt aplikacionin ose për të nisur transmetimin e medias.

Butonat e shpejtë aktualë variojnë midis rajoneve ose shteteve.

3.2. Sensori infrakuq

Televizori mund të marrë komanda edhe nga një telekomandë që përdor IR (rreze infrakuqe) për të dërguar komanda. Nëse përdorni telekomandë të tillë, sigurohuni gjithmonë që ta drejtoni telekomandën nga sensorin infrakuq në pjesën e përparme të televizorit.



⚠ Parolajmërim

Mos vendosni objekte para sensorit infrakuq të televizorit pasi mund të bllokojë sinjalin.

3.3. Bateritë dhe pastrimi

Ndërrimi i baterive

Për informacion të hollësishëm mbi bateritë e telekomandës, shihni Udhëzuesin e shpejtë në paketimin e produktit.

Nëse televizori nuk reagon ndaj shtypjes së tasteve të

telekomandës, kësaj mund t'i kenë rënë bateritë.

Për të ndërruar bateritë, hapni folenë e baterive në anën e pasme të telekomandës.

1 - Rrëshqitni kapakun e folesë së baterive në drejtimin që tregohet me shigjetë.

2 - Ndërrojini bateritë e vjetra me të reja. Sigurohuni që polet + dhe - të baterive të vendosen siç duhet.

3 - Rivendosni kapakun e folesë së baterive dhe rrëshqiteni në vend derisa të puthitet.

- Përdorni vetëm bateri alkaline LR03.
- Hiqini bateritë nëse nuk e përdorni telekomandën për kohë të gjatë.
- Hidhni bateritë e vjetra sipas udhëzimeve të përfundimit të përdorimit.
- Kontrolloni rregullisht gjendjen e baterive të telekomandës për të parandaluar gërryerjen e kontakteve.

Për më shumë informacion, kontrolloni te **Ndihma > Manuali i përdorimit > Fundi i përdorimit**.

Pastrimi

Telekomanda është e veshur me një shtresë rezistente ndaj gërryerjeve.

Për ta pastruar telekomandën, përdorni një leckë të butë e të lagur. Mos përdorni asnjëherë mbi telekomandë substanca si alkooli, kimikatet ose solucionet pastruese për shtëpinë.

Asnjëherë mos e ekspozoni telekomandën ndaj ujit ose lëngjeve.

4. Konfigurimi

4.1. Lexoni udhëzimet mbi sigurinë


Lexoni udhëzimet mbi sigurinë përpara se të përdorni televizorin.

Për të lexuar udhëzimet, kontrolloni te Ndhima > Manuali i përdorimit > Siguria dhe kujdesi.

4.2. Vendosja televizive

Këshilla mbi vendosjen

- Pozicionojeni televizorin në vende ku drita nuk bie drejtpërdrejt në ekran.
- Errësoni ndriçimin në dhomë për efekt më të mirë të "Ambilight".
- Distanca ideale për të parë televizor është 2 deri në 5 herë sa lartësia e ekranit. Kur jeni të ulur, sytë duhet të jenë në një nivel me mesin e ekranit.
- Distanca e rekomanduar nga muri:
A. Kur montohet në mur, televizori duhet të vendoset 7 deri në 10 cm larg nga muri.
B. Kur televizori të montohet në bazament, televizori duhet të vendoset 10 deri në 20 cm larg nga muri, në varësi të madhësisë së bazamentit.



Shënim:

Mbajeni televizorin larg burimeve që prodhojnë pluhur, si p.sh. sobat. Sugjerohet t'i pastroni rregullisht pluhurat për të shmangur futjen e tij në televizor.

Bazamenti i televizorit

Udhëzimet për montimin e bazamentit të televizorit mund t'i gjeni në udhëzuesin e shpejtë që vjen me televizorin. Në rast se ju ka humbur ky udhëzues, mund ta shkarkoni nga www.philips.com/tvsupport.


Përdorni numrin e modelit të televizorit për të kërkuar e shkarkuar Udhëzuesin e shpejtë.

Montimi në mur

Televizori është gjithashtu i përgatitur për suport muri (shitet veçmas).

Madhësia e suportit të murit mund të ndryshojë në varësi të llojeve të ndryshme të mbështetësve së prapme, shihni Udhëzuesin e shpejtë në paketimin e produktit për të parë madhësinë që i përkon televizorit tuaj.

Përdor përmasat e mëposhtme të suportit të murit kur blen një suport muri.



- 32PQS69x1
100x200, M6 (min.: 8 mm, max: 10 mm)
- 40PQS69x1
100x200, M6 (min.: 8 mm, max: 10 mm)


Kujdes

Montimi i televizorit në mur kërkon ekspertizë dhe duhet të kryhet vetëm nga personeli i kualifikuar. Montimi i televizorit në mur duhet të përmbushë standardet e sigurisë sipas peshës së televizorit. Gjithashtu, lexoni masat paraprake të sigurisë para pozicionimit të televizorit. "TP Vision Europe B.V." nuk mban përgjegjësi për montimin e pasaktë apo montime të tjera që mund të shkaktojnë aksident ose lëndim.

4.3. Ndezja e televizorit

Lidhja e kordonit elektrik

- Sigurohuni që mund ta arrini gjithmonë spinën te priza në mur.
- Kur hiqni kordonin nga priza, tërhiqni gjithmonë spinën dhe asnjëherë kordonin.




Edhe pse televizori ka konsum shumë të ulët energjie gjatë qëndrimit në pritje, hiqeni nga priza për të kursyer energji nëse nuk e përdorni për kohë të gjata.

Aktiv ose në pritje


Përpara se të ndizni televizorin, sigurohuni që të lidhni rrjetin elektrik në fletën **POWER** në pjesën e pasme të televizorit.

Aktivizimi

Shtypni tastin e vogël të levës në pjesën e poshtme të televizorit.



Kalimi në modalitet pritjeje

Për ta kaluar televizorin në pritje, shtypni  në telekomandë. Gjithashtu, mund të shtypni tastin e vogël të levës në pjesën e poshtme të televizorit.

Në modalitetin e pritjes, televizori është ende i lidhur me rrjetin elektrik, por konsumon shumë pak energji.

Për ta fikur plotësisht televizorin, shkëputni spinën. Gjatë shkëputjes së prizës, tërhiqni gjithmonë spinën dhe asnjëherë kordonin. Sigurohuni që të mund ta arrini gjithmonë spinën, kordonin elektrik dhe prizën.

5. Lidhjet

5.1. Udhëzuesi i lidhjeve

Gjithmonë lidhni pajisjen me televizorin me lidhjen më cilësore të mundshme. Gjithashtu, përdorni kablllo të cilësisë së lartë për të garantuar transferim të mirë të figurës dhe zërit.

Kur lidhni një pajisje, televizori njuh llojin e saj dhe i jep secilës pajisje një emër të saktë të llojit. Nëse dëshironi mund ta ndryshoni emrin e pajisjes. Nëse pajisjes i caktohet emri i duhur i llojit, televizori kalon automatikisht në cilësimet e tij ideale kur kaloni te kjo pajisje në menyne "Burimet".

5.2. Antena

Futeni mirë fishën e antenës në folenë Antena në pjesën e pasme të televizorit.

Mund të lidhni antenën tuaj ose sinjalin e antenës nga një sistem shpërndarjeje të sinjalit të antenës. Përdorni fole antene RF IEC për koaksial 75 om.

Përdoreni këtë lidhje antene për sinjale hyrëse DVB-T dhe DVB-C.



5.3. Satelit

Lidhni fishën satelitore tip "F" me folenë satelitore SAT në pjesën e pasme të televizorit.




5.4. Pajisja e videos

HDMI

Lidhja HDMI siguron cilësinë më të mirë të figurës dhe zërit.

Për cilësinë më të mirë të transmetimit të sinjalit, përdorni kablllo HDMI të certifikuar me shpejtësi ultra të lartë. Mos përdorni kablllo HDMI më të gjatë se 5 m. Pajisjet që përdorin sinjalet HDR mund të lidhen me çdo hyrje HDMI.



Mbrojtja nga kopjimi

Foletë HDMI mbështesin HDCP (mbrojtje e materialeve dixhitale të shpejtësisë së lartë). HDCP është një sinjal i mbrojtjes nga kopjimi që parandalon kopjimin e materialeve nga disku DVD ose disku Blu-ray. Përmendet gjithashtu edhe si DRM (menaxhim i të drejtave dixhitale).

5.5. Pajisja e zërit

HDMI ARC

HDMI ARC (Audio Return Channel; kanali i kthimit të zërit) ka vetëm HDMI 1 në televizor.


Nëse edhe pajisja, zakonisht sistem kinemaje (HTS), ka lidhje "HDMI ARC", lidheni me ndonjë nga lidhjet HDMI në televizor. Me lidhjen "HDMI ARC" nuk është e nevojshme të lidhni kablo shtesë audioje që dërgon zërin e figurës së televizorit drejt sistemit të kinemasë. Lidhja "HDMI ARC" i kombinon të dy sinjalet.



Dalja e zërit dixhital - Optike

Dalja e audios - Optike është lidhje zëri e cilësisë së lartë.

Kjo lidhje optike mund të transmetojë audio 5.1-kanalësh. Nëse pajisja juaj, zakonisht sistemi i kinemasë (HTS), nuk ka lidhje HDMI ARC, mund ta përdorni këtë lidhje me lidhjen Dalja e audios - Optike në HTS. Lidhja Dalja e audios - Optike e dërgon zërin nga televizori në HTS.



Kufjet

Mund të lidhni një palë kufje në lidhjen në pjesën anësore të televizorit. Lidhja është minifole 3,5 mm. Volumin e kufjeve mund ta rregulloni veçmas.



5.6. Pajisja celulare

Transmetoni në televizor

Për të transmetuar përmbajtje të transmetimit në televizorin tuaj:

- 1 - Sigurohuni që pajisja juaj celulare dhe televizori të jenë në të njëjtin rrjet Wi-Fi.
- 2 - Hapni një aplikacion të aktivizuar për transmetim në pajisjen tuaj celulare dhe prekni ikonën e transmetimit.
- 3 - Zgjidhni PHILIPS_TV_(ModelName) të televizorit tuaj për të filluar transmetimin.

Aplikacioni Philips Smart TV

Aplikacioni Philips Smart TV në smartfonin ose tabletin tuaj është miku juaj i ri i televizorit. Aplikacioni ju mundëson ndërrimin e kanaleve dhe rregullimin e volumit, si një telekomandë.

Shkarkojeni sot aplikacionin Philips Smart TV nga dyqani juaj i preferuar i aplikacioneve.

Aplikacioni Philips Smart TV ofrohet për sistemet iOS dhe Android dhe është pa pagesë.

Përndryshe, mund të shkoni te **🏠 (Kreu) > Cilësimet > Lidhjet me valë dhe rrjetet > Me tel ose Wi-Fi > Kodi QR** i aplikacionit Remote dhe të shtypni OK; në ekranin e televizorit do të shfaqet një kod QR. Skanoni kodin QR me pajisjen tuaj celulare dhe ndiqni udhëzimin për të shkarkuar dhe instaluar aplikacionin Philips Smart TV. Kur përdorni aplikacionin, pajisja celulare dhe televizori Philips duhet të lidhen me të njëjtin rrjet Wi-Fi.

Get Connected



www.philips.to/smartTV

The Philips Smart TV app lets you switch channels and adjust the volume - just like a remote control.

5.7. Pajisje të tjera

Moduli CAM me kartë "Smart" - CI+

Rreth CI+

Televizori është gati për modulën e hyrjes së kushtëzuar CI+.

Me CI+ mund të shikoni programe HD me pagesë, si p.sh. filma dhe sport, të cilat ofrohen nga operatorët televizivë dixhitalë në rajonin tuaj. Këto programe kodohen nga operatori televiziv dhe dekodohen me një modul të parapaguar CI+.

Kur abonoheni për programet e tyre me pagesë, operatorët televizivë dixhitalë ofrojnë modulën CI+ (moduli me hyrje të kushtëzuar - CAM) dhe një kartë shoqëruese "Smart". Këto programe kanë nivel të lartë mbrojtjeje nga kopjimi.

Kontaktoni operatorin televiziv dixhital për më tepër informacion mbi kushtet.



Kartë "Smart"

Kur abonoheni për programet e tyre me pagesë, operatorët televizivë dixhitalë ofrojnë modulën CI+ (moduli me hyrje të kushtëzuar - CAM) dhe një kartë shoqëruese "Smart".


Futni kartën "Smart" në modulën CAM. Shihni udhëzimet e marra nga operatori.

Për të futur CAM në televizor...

1. Shihni në modulën CAM për mënyrën e saktë të futjes. Futja e pasaktë mund ta dëmtojë modulën CAM dhe televizorin.
2. Ndërsa shihni në pjesën e pasme të televizorit, me modulën CAM të drejtuar nga vetja, futeni me kujdes në folenë **COMMON INTERFACE**.
3. Shtyjeni modulën CAM deri në fund. Lëreni gjithnjë në fole.

Kur ndizni televizorin, mund të duhet pak kohë për aktivizimin e modulit CAM. Nëse keni futur modulën CAM dhe keni paguar tarifat e abonimit (format e abonimit mund të ndryshojnë), mund t'i shikoni kanalet e koduara që mbështeten nga karta "Smart" e modulit CAM.

Moduli CAM dhe karta "Smart" janë ekskluzivisht për televizorin tuaj. Nëse e hiqni modulën "CAM", nuk do të mund t'i shikoni më kanalet e koduara të mbështetura nga moduli CAM.



Vendosja e fjalëkalimeve dhe i kodeve PIN

Për disa module CAM duhet të jepni një kod PIN për t'i parë kanalet. Kur caktoni kodin PIN për modulën CAM, ju rekomandojmë të përdorni të njëjtin kod që përdorni për kyçjen e televizorit.

Për të vendosur kodin PIN për CAM...


1. Shtypni **SOURCES**.
2. Zgjidhni llojin e kanalit për të cilin po përdorni modulën CAM.
3. Shtypni **OPSIONET** dhe zgjidhni **Ndërfaqja e përbashkët**.
4. Zgjidhni operatorin e televizorit të modulit CAM. Ekranet vijuese shfaqen nga operatori televiziv.


Ndiqni udhëzimet në ekran për të kërkuar cilësimin e kodit PIN.

Pajisja ruajtëse USB

Mund t'i shikoni fotot dhe të luani muzikën dhe videot tuaja nga njësia e lidhur "Flash USB". Futni një njësi "Flash USB" në njërën nga lidhjet USB në televizor ndërkohë që ky është ndezur.

Televizori dikton njësinë Flash dhe hap një listë që tregon përmbajtjen e saj.

Nëse lista e përmbajtjes nuk shfaqet automatikisht, shtypni  SOURCES dhe zgjidhni USB.





Për më shumë informacion mbi shikimin ose luajtjen e përmbajtjeve nga një njësi flash USB, kontrolloni te Ndhma > Manuali i përdorimit > Fotot, videot dhe muzika.

5.8. Kompjuteri


Mund ta lidhni kompjuterin me televizorin dhe ta përdorni këtë të fundit si monitor kompjuteri. Përdorni kabllo HDMI për të lidhur kompjuterin me televizorin.

6. Ndërrimi i burimit

6.1. Lista e burimeve

- Për të hapur menynë "Burimet", shtypni  SOURCES.
 - Për të kaluar në një pajisje të lidhur, zgjidhni pajisjen me tastet **Shigjeta / navigimi** dhe shtypni **OK**.
 - Për të shfaqur të dhënat teknike të pajisjes së lidhur që po shikoni, shtypni **OPTIONS** dhe zgjidhni **Informacionin e pajisjes**.
 - Për të mbyllur menynë "Burimet" pa kaluar te një pajisje, shtypni sërish  SOURCES.
-

6.2. Riemërtimi i pajisjes

 (Kryefaqja) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Modifiko burimet e hyrjes > Burimi

- 1 - Zgjidhni një nga ikonat e pajisjeve, emri i paracaktuar shfaqet në fushën e shkrimit dhe zgjidhni.
- 2 - Zgjidhni **Riemërto** për të hapur tastierën në ekran.
- 3 - Përdorni butonat e navigimit për të zgjedhur karakteret.
- 4 - Zgjidhni **Mbyll** kur të përfundoni modifikimin.


7. Kanalet



7.1. Rreth kanaleve dhe ndërrimit të tyre

Shikimi i kanaleve televizive


• Shtypni TV / DIL. Televizori sintonizohet në kanalën e fundit që keni parë.

.

Shtypni  (Kryefaqa) > Televizori > Kanalet dhe shtypni OK.

• Shtypni  + ose  - për të ndërruar kanalet.

• Nëse e dini numrin e kanalit, shkruajeni me tastet numerike. Për ta ndërruar kanalën, shtypni OK pasi të keni shkruar numrin.



• Për t'u rikthyer te kanali ku ishit sintonizuar më parë, shtypni  Kthehu .

Për të kaluar në një kanal nga lista e kanaleve

• Ndërkohë që shikoni një kanal televiziv, shtypni OK për të hapur listën e kanaleve.


• Lista e kanaleve mund të ketë disa faqe me kanale.

Për të parë faqen pasardhëse apo të mëparshme,

shtypni  + ose  -.

• Për të mbyllur listat e kanaleve pa ndërruar kanalet, shtypni  Pas ose TV / DIL.

Ikonat e kanaleve

Pas një përditësimi automatik të kanaleve në listën e kanaleve, kanalet e gjetura rishtas shënohen me një  (yll).

Nëse kyçni një kanal, ai do të shënohet me

një  (kyç).

Kanalet radiofonike

Nëse ka transmetim dixhital, stacionet dixhitale radiofonike instalohen gjatë instalimit. Kaloni në një kanal radioje njëlloj si me kanalet televizive.

Ky televizor mund të marrë sinjal standard dixhital televiziv DVB. Televizori mund të mos funksionojë siç duhet me disa operatorë televizionesh dixhitale që nuk pajtohen plotësisht me specifikimet e standardit.


7.2. Instalimi i kanalit

Antena dhe kabllori

Kërkimi manual për kanale dhe cilësimet e tyre

Kërkimi për kanale

Përditëso kanalet

 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Instalimi i antenës/kabllorit* > Kërko për kanale

1 - Zgjidhni Përditëso kanalet dixhitale për të shtuar vetëm kanale të reja dixhitale.

2 - Shtypni OK për të kërkuar kanale. Kjo mund të zgjasë disa minuta.

Riinstalim i shpejtë

 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Instalimi i antenës/kabllorit* > Kërko për kanale

1 - Zgjidhni Riinstalim i shpejtë ose Riinstalim i kanaleve (nëse cilësimi i shtetit është Mbretëri e Bashkuar) për të instaluar sërish të gjitha kanalet me cilësimet standarde.

2 - Shtypni OK për të kërkuar kanale. Kjo mund të zgjasë disa minuta.

Riinstalim i avancuar i kanaleve


 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Instalimi i antenës/kabllorit* > Kërko për kanale

1 - Zgjidhni Riinstalim i avancuar i kanaleve ose Konfigurimi i aplikacionit Freely (nëse cilësimi i shtetit është Mbretëri e Bashkuar) për të kryer një riinstalim të plotë hap pas hapi.

2 - Shtypni OK për të kërkuar kanale. Kjo mund të zgjasë disa minuta.

* Shënim: Nëse cilësimi i shtetit është Mbretëri e Bashkuar, disponohet vetëm Instalimi i antenës.

Cilësimet e kanaleve

 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Instalimi i antenës/kabllorit > Search for channels > Riinstalim i avancuar i kanaleve



1 - Zgjidhni Riinstalim i avancuar i kanaleve për të kryer një riinstalim të plotë hap pas hapi.

2

- Zgjidhni Antena (DVB-T) ose Kabllori (DVB-C) , dhe zgjidhni një artikull që duhet të riinstaloni.

3 - Zgjidhni Kanalet dixhitale dhe* analoge, Vetëm kanalet dixhitale ose Vetëm kanalet analoge.

4 - Zgjidhni Cilësimet dhe shtypni OK.

5 - Shtypni  Rivendosje për t'i rivendosur, ose shtypni  Fund pasi të keni përfunduar cilësimet.

* Shënim: Mbështetja e kanaleve analoge nuk ofrohet për vendet që e kanë përfunduar çaktivizimin e kanaleve analoge.

Kërkimi për frekuenca

Zgjidhni mënyrën e kërkimit për kanale.

• **I shpejtë:** zgjidhni metodën më të shpejtë dhe përdorni cilësimet e paracaktuara siç përdoren nga shumica e operatorëve kabllorë në shtetin tuaj.
• **Kërkim i plotë:** Nëse kjo mënyrë nuk jep kanale të instaluar ose nëse mungojnë disa kanale, mund të zgjidhni mënyrën e zgjeruar **Kërkim i plotë**. Kjo mënyrë kërkon më shumë kohë për kërkimin dhe instalimin e kanaleve.

• **I avancuar:** Nëse keni marrë një vlerë specifike të frekuencës së rrjetit për kërkimin e kanaleve, zgjidhni **I avancuar**.

Madhësia e shkallës të frekuencës

Televizori kërkon kanale në shkallë prej **8MHz**. Nëse kjo nuk jep kanale të instaluar ose nëse mungojnë disa kanale, mund të kërkoni në një shkallë më të vogël prej **1MHz**. Përdorimi i shkallës 1 MHz do të marrë më shumë kohë për kërkimin dhe instalimin e kanaleve.

Frekuenca e rrjetit

Nëse për kërkimin e kanaleve synoni të përdorni metodën **Kërkim i shpejtë** të **Kërkimi i frekuencave**, zgjidhni opsionin **Automatik**. Televizori do të përdorë 1 nga frekuencat e paracaktuara të rrjetit (ose HC - kanal lokalizues) që përdoret nga shumica e operatorëve kabllorë në shtetin tuaj. Nëse keni marrë një vlerë specifike të frekuencës së rrjetit për kërkimin e kanaleve, zgjidhni **Manual**.

Frekuenca e rrjetit

Me modalitetin **Frekuenca e rrjetit** të caktuar në **Manual**, mund ta jepni këtu vlerën e frekuencës së rrjetit që morët nga operatori. Për të dhënë vlerën, përdorni tastet me ngjyrë.

ID e rrjetit

Jepni ID-në e rrjetit që ju është dhënë nga operatori juaj kabllor.

Modaliteti i shpejtësisë së modulimit

Nëse operatori kabllor nuk ju ka dhënë një vlerë specifike të shpejtësisë së modulimit për të instaluar kanalet televizive, lëreni cilësimin e modalitetit të shpejtësisë së modulimit në **Automatik**. Nëse keni marrë një vlerë specifike të shpejtësisë së modulimit, zgjidhni **Manual**.

Shpejtësia e modulimit

Me **Modaliteti i shpejtësisë së modulimit** të caktuar në **Manual**, mund të jepni shpejtësinë e modulimit nëpërmjet tasteve numerike.

Të hapura / të koduara

Nëse keni pajtim dhe modul CAM - modul me hyrje të kushtëzuar për shërbimet televizive me pagesë, zgjidhni **Të hapura + të koduara**. Nëse nuk keni pajtim për shërbime dhe kanale me pagesë, mund të zgjidhni **Vetëm kanalet e hapura**.

Kërkimi automatik i kanaleve

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Instalimi i antenës/kabllorit > Përditësimi automatik i kanaleve

Nëse merrni kanale dixhitale, mund ta caktoni televizorin që ta përditësojë automatikisht listën me kanalet e reja.

Përndryshe, mund ta bëni vetë.

Përditësimi automatik i kanaleve

Televizori i përditëson kanalet një herë në ditë, në orën 06:00 dhe ruan kanalet e reja. Kanalet e reja ruhen në listën "Të gjitha kanalet", por edhe në listën "Kanalet e reja". Kanalet boshe do të hiqen. Me ndezjen e televizorit shfaqet një mesazh nëse gjenden kanale të reja ose nëse kanalet janë përditësuar ose hequr. Për të bërë përditësimin automatik të kanaleve, televizori duhet të jetë në modalitet pritjeje.

Mesazhi i përditësimit të kanaleve

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Instalimi i antenës/kabllorit > Mesazhi i përditësimit të kanaleve

Me ndezjen e televizorit shfaqet një mesazh nëse gjenden kanale të reja ose nëse kanalet janë përditësuar ose hequr. Për të shmangur shfaqjen e këtij mesazhi pas çdo përditësimi të kanaleve, mund ta çaktivizoni.

Dixhital: Testi i marrjes

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Instalimi i antenës/kabllorit > Dixhital testi i marrjes

Shfaqet frekuenca dixhitale për këtë kanal. Nëse marrja është e dobët, mund ta ripoziciononi antenën. Për të kontrolluar sërish cilësinë e sinjalit të kësaj frekuence, zgjidhni **Kërkim** dhe shtypni **OK**. Për të dhënë manualisht një frekuencë specifike, përdorni tastet numerike të telekomandës. Përndryshe, zgjidhni frekuencën, pozicionojini shigjetat mbi një numër me **<** dhe **>** dhe ndryshojeni shifrën me **▲** dhe **▼**. Për të verifikuar frekuencën, zgjidhni **Kërkim** dhe shtypni **OK**.

Analog: Instalim manual

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Instalimi i antenës/kabllorit > Instalimi manual analog

Kanalet analoge televizive mund të instalohen manualisht, kanal pas kanali.

• Sistemi

Për të konfiguruar sistemin e televizorit,

zgjidhni Sistemi.

• Kërkimi për kanal

Për të gjetur një kanal, zgjidhni **Kërkimi për kanal** dhe shtypni **OK**. Mund të jepni vetë një frekuencë për të gjetur një kanal ose të lini ta kërkojë televizori. Shtypni **OK**, zgjidhni **Kërkim** dhe shtypni **OK** për të kërkuar automatikisht një kanal. Kanali i gjetur do të shfaqet në ekran dhe nëse marrja është e dobët, shtypni sërish **Kërkim**. Nëse dëshironi ta ruani kanalin, zgjidhni **Fund** dhe shtypni **OK**.

• Sintonizimi

Për të sintonizuar një kanal, zgjidhni **Sintonizimi** dhe shtypni **OK**. Mund të sintonizoni kanalin me **▲** ose **▼**. Nëse dëshironi ta ruani kanalin e gjetur, zgjidhni **Fund** dhe shtypni **OK**.

• Ruajtja

Kanalin mund ta ruani në numrin aktual të kanalit ose në një numër të ri. Zgjidhni **Ruajtja** dhe shtypni **OK**. Numri i kanalit të ri do të shfaqet shkurtimisht.

Këto hapa mund t'i kryeni sërish derisa të keni gjetur të gjitha kanalet e ofruara analoge.

Satelit

Kërkimi për satelitorin dhe cilësimet e tij

▲ (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Instalimi i satelitit > Kërko për satelit

Riinstalimi i të gjitha kanaleve

▲ (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Instalimi i satelitit > Kërko për satelit > Riinstalo kanalet

- Zgjidhni grupin e kanaleve që dëshironi të instaloni.
- Operatorët satelitorë mund të ofrojnë paketa që përmbledhin kanale të hapura (transmetime falas) dhe mundësojnë një renditje në përshtatje me shtetin përkatës. Disa satelitë ofrojnë paketa abonimi - një përmbledhje kanalesh me pagesë.

Lloji i lidhjes

Zgjidhni numrin e satelitëve që dëshironi të instaloni. Televizori e cakton automatikisht llojin e përshtatshëm të lidhjes.

- **Deri në 4 satelitë** - Mund të instaloni deri në 4 satelitë (4 koka LNB) në televizor. Zgjidhni numrin e saktë të satelitëve që dëshironi të instaloni në fillim të instalimit. Kjo do ta shpejtonte instalimin.
- **Unicable** - Për të lidhur antenën parabolike me

televizorin mund të përdorni një sistem "Unicable". Në fillim të instalimit mund të zgjidhni "Unicable" për 1 ose 2 satelitë.

Cilësimet e LNB

Në disa shtete, mund të rregulloni cilësimet për përdoruesit ekspertë për transponderët lokalizues dhe çdo kokë LNB. Përdorini ose ndryshojini këto cilësime vetëm nëse nuk bëhet dot instalimi normal. Këto cilësime mund t'i përdorni për të anuluar ato normale nëse keni pajisje jostandarde satelitore. Disa operatorë mund t'ju japin disa vlera transponderi ose koke LNB të cilat mund t'i vendosni këtu.

- **Universale ose rrethore** - Lloji i përgjithshëm i kokës LNB, zakonisht mund të zgjidhni këtë lloj për kokën tuaj LNB.
- **Frekuenca e ulët LO / Frekuenca e lartë LO** - Frekuencat e oshilatorit lokal caktohen në vlerat standarde. Rregullojini vlerat vetëm në rast pajisjesh të posaçme që kërkojnë vlera të ndryshme.
- **Toni 22 kHz** - Në cilësimin bazë, "Toni" është i caktuar në "Automatik".
- **Energjia e kokës LNB** - Në cilësimin bazë, energjia e kokës LNB është e caktuar në "Automatik".

Kërkimi automatik i kanaleve

▲ (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Instalimi i satelitit > Përditësimi automatik i kanaleve

Nëse merrni kanale dixhitale, mund ta caktoni televizorin që ta përditësojë automatikisht listën me kanalet e reja.

Përndryshe, mund ta bëni vetë.

Përditësimi automatik i kanaleve

Televizori i përditëson kanalet një herë në ditë, në orën 06:00 dhe ruan kanalet e reja. Kanalet e reja ruhen në listën "Të gjitha kanalet", por edhe në listën "Kanalet e reja". Kanalet boshe do të hiqen. Me ndezjen e televizorit shfaqet një mesazh nëse gjenden kanale të reja ose nëse kanalet janë përditësuar ose hequr. Për të bërë përditësimin automatik të kanaleve, televizori duhet të jetë në modalitet pritjeje.

* Ofrohet vetëm kur **Lista e kanaleve satelitore** është caktuar në **Nga një paketë e renditur**

Mesazhi i përditësimit të kanaleve

▲ (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Instalimi i satelitit > Mesazhi i përditësimit të kanaleve

Me ndezjen e televizorit shfaqet një mesazh nëse gjenden kanale të reja ose nëse kanalet janë përditësuar ose hequr. Për të shmangur shfaqjen e këtij mesazhi pas çdo përditësimi të kanaleve, mund ta çaktivizoni.

Opsioni i përditësimit automatik

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Instalimi i satelitit > Opsioni i përditësimit automatik

Çzgjdhni një satelit nëse nuk doni ta përditësoni automatikisht.

* Ofrohet vetëm kur **Lista e kanaleve satelitore** është e caktuar në **Nga një paketë e renditur**

Instalim manual

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Instalimi i satelitit > Instalimi manual

Instalimi manual i satelitit.

- LNB – Zgjidhni kokën LNB për të cilën dëshironi të shtoni kanale të reja.
- Polarizimi – Zgjidhni polarizimin që ju nevojitet.
- Modaliteti i shpejtësisë së modulimit – Zgjidhni "Manual" për të caktuar shpejtësinë e modulimit.
- Frekuenca – Vendosni frekuencën e transponderit.
- Kërkim – Kërkimi për transponder.

Modulet satelitore CAM

Nëse për shikimin e kanaleve satelitore përdorni modul CAM (për hyrje të kushtëzuar me kartë "Smart") ju rekomandojmë që instalimin e satelitëve ta kryeni me modul CAM të vendosur në televizor.

Shumica e moduleve CAM përdoren për të dekoduar kanalet.

Modulet CAM (CI+ 1.3 me profil operatori), mund të t'i instalojnë vetë të gjitha kanalet në televizor. Moduli CAM ju fton të instaloni satelitët dhe kanalet. Ato jo vetëm që instalojnë dhe dekodojnë kanalet, por kryejnë edhe përditësimet e rregullta të tyre.

Kopjimi i listës së kanaleve

Hyrje

Kopjimi i listës së kanaleve dhe Kopjimi i listës së satelitëve synohen për shitësit dhe përdoruesit ekspertë..

Me funksionin **Kopjimi i listës së kanaleve/Kopjimi i listës së satelitëve**, kanalet e instaluar në televizor mund t'i kopjoni drejt një televizori tjetër Philips të së njëjtës gamë. Me funksionin "Kopjimi i listës satelitore", mund të shmangni kërkimin e tepruar të kanaleve, duke ngarkuar në televizor një listë kanalesh të paracaktuara.

Kushtet

- Të dy televizorët i përkasin të njëjtit vit prodhimi.

- Të dy televizorët kanë të njëjtin lloj hardueri. Lloji i harduerit kontrollohet te pllaka e llojit të televizorit në pjesën e pasme të tij.
- Të dy televizorët kanë versione të pajtueshme softueri.
- Përdorni njësi "Flash USB" prej së paku 1 GB.

Kopjimi i një liste kanalesh, kontrolli i versionit të saj

Kopjimi i një liste kanalesh në njësinë "Flash USB"

Për të kopjuar një listë kanalesh...

1 - Ndizni televizorin. Televizori duhet të ketë kanale të instaluar.

2 - Futni një njësi USB në portën USB.

3 - Zgjidhni 🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Kopjimi i listës së kanaleve ose Kopjimi i listës së satelitëve dhe shtypni **OK**.

4 - Zgjidhni **Kopjim në USB** dhe shtypni **OK**.

5 - Pas përfundimit të kopjimit, hiqeni njësinë "Flash USB".

Tani mund ta ngarkoni listën e kopjuar e kanaleve drejt një televizori tjetër "Philips".

Kontrolli i versionit të listës së kanaleve

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Kopjimi i listës së kanaleve ose Kopjimi i listës së satelitëve > **Versioni aktual**

Ngarkimi i një liste kanalesh

Drejt televizorëve të painstaluar

Në varësi të instalimit ose jo të televizorit, për të ngarkuar listën e kanaleve duhet të përdoret një mënyrë tjetër.

Drejt një televizori ende të painstaluar

1 - Për të filluar instalimin, futeni televizorin në prizë dhe zgjidhni gjuhën e shtetin. Mund ta anashkaloni kërkimin e kanaleve. Përfundoni instalimin.

2 - Lidhni njësinë "Flash USB" që përmban listën e kanaleve të televizorit tjetër.

3 - Për të nisur ngarkimin e listës së kanaleve, zgjidhni 🏠 (Kreu) > Cilësimet

> **Kanaleve** > **Kopjimi i listës së kanaleve** ose **Kopjimi i listës satelitore** > **Kopjo në televizor** dhe shtyp **OK**. Jepni kodin PIN nëse nevojitet.

4 - Televizori do t'ju njoftojë nëse lista e kanaleve kopjohet me sukses në televizor. Hiqni njësinë "Flash USB".

Drejt televizorëve të instaluar

Në varësi të instalimit ose jo të televizorit, për të ngarkuar listën e kanaleve duhet të përdoret një mënyrë tjetër.

Drejt një televizori të instaluar

- 1 - Lidhni njësinë "Flash USB" që përmban listën e kanaleve të televizorit tjetër.
- 2 - Për të nisur ngarkimin e listës së kanaleve, zgjidhni **🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanaleve > Kopjimi i listës së kanaleve ose Kopjimi i listës satelitore > Kopjo në televizor dhe shtyp OK**. Jepni kodin PIN nëse nevojitet.
- 3 - Televizori do t'ju njoftojë nëse lista e kanaleve kopjohet me sukses në televizor. Hiqni njësinë "Flash USB".

* Shënim: Shteti i televizorit do të ndryshohet në atë të burimit (USB) pasi klonimi të ketë përfunduar.

Instalimi i kanaleve të internetit

Kërko dhe përditëso kanalet e internetit

Kërko kanalet e internetit*

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Instalimi i kanaleve të internetit > Kërko për kanale

- 1 - Zgjidhni **Kërko për kanale** dhe shtypni **OK**.
- 2 - Zgjidhni **Përditëso kanalet dixhitale** për të shtuar vetëm kanale të reja dixhitale. Zgjidhni **Riinstalim i shpejtë i kanaleve** për të instaluar sërish të gjitha kanalet me cilësimet standarde. Zgjidhni **Riinstalim i avancuar i kanaleve** për të kryer një riinstalim të plotë hap pas hapi.
- 3 - Shtypni **OK** për të kërkuar kanale. Kjo mund të zgjasë disa minuta.

Përditësimi automatik i kanaleve për kanale interneti

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Instalimi i kanaleve të internetit > Përditësimi automatik i kanaleve

Aktivizojeni për ta caktuar televizorin që të përditësojë automatikisht kanalet e internetit.

Përditësimi automatik i kanaleve

Televizori i përditëson kanalet një herë në ditë, në orën 06:00 dhe ruan kanalet e reja. Kanalet e reja ruhen në listën "Të gjitha kanalet", por edhe në listën "Kanalet e reja". Kanalet boshe do të hiqen. Me ndezjen e televizorit shfaqet një mesazh nëse gjenden kanale të reja ose nëse kanalet janë përditësuar ose hequr. Për të bërë përditësimin automatik të kanaleve, televizori duhet të jetë në modalitet pritjeje.

* Shënim: Kanalet e internetit janë të disponueshme vetëm kur cilësimi i vendit është MB ose ndonjë vend që mbështet DVB-I.

Opsionet e kanaleve

Hapja e opsioneve

Mund të caktoni disa opsione ndërkohë që shikoni një kanal.

Në varësi të llojit të kanalit që po shikoni ose në varësi të cilësimeve të televizorit që keni caktuar, ofrohen disa opsione.

Për të hapur menynë e opsioneve...

- 1 - Ndërkohë që shikoni një kanal, shtypni **OPTIONS**.
- 2 - Për ta mbyllur, shtypni sërish **OPTIONS**.

Informacioni i programit

Zgjidhni **Informacioni i programit** për të parë informacionin e programit që po shikoni.

Për të shfaqur të dhënat e programit të zgjedhur...

- 1 - Sintonizohuni në kanal.
- 2 - Shtypni **INFO** për të hapur ose për të mbyllur informacionin e programit.
- 3 - Përndryshe mund të shtypni **OPTIONS**, të zgjidhni **Informacioni i programit** dhe të shtypni **OK** për të hapur informacionin e programit.
- 4 - Shtypni **← Kthehu** për të mbyllur informacionin mbi programin.

Titrat

Për të aktivizuar titrat, shtypni **OPSIONET** dhe zgjidhni **Titrat**.

Mund t'i kaloni titrat në **Titra aktive** ose **Titra joaktive**. Përndryshe mund të zgjidhni **Automatike**.

Automatike

Nëse informacionet e gjuhës janë pjesë e transmetimit dixhital dhe programi i transmetuar nuk është në gjuhën tuaj (gjuha e caktuar në televizor), televizori mund të shfaqë automatikisht titrat në një nga gjuhët tuaja të preferuara. Njëra nga këto gjuhë titrash duhet të jetë edhe pjesë e transmetimit.

Gjuhët e preferuara të titrave mund t'i zgjidhni te **Gjuha e titrave**.

Gjuha e titrave

Nëse nuk ofrohet asnjëra nga gjuhët e preferuara të titrave, mund të zgjidhni një gjuhë tjetër që ofrohet. Nuk e zgjidhni dot këtë opsion nëse nuk ofrohet asnjë gjuhë titrash.

Gjuha e audios

Nëse nuk ofrohet asnjë nga gjuhët e preferuara të audios, mund të zgjidhni një gjuhë tjetër, nëse ofrohet. Nëse nuk ofrohet asnjë gjuhë audioje, nuk e zgjidhni dot këtë opsion.

Dual I-II

Ky opsion ofrohet nëse sinjali i zërit përmban dy gjuhë audioje, por njëra nga gjuhët — ose të dyja — nuk ka tregues gjuhe.

Ndërfaqja e përbashkët

Nëse ofrohet material cilësor me parapagesë nga një modul CAM, mund t'i caktoni cilësimet e operatorit me këtë opsion.

Mono/Stereo

Zërin e një kanali analog mund ta kaloni në "Mono" ose "Stereo".

Për të kaluar në Mono ose Stereo...

Sintonizohuni në një kanal analog.

- 1 - Shtypni **OPSIONET**, zgjidhni **Mono/Stereo** dhe shtypni **➤** (djathtas).
- 2 - Zgjidhni **Mono** ose **Stereo** dhe shtypni **OK**.
- 3 - Nëse është e nevojshme, shtypni vazhdimisht **◀** (majtas) për të mbyllur menyne.

Informacioni i kanalit

Zgjidhni **Informacioni i kanalit** për të parë informacionet teknike të kanalit.

Për të hapur detajet e kanalit të zgjedhur...

- 1 - Sintonizohuni në kanal.
- 2 - Shtypni **OPTIONS**, zgjidhni **Informacioni i kanalit** dhe shtypni **OK** për të hapur informacionin e kanalit.
- 3 - Shtypni sërish **OPSIONET** ose shtypni **◀ Pas** për të mbyllur informacionin e kanalit.

"HbbTV" në këtë kanal

Nëse nuk doni të hapni faqet e "HbbTV" në një kanal të caktuar, mund t'i bllokoni vetëm për këtë kanal.

- 1 - Sintonizohuni në kanalin faqet "HbbTV" të të cilit dëshironi të bllokoni.
- 2 - Shtypni **OPSIONET** dhe zgjidhni **HbbTV në këtë kanal** dhe shtypni **➤** (djathtas).
- 3 - Zgjidhni **Joaktiv** dhe shtypni **OK**.
- 4 - Shtypni **◀** (majtas) për t'u kthyer një hap prapa ose shtypni **◀** Kthehu për të mbyllur menyne.

Bllokimi i plotë i "HbbTV" në televizor:

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Cilësimet e HbbTV > HbbTV > Joaktive

Asistenca

Ofrohet vetëm kur **Asistenca** caktohet në **Aktive**.

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Asistenca > Asistenca > Aktive.

Për të lexuar më shumë informacion, kontrolloni te **Ndihma > Manuali i përdorimit > Cilësimet e aksesit universal**.

Cilësimet e "HbbTV" - Teletransmetimi hibrid me brez të gjerë

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Cilësimet e HbbTV > HbbTV

Nëse një kanal televiziv ofron shërbime "HbbTV", fillimisht duhet të aktivizoni "HbbTV" në cilësimet e televizorit për të aksesuar këto shërbime të avancuara, si p.sh. shërbimet e videove me porosi dhe "Catch-up TV".

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Cilësimet e HbbTV > Monitorimi i HbbTV

Aktivizoni ose çaktivizoni ndjekjen e sjelljes së shfletimit të "HbbTV". Çaktivizimi informon shërbimet e "HbbTV" që të mos ndjekin sjelljen tuaj të shfletimit.

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Cilësimet e HbbTV > Skedarët e personalizimit të HbbTV

Aktivizoni ose çaktivizoni ruajtjen e skedarëve të personalizimit, të dhënave të faqeve dhe memories specifike të palëve të treta nga shërbimet e "HbbTV".

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Cilësimet e HbbTV > HbbTV Rivendosja e ID-së së pajisjes

Mund të rivendosësh identifikuesin unik të pajisjes për televizorin. Do të krijohet një identifikues i ri.

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Cilësimet
HbbTV > Spastro listën e aplikacioneve të miratuara

Ju lejon të spastroni listën e aplikacioneve të "HbbTV" që keni lejuar të hapen në televizor.

Cilësimet e CAM-së

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Profili i operatorit të modulit CAM

Kur instalimi i profilit CAM të ketë përfunduar, zgjidhni të aktivizoni ose çaktivizoni mesazhin kërcyes të ndërfaqes së përdoruesit të "Profili i operatorit të modulit CAM".

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Emri i profilit të operatorit të modulit CAM

Kur Profili i operatorit të modulit CAM është i aktivizuar, zgjidhni për të shfaqur emrin e profilit të kartës CAM që është lidhur aktualisht.

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Ndërfaqja e CAM

Zgjidhni USB për të aktivizuar USB CAM, duke çaktivizuar kështu PCMCIA CAM. Zgjidhni PCMCIA për të aktivizuar PCMCIA CAM, duke çaktivizuar kështu USB CAM.

7.3. Lista e kanaleve

Hapja e listës së kanaleve

Për të hapur listën aktuale të kanaleve...

- 1 - Shtypni TV / DIL për të kaluar te televizori.
- 2 - Shtypni OK për të hapur listën e kanaleve nëse shërbimi interaktiv nuk disponohet, ose shtypni ≡ Lista e kanaleve për të hapur listën e kanaleve.
- 3 - Shtypni OPSIONET > Zgjidh listën e kanaleve.
- 4 - Zgjidhni listën e kanaleve që dëshironi të shikoni.
- 5 - Shtypni ← Kthehu për të mbyllur listën e kanaleve.

Kanalet që shfaqen në listën "Të gjitha kanalet" janë të renditur në bazë të zhanrit*. Për shembull: Premium, Premium Lajme, Premium Lokal, Fëmijët, Sport dhe të tjera. Zhanri "Premium" përfshin kanalet transmetuese më të mira të pozicionuara dhe që zënë

mbi 3% të tregut.

* Shënim: Funkzioni i renditjes sipas zhanrit është i vlefshëm vetëm në Gjermani.

Opsionet e listës së kanaleve

Hapja e menysë Opsionet

Për të hapur menynë e opsioneve të listës së kanaleve:

- Shtypni TV / DIL për të kaluar te televizori.
- Shtypni ≡ Lista e kanaleve për të hapur listën e kanaleve.
- Shtypni OPSIONET dhe zgjidhni një nga opsionet.
- Shtypni ← Kthehu për të mbyllur listën e kanaleve.

Riemërtimi i kanalit

- 1 - Shtypni TV / DIL për të kaluar te televizori.
- 2 - Shtypni ≡ Lista e kanaleve për të hapur listën e kanaleve.
- 3 - Zgjidhni një kanal që doni të riemërtoni.
- 4 - Shtypni OPSIONET > Riemërto kanalën dhe shtypni OK për të hapur tastierën në ekran.
- 5 - Përdorni butonat e navigimit për të zgjedhur karakteret.
- 6 - Zgjidhni Hyr pasi të keni përfunduar modifikimin.
- 7 - Shtypni ← Kthehu për të mbyllur listën e kanaleve.

Zgjedhja e filtrit të kanaleve

- 1 - Shtypni TV / DIL për të kaluar te televizori.
- 2 - Shtypni ≡ Lista e kanaleve për të hapur listën e kanaleve.
- 3 - Shtypni OPSIONET > Dixhital/Analog, Të hapura/Të koduara
- 4 - Zgjidhni një nga kombinimet e kanaleve që shfaqen në listë.

Krijimi ose modifikimi i listës së kanaleve të preferuara

TV / DIL > OK > OPSIONET > Krijo listën e preferencave

Zgjidhni një kanal dhe shtypni OK për ta shtuar në listën e kanaleve të preferuara dhe pasi të keni përfunduar, shtypni ➡ Fund.

TV / DIL > OK > OPSIONET > Modifiko preferencat

Zgjidhni një kanal dhe shtypni OK për ta shtuar apo hequr nga një listë kanalesh të preferuara, pasi të përfundoni shtypni ➡ Fund.

Zgjedhja e vargut të kanaleve

TV / DIL > OK > OPSIONET > Zgjidh diapazonin e kanaleve

Zgjidhni një diapazon të kanaleve në listën e kanaleve. Shtypni OK për të shënuar fillimin e diapazonit dhe më pas shtypni përsëri OK për të përfunduar zgjedhjen e diapazonit. Kanalet e zgjedhura do të shënohen si preferenca.

Zgjedhja e listës së kanaleve

TV / DIL > OK > OPSIONET > Zgjidh listën e kanaleve

Zgjidhni një nga listat e kanaleve që renditen sipas llojeve të ndryshme të kanaleve.

Kërkimi i kanaleve

TV / DIL > OK > OPSIONET > Kërko kanal

Mund të kërkoni një kanal për ta gjetur në një listë të gjatë kanalesh. Kërkimi do të nxjerrë emrin e kanalit që përputhet, me rezultate të renditura sipas rendit alfabetik.

- 1 - Shtypni TV / DIL për të kaluar te televizori.
- 2 - Shtypni ≡ Lista e kanaleve për të hapur listën e kanaleve.
- 3 - Shtypni OPSIONET > Kërko kanal dhe shtypni OK për të hapur tastierën në ekran.
- 4 - Përdorni tastet e shfletimit për të zgjedhur një germë, më pas shtypni OK.
- 5 - Zgjidhni Enter kur të përfundoni futjen e emrit.
- 6 - Shtypni ← Kthehu për të mbyllur listën e kanaleve.

Kyçja ose shkyçja e kanaleve

TV / DIL > OK > OPSIONET > Blloko kanal, Zhblloko kanal

Kanalet mund t'i kyçni për të parandaluar shikimin nga fëmijët. Për të parë një kanal të kyçur, fillimisht duhet të jepni kodin PIN 4-shifror të funksionit Bllokimi për fëmijët. Programet nuk i kyçni dot nga pajisjet e lidhura.

Kanali i kyçur do të ketë  përbri stemës së kanalit.

Heqja e listës së preferencave

TV / DIL > OK > OPSIONET > Hiq listën e preferencave



Për të hequr një listë ekzistuese preferencash, zgjidhni Po.

7.4. Kanalet e preferuara



Rreth kanaleve të preferuara

Mund të krijoni një listë me kanale të preferuara e cila mban vetëm kanalet që dëshironi të shikoni. Kur zgjidhni listën e kanaleve të preferuara, kanalet e preferuara do t'i shihni vetëm kur ndërroni kanalet.

Krijimi i një liste preferencash


- 1 - Ndërkohë që shikoni një kanal televiziv, shtypni ≡ Lista e kanaleve për të hapur listën e kanaleve.
- 2 - Zgjidhni një kanal dhe shtypni  Piketo si të preferuar për ta shënuar si të preferuar.
- 3 - Kanali i zgjedhur shënohet me një .
- 4 - Për të përfunduar, shtypni ← Kthehu . Kanalet shtohen në listën "Preferencat".

Heqja e kanaleve nga lista e preferencave

Për të hequr një kanal nga lista e preferencave, zgjidhni kanalën me , shtypni sërish  Shpiketo si të preferuar për ta shpikëtuar.

Rirenditja e kanaleve

Mund t'i rirëdisni — ripoziononi — kanalet në listën e kanaleve të preferuara (disponohet vetëm për disa shtete).

- 1 - Ndërkohë që shikoni një kanal televiziv, shtypni OK > OPSIONET > Zgjidh listën e kanaleve.
- 2 - Zgjidhni Preferenca në antenë, Preferenca në kabllor ose Preferenca në satelitor* dhe shtypni OPSIONET.
- 3 - Zgjidhni Rirenditja e kanaleve, zgjidhni kanalën që dëshironi të rirëdisni dhe shtypni OK.
- 4 - Shtypni Butonat e shfletimit për të lëvizur diku tjetër kanalën e zgjedhur dhe shtypni OK.
- 5 - Pasi të keni përfunduar, shtypni  Fund.

* Kanalet vetëm satelitor mund të kërkohen në modelet e televizorëve xxPxSxxxx.

"Lista e preferencave" në "Guidën televizive"

"Guidën televizive" mund ta lidhni për "Listën e preferencave".

- 1 - Ndërkohë që shikoni një kanal televiziv, shtypni **OK > OPSIONET > Zgjidh listën e kanaleve**.
- 2 - Zgjidhni **Preferencat e antenës, Preferencat e kabllorit ose Preferencat e satelitorit*** dhe shtypni **OK**.
- 3 - Zgjidhni **GUIDA TELEVIZIVE** për ta hapur.

Me "Guidën televizive" mund të shihni listën aktuale të programeve televizive dhe të programeve të planifikuara të kanaleve tuaja të preferuara. Ndër kanalet tuaja të preferuara, 3 kanalet e para më të përdorura nga lista bazë e transmetuesit do të bashkëngjiten pas kanaleve tuaja të preferuara për shikimin paraprak. Këto kanale duhet t'i shtoni në listën tuaj të preferuar për ta bërë funksionale (shihni kreun "Guida televizive").

Në secilën faqe të guidës televizive ka një rrejtë "A e dinit se" të futur në listën tuaj të kanaleve të preferuara. Kanali "A e dinit" ofron këshilla të dobishme për të përmirësuar mënyrën sesi e përdorni televizorin.

7.5. Teleteksti

Titrat nga teleteksti

Nëse sintonizoheni në kanal analog, titrat duhet të aktivizohen manualisht për çdo kanal.

- 1 - Shtypni **OPTIONS** teksa ndiqni kanalet televizive, zgjidhni **Teleteksti** për të hapur teletekstin.
- 2 - Jepni numrin e faqes për titrat, zakonisht **888**.
- 3 - Shtypni **← (Kthehu)** për të mbyllur faqen e tekstit.

Nëse gjatë shikimit të këtij kanali analog zgjidhni **Aktiv te menyja "Titrat"**, do të shfaqen titrat, nëse ka.

Për të mësuar nëse një kanal është analog apo dixhital, shkoni te kanali dhe shtypni **INFO**.

Faqet e teletekstit

Nëse telekomanda vjen me butonin **TEXT**, mund të shtypni **TEXT** për të hapur "Teletekstin" ndërsa shihni televizor. Për ta mbyllur funksionin "Teleteksti", shtypni sërish butonin **TEXT**.

Nëse telekomanda nuk vjen me butonin **TEXT**, shtypni **OPTIONS** ndërsa shihni televizor, zgjidhni

Teleteksti për të hapur teletekstin.

Zgjedhja e një faqeje teleteksti

Për të zgjedhur një faqe. . .

- 1 - Shkruani numrin e faqes me tastet numerike.
- 2 - Përdorni tastet me shigjetë për të lëvizur.
- 3 - Shtypni një tast me ngjyrë për të zgjedhur një element me ngjyrë në pjesën e poshtme të ekranit.

Nënfaqet e teletekstit

Një numër faqeje teleteksti mund të përmbajë disa nënfaqe. Numrat e nënfaqeve shfaqen në një shirit përbri numrit të faqes kryesore.

Për të zgjedhur një nënfaqe, shtypni **< ose >**.

Pasqyra e teletekstit Faqet e teletekstit

Disa transmetues ofrojnë pasqyrë Teleteksti. Për të hapur T.O.P. Faqet e teletekstit brenda funksionit Teleteksti, shtypni **OPTIONS** dhe zgjidhni **Përmbledhje e pasqyrës**.

* Teleteksti mund të hapet vetëm kur kanalet instalohen direkt në sintonizuesin e brendshëm të televizorit dhe ky i fundit është i caktuar në modalitetin e televizorit. Nëse përdoret një dekodues, teleteksti do të jetë i padisponueshëm nëpërmjet televizorit. Në këtë rast mund të përdoret teleteksti i dekoduesit.

Opsionet e teletekstit

Tek Teksti/Teleteksti, shtypni **OPTIONS** për të zgjedhur sa më poshtë...

- **Ngri faqen/Shkri faqen**
Për të ndaluar rrotullimin automatik të nënfaqeve.
- **Ekran i dyfishtë / Ekran i plotë**
Për të shfaqur kanalin televiziv dhe teletekstin përbri njëri-tjetrit.
- **Përmbledhja e pasqyrës**
Për të hapur pasqyrën. teletekstit.
- **Zmadhim/pamje normale**
Për të zmadhuar faqen e teletekstit për lexim komod.
- **Shfaqje**
Për të rishfaqur informacionin e fshehur në një faqe.
- **Qarkullim i nënfaqeve**
Për të qarkulluar nënfaqet, nëse ka.
- **Gjuha**
Për të ndërruar grupin e gërmave që përdoren nga teleteksti për t'u shfaqur siç duhet.
- **Teksti 2,5**
Për të aktivizuar funksionin "Teksti 2,5" për më shumë ngjyra dhe grafikë më të mirë.

Konfigurimi i teletekstit

Gjuha e teletekstit

Disa transmetues televizivë dixhitalë ofrojnë disa gjuhë teleteksti.

Caktimi i gjuhës së preferuar të teletekstit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Rajoni dhe gjuha > Gjuha > Teleteksti kryesor, Teleteksti dytësor

Teleteksti 2.5

Nëse ofrohet, "Teleteksti 2.5" ofron më shumë ngjyra dhe grafikë më të mirë. Teksti 2,5 aktivizohet si cilësim standard i fabrikës.

Për të çaktivizuar Teksti 2,5...

- 1 - Shtypni **TEXT** ose shtypni **OPTIONS** dhe më pas zgjidhni Teleteksti.
- 2 - Me funksionin Teksti/Teleteksti të hapur në ekran, shtypni **OPSIONET**.
- 3 - Zgjidh **Teksti 2,5 > Joaktiv për të çaktivizuar Teksti 2,5**.

7.6. Kanalet e transmetimit

Kanalet e transmetimit janë kanale televizive që mund të shihen pa pagesë dhe që mbështeten nga reklamat. Kur televizori juaj është i lidhur me internetin, dhe në rajonin tuaj ofrohen kanale transmetimi, televizori juaj mund të shtojë automatikisht kanale transmetimi në guidën tuaj të televizorit. Ju mund t'i aksesoni këto kanale me shtypjen e një butoni kurdo që dëshironi.

Shikoni kanalet e transmetimit

Televizori juaj duhet të jetë i lidhur në një rrjet shtëpie me një lidhje interneti. Do t'ju duhet të pranoni Kushtet e Përdorimit dhe Politikën e Privatësisë së kanaleve të transmetimit.

Për të instaluar dhe parë kanalet e transmetimit:

- 1 - Shtypni butonin **SOURCES** në telekomandë për të hapur menunë "Burimet".
- 2 - Zgjidhni **Në transmetim*** për të ndryshuar burimin e kanaleve të transmetimit.
- 3 - Ndiqni udhëzimet në ekran për të pranuar Kushtet e Përdorimit dhe Politikën e Privatësisë.
- 4 - Televizori do të instalojë kanalet e transmetimit të disponueshme në rajonin tuaj, ju lutemi prisni derisa të përfundojë instalimi.
- 5 - Tani mund të shihni kanalet e transmetimit në televizorin tuaj.

Kanalet e transmetimit përfshijnë një listë kanalesh, informacion për kanalet / programet, një guidë televizive, kyçjen e kanaleve / programeve, ashtu si edhe kanalet me antenë, kabllorë dhe satelit.

* Shënim: Kanali **Në transmetim** nuk disponohet kur cilësimi i shtetit është Mbretëri e Bashkuar.

Ndryshoni cilësimet e privatësisë së reklamave

Kanalet e transmetimit falas mbështeten nga reklamat. Mund të ndryshoni cilësimet e privatësisë së reklamave për të aktivizuar ose çaktivizuar reklamat përkatëse.

Ër të parë Kushtet e përdorimit të kanaleve të transmetimit ose për të ndryshuar cilësimet e privatësisë së reklamimit të kanaleve të transmetimit, shkoni te 🏠 (Kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Cilësimet e privatësisë dhe zgjidhni cilësimet më poshtë.

Qendra e preferencave të privatësisë: Shikoni dhe caktoni cilësimet e privatësisë sipas preferencës suaj.

ID-ja e reklamimit: shikoni ID-në aktuale të reklamimit që identifikon televizorin tuaj për të aktivizuar reklamat e përshtatshme për ju. Shtypni **OK** për të rivendosur ID-në e reklamimit në një numër të rastësishëm të ri.

Gjurmimi i kufizuar i reklamave: kur aktivizohet gjurmimi i kufizuar i reklamave, reklamimi mund të jetë më pak i përshtatur për ju. Kjo nuk do të ndikojë numrin e reklamave të shfaqura. Shtypni **OK** për të aktivizuar ose çaktivizuar gjurmimin e kufizuar të reklamave.

8. Guida televizive

8.1. Çfarë ju duhet

Me funksionin "Guida televizive" mund të shihni listën e programeve televizive dhe të programeve aktuale dhe të planifikuara të kanaleve tuaja. Në varësi të origjinës së informacionit (të të dhënave) të guidës televizive, do të shfaqen kanalet analoge dhe dixhitale ose vetëm kanalet dixhitale. Jo të gjitha kanalet televizive ofrojnë informacionin e guidës televizive.

Televizori mund të mbledhë informacion të guidës televizive për kanalet e instaluara (p.sh. kanalet që shikoni me funksionin "Shikimi televiziv"). Televizori nuk mund të mbledhë informacion të guidës televizive për kanalet e shikuara nga një marrës dixhital.

8.2. Përdorimi i guidës televizive

Hapja e guidës televizive

Për të hapur guidën televizive, shtypni **GUIDA TELEVIZIVE**.

Shtypni sërish **GUIDA TELEVIZIVE** për ta mbyllur.

Herën e parë që hapni funksionin "Guida televizive", televizori kontrollon të gjitha kanalet televizive për informacione mbi programet e tyre. Ky veprim mund të zgjasë disa minuta. Të dhënat e guidës televizive ruhen në televizor.

Sintonizimi në një program

Kalimi te një program

- Mund të kaloni nga Guida televizive te një program aktual.
- Për të zgjedhur një program, përdorni tastet me shigjeta për të theksuar emrin e programit.
- Kaloni djathtas për të parë programet e planifikuara për më vonë po atë ditë.
- Për të kaluar te programi (kanali), zgjidhni programin dhe shtypni **OK**.

Shfaqja e detajeve të programit

Për të shfaqur detajet e programit të zgjedhur, shtypni **INFO**.

Përditësimi i guidës së televizorit

Ju mund ta përditësoni guidën e televizorit për të marrë informacionet më të fundit të programeve.

Për ta përditësuar guidën televizive, shtypni **OPSIONET** dhe zgjidhni **Përditëso guidën televizive**. Përditësimi mund të zgjasë disa minuta.

Ndryshimi i ditës

Nëse informacioni i guidës televizive vjen nga transmetuesi, për të parë programin e një prej ditëve të ardhshme, shtypni **Kanali lart**. Shtypni **Kanali poshtë** për t'u kthyer te dita e mëparshme.

Përndryshe, mund të shtypni **OPSIONET** dhe të zgjidhni **Ndrysho ditën**.

Kërkimi sipas zhanrit

Nëse jepen informacione, programet e planifikuara mund t'i kërkoni sipas zhanrit si p.sh filma, sporte etj.


Për të kërkuar programet sipas zhanrit, shtypni **OPSIONET** dhe zgjidhni **Kërko sipas zhanrit**. Zgjidhni një zhanër dhe shtypni **OK**. Do të shfaqet një listë me programet e gjetura.

9. Videot, fotografitë dhe muzika

9.1. Nga një lidhje USB

Mund të shikoni fotografitë ose të luani muzikën dhe videot nga një njësi "Flash USB" ose disk i lidhur USB.

Me televizorin të ndezur, lidhni një njësi "Flash USB" ose një disk USB në një nga lidhjet USB.

Shtypni  SOURCES dhe më pas zgjidhni USB, ku mund të shfletoni skedarët tuaj në strukturën e dosjeve që keni organizuar në diskun USB.

9.2. Nga kompjuteri ose NAS


Mund të shikoni fotografitë ose të luani muzikë dhe video nga kompjuteri apo NAS (pajisje ruajtëse e lidhur në rrjet) në rrjetin e shtëpisë.

Televizori dhe kompjuteri ose NAS duhet të jenë në të njëjtin rrjet shtëpie. Në kompjuter apo NAS duhet të instaloni softuerë serveri për media. Serveri për media duhet të caktohet që t'i ndajë skedarët me televizorin. Televizori i shfaq skedarët dhe dosjet sipas organizimit në serverin për media ose sipas strukturimit në kompjuter apo NAS.

Televizori nuk mbështet titra në transmetime videosh nga një kompjuter apo NAS.







Nëse serveri për media mbështet kontrollin për skedarë, ofrohet një fushë kërkimi.

Për të shfletuar dhe luajtur skedarët në kompjuterin tuaj...

- 1 - Shtypni  SOURCES, zgjidhni Rrjeti dhe shtypni OK.
- 2 - Pasi një pajisje të lidhet, artikulli Pajisja e rrjetit do të zëvendësohet me emrin e pajisjes së lidhur.
- 3 - Mund t'i shfletoni dhe të luani skedarët.
- 4 - Për të ndaluar luajtjen e videove, fotove dhe muzikës, shtypni EXIT.

9.3. Fotografi

Shikimi i fotove

- 1 - Shtypni  SOURCES, zgjidhni USB dhe shtypni OK.
- 2 - Zgjidhni  Njësia Flash USB dhe më pas zgjidhni pajisjen USB që ju nevojitet.
- 3 - Zgjidhni një foto dhe shtypni OK për ta parë.
 - Për të parë fotot, zgjidhni Foto në shiritin e menysë, zgjidhni një miniaturë fotoje dhe shtypni OK.
 - Shihni skedarët e fotove me menynë e kontrollit: Shiriti i kontrollit të luajtjes,  (Kalo te fotoja e mëparshme në një dosje),  (Kalo te fotoja tjetër në një dosje),  (Fillo luajtjen e fotoserisë),  (Pusho luajtjen).
 - Shtypni ikonat në luajtës për të:
 - Fillo një fotoseri
 - Rrotullo foton
 - Përzieji: luajti skedarët në rend të rastësishëm
 - Përsërit: luan të gjitha fotot në këtë dosje një herë ose vazhdimisht
 - Cakto shpejtësinë e fotoserisë
 - Ndalo muzikën që po luhet në sfond.

Opsionet e fotografisë

Kur shfletoni skedarët e fotove, shtypni OPSIONET për të përfituruar më shumë opsione.

Fotoseri

Nëse ka disa foto në të njëjtën dosje, zgjidhni për të nisur një fotoseri të të gjitha fotove në këtë dosje.

Rendit

Shfletoni fotot sipas datës, harkut kohor ose emrit të skedarit.

Lista/Miniaturat

Shfaqini fotot në pamje liste ose miniaturash.

Përzieji

Shikoni figurat në rend të njëpasnjëshëm ose në mënyrë të rastësishme.

Përsërit

Shikojini figurat vazhdimisht ose vetëm një herë.

Ndalimi i muzikës

Ndaloni muzikën nëse është duke u luajtur.

Shpejtësia e fotoserisë

Caktoni shpejtësinë e fotoserisë.

Tranzicionet e fotoserisë

Caktoni tranzicionin nga njëra figurë tek tjetra.

Info

Shfaqini informacionin e skedarëve të fotove.

Gjatë shikimit të skedarëve të fotove, shtypni

OPSIONET për të përfituar më shumë opsione.

Info

Shfaqni informacionin e skedarëve të fotove.

9.4. Videot

Luajtja e videove

Për të luajtur një video në televizor:

Zgjidhni **Videot**, më pas zgjidhni emrin e skedarit dhe shtypni **OK**.

- Për të pushuar videon, shtypni **OK**. Shtypni përsëri **OK** për të vazhduar.
- - Për ta kthyer pas ose për ecur shpejt përpara, shtypni **▶▶** ose **◀◀**. Shtypini tastet disa herë për të përshpejtuar me - 2x, 4x, 8x, 16x, 32x.
- Për të kaluar në videon tjetër në një dosje, shtypni **OK** për ta pushuar, zgjidhni **▶** në ekran dhe shtypni **OK**.
- Për t'u kthyer te dosja, shtypni **←** **Pas**.

Hapja e dosjes së videove

- 1 - Shtypni **☐ SOURCES**, zgjidhni **USB** dhe shtypni **OK**.
 - 2 - Zgjidhni **☑ Njësia Flash USB** dhe më pas zgjidhni pajisjen **USB** që ju nevojitet.
 - 3 - Zgjidhni **Video** dhe zgjidhni një video. Mund të shtypni **OK** për ta luajtur.
- Zgjidhni një video dhe shtypni **INFO** për të shfaqur informacionin e skedarit.
 - Luani një skedar video me menynë e kontrollit: Shirti i ecurisë, shirti i kontrollit të luajtjes, **◀** (Kalo te videoja e mëparshme në një dosje), **▶** (Kalo te videoja tjetër në një dosje), **▶** (Luajtja), **◀◀** (Kthe pas), **▶▶** (Shpejt përpara), **||** (Pusho luajtjen).
 - Shtypni ikonat në luajtës për të:
 - Luaj një/të gjitha videot
 - Titra: caktojini titrat në "Aktive", "Joaktive" ose "Aktive gjatë heshtjes".
 - Gjuha e titrave: zgjidhni një gjuhë titrash
 - Zgjidhni setin e karaktereve nëse disponohen titra të jashtme.
 - Gjuha e audios: zgjidhni një gjuhë audioje
 - Përzieji: luajni skedarët në rend të rastësishëm
 - Përsërit: luan të gjitha videot në këtë dosje një herë ose në mënyrë të vazhdueshme

Opsionet e videos

Kur shfletoni skedarë video, shtypni **OPSIONET** për të përfituar më shumë opsione.

Luaj të gjitha

Luani të gjithë skedarët në dosje.

Lista/Miniaturat

Shfaqini skedarët video në pamje liste ose miniaturash.

Përzierja aktive, joaktive

Luani video në rend të njëpasnjëshëm ose të çrregullt.

Përsëritje, luajtje e vetme

Luajini videot vazhdimisht ose vetëm një herë.

Info

Shfaqni informacionin e skedarit video.

Gjatë luajtjes së videos, shtypni **OPSIONET** për të përfituar më shumë opsione.

Cilësimi i titrave

Caktoni opsionet Madhësia e shkrimit, Ngjyra e titrave, Pozicioni i titrave dhe Shmangia e sinkronizimit, nëse këto opsione janë të disponueshme.

Info

Shfaqni informacionin e skedarit video.

9.5. Muzikë

Luajtja e muzikës

Hapja e dosjes së muzikës

- 1 - Shtypni **☐ SOURCES**, zgjidhni **USB** dhe shtypni **OK**.
 - 2 - Zgjidhni **Njësia Flash USB** dhe shtypni **▶** (djathtas) për të zgjedhur pajisjen **USB** që ju nevojitet.
 - 3 - Zgjidhni **Muzikë** dhe zgjidhni një këngë. Mund të shtypni **OK** për ta luajtur.
- Zgjidhni një muzikë dhe shtypni **INFO** për të shfaqur informacionin e skedarit.
 - Luani një skedar muzike me menynë e kontrollit: Shirti i ecurisë, shirti i kontrollit të luajtjes, **◀** (Kalo te muzika e mëparshme në një dosje), **▶** (Kalo te muzika tjetër në një dosje), **▶** (Luajtja), **◀◀** (Kthe pas), **▶▶** (Shpejt përpara), **||** (Pusho luajtjen).
 - Shtypni ikonat në luajtës për të:
 - Luaj gjithë muzikën
 - Përzieji: luajni skedarët në rend të rastësishëm
 - Përsërit: luan gjithë muzikën në këtë dosje një herë ose në mënyrë të vazhdueshme

Opsionet e muzikës

Kur shfletoni skedarë muzike, shtypni **OPSIONET** për të përfituar më shumë opsione.

Luaj të gjitha

Luani të gjithë skedarët në dosje.

Lista/Miniaturat

Shfaqni skedarët e muzikës në pamje liste ose miniaturash.

Përzierja joaktive, aktive

Luani këngët në rend të njëpasnjëshëm ose të çrregullt.

Përsëritje, luajtje e vetme

Luajini këngët vazhdimisht ose vetëm një herë

Mund të shtypni tastin **≡** (Menyja e shpejtë/Menyja e televizorit) dhe të zgjidhni Moments; në ekranin e televizorit do të shfaqet një kod QR. Skanoni kodin QR me pajisjen tuaj celulare dhe ndiqni udhëzimin për të shkarkuar dhe instaluar aplikacionin **Moments**. Kur përdorni aplikacionin, pajisja celulare dhe televizori Philips duhet të lidhen me të njëjtin rrjet Wi-Fi.

9.6. Aplikacioni "Moments"

Moments – albumi dixhital për televizor

Moments është një aplikacion albumi dixhital fotografish që integrohet me televizorin tuaj. Mund të krijoni, modifikoni dhe ndani albume fotografish në mënyrë intuitive dhe të personalizuar.

I zhvilluar për t'u integruar me pajisjet celulare dhe për televizorë të zgjedhur inteligjentë Philips,

Moments ju lejon të organizoni kujtimet tuaja në një mënyrë novatore, me mjete modifikimi dhe një ndërfaqe praktike. Transformoni fotot tuaja në histori të bukura vizuale që mund të ndahen dhe të shikohen lehtësisht në ekranin e madh.

Veçoritë kryesore

Albumi i shpejtë: Mund thjesht të shtoni figura dhe albumi është gati për t'u dërguar në televizor. Përpos kësaj, është e mundur të përfshihet në mënyrë opsionale audio në sfond, të rregullohet koha e tranzicionit midis fotove dhe të zgjidhet efekti i dëshiruar i tranzicionit në album.

Album shabllon: Mund të përdorni më shumë opsione personalizimi, duke lejuar krijimin e albumit faqe për faqe. Procesi fillon me zgjedhjen e një shablloni/modeli, i cili mund të modifikohet sipas nevojave tuaja. Mund të ndryshoni figurat, të personalizoni tekstin, të ndryshoni ngjyrat dhe të eksploroni opsione të tjera personalizimi.

Televizorët e çiftuar: Kjo veçori ju lejon të menaxhoni televizorët, duke bërë të mundur shtimin e çiftimeve të reja dhe mirëmbajtjen e televizorëve tashmë të lidhur.

10. Hapja e menysë së cilësimeve të televizorit

10.1. Menyja e shpejtë dhe Cilësimet e shpeshta

Shtypni tastin Menyja e shpejtë/MENYJA në telekomandë për të gjetur Menyja e shpejtë dhe më pas shtypni shigjetat ◀ (majtas) për të gjetur Cilësimet e shpeshta.

* Shënim: opsionet te Menyja e shpejtë dhe Cilësimet e shpeshta mund të ndryshojnë në varësi të veçorive të ndryshme të produktit ose rasteve të ndryshme të përdorimit.

Menyja e shpejtë:

- Ndhma — Diagnostikoni dhe merrni më shumë informacion rreth televizorit tuaj.
- Të gjitha cilësimet — Shfaqni menynë e të gjitha cilësimeve.
- Burimet — Për të hapur menynë Burimet.
- AmbiScape* — Për të hapur AmbiScape.
- Aurora* — Për të hapur aplikacionin Aurora.
- Ambilight Suite* — Për të nisur Ambilight Suite.
- Moments — Për t'u lidhur me aplikacionin Moments.
- Shiko televizor — Për t'u kthyer përsëri për të parë televizion.
- Guida televizive — Për të hapur guidën televizive.
- Kanalet — Për të hapur listën e kanaleve.
- Media — Për të hapur luajtësin e skedarëve media për të luajtur skedarë nga USB-ja ose rrjeti.
- Cilësimet Eco — Për të hapur menynë e cilësimeve Eco.
- Demo Me — Për të menaxhuar skedarë demonstrimi.

Cilësimet e shpeshta:

- Stil i figurës me AI* / Stili i figurës — Zgjidhni një nga stilet e paracaktuara të figurës për shikim ideal të tyre.
- Format i figurës — Zgjidhni një nga formatet e paracaktuara të figurës që përshtatet me ekranin.
- IntelliSound* / Stili i zërit — Zgjidhni një nga stilet e paracaktuara të zërit për cilësime ideale zëri.
- EasyLink 2.0 — Kontrolloni dhe rregulloni cilësimet e fonisë HDMI në përputhje me EasyLink 2.0.
- Dalja e zërit — Caktoni që televizori ta luajë zërin në televizor ose në sistemin e lidhur të zërit.
- Pajisjet me Bluetooth®* — Cilësim për pajisjet me Bluetooth®.

- DTS Play-Fi* — Hapni aplikacionin "DTS Play-Fi".
- Profili i dëgjimit* — Personalizoni zërin e altoparantëve të televizorit.
- Stili Ambilight* — Zgjidhni një nga stilet e paracaktuara të "Ambilight".
- Instalo kanale — Përditësoni kanalet ose nisni një instalim krejtësisht të ri të kanaleve.
- Lidhjet me valë dhe rrjetet — Lidhni në rrjetin e shtëpisë ose rregulloni cilësimet e rrjetit.
- Ekрани fikur — Nëse dëgjoni vetëm muzikë në televizor, mund ta fikni ekranin e televizorit.
- Kohëmatësi i gjumit — Caktojeni televizorin të kalojë automatikisht në pritje pas një kohe të paracaktuar.
- Përditësim softueri — Kontrolloni për përditësime të softuerit të televizorit.

Mund të shtypni OPTIONS për të aktivizuar ose çaktivizuar artikujt nga lista Cilësimet e shpeshta.

Menyja "Të gjitha cilësimet":

Shtyp tastin 🏠 (Kreu) në telekomandë për t'u kthyer në Kryefaqe. Ju mund të aksesoni menynë Cilësimet me anë të ikonës në këndin e sipërm djathtas në Kryefaqe.

* Cilësimet e lidhura me Ambilight, Stil i figurës me AI, IntelliSound, pajisjet me Bluetooth®, DTS Play-Fi dhe Profili i dëgjimit janë vetëm për modelet që mbështesin veçoritë.

10.2. Të gjitha cilësimet

Cilësimet e figurës

Rreth menysë së cilësimeve të figurës

Menyja e cilësimeve të figurës ofron një mënyrë të thjeshtë për të aksesuar cilësimet e figurës shumëplanëshe nga të përgjithshmet te të avancuarat. Për disa cilësime të figurës, vlerat mund të ndryshohen nga menyja e veçantë, e cila ju lejon të shihni të gjitha vlerat e cilësimeve dhe të shihni paraprakisht efektet që do të aplikohen.

Në nivelin e parë të menysë së cilësimeve të figurës, mund të zgjidhni një artikull dhe të shtypni butonin OK për të shkuar te opsionet e nivelit vijues. Nëse shfaqet një meny e veçantë, mund të klikoni ose të rrëshqitni shiritin për të zgjedhur vlerat e cilësimeve dhe të shihni paraprakisht efektin, dhe më pas të shtypni OK për të konfirmuar ndryshimin. Nëse ka opsione të tjera cilësimesh në të njëjtin nivel, mund të shtypni butonin ▲ (lart) ose ▼ (poshtë) për të kaluar në opsione të tjera cilësimesh dhe të vazhdoni

përzgjedhjen në menynë e veçantë. Pasi të jenë bërë të gjitha ndryshimet e cilësimeve, mund të shtypni butonin ← **Kthehu** për t'u larguar ose për të mbyllur menytenë e cilësimeve.

Stili i figurës

Zgjedhja e një stili

Për rregullim me lehtësi të figurës mund të zgjidhni një stil të paracaktuar.

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Stili i figurës, shtypni **OK** për të kaluar në opsionin tjetër të disponueshëm.

Stilet e disponueshme të figurës janë:

- **Personal** - Preferencat e figurës që caktoni gjatë ndezjes fillestare.
- **I qartë si kristal** - Ideal për shikimin gjatë ditës.
- **Kinemaja në shtëpi** - Ideale për përvojën e përditshme të argëtimit me filma në shtëpi.
- **ECO** - Cilësimi më i favorshëm i kursimit të energjisë
- **Film** - Ideal për të parë filma me efektin origjinal të studios.
- **Lojë*** - Ideal për të luajtur lojëra.
- **Monitor**** - Ideal për afishimin e aplikacioneve kompjuterike. Videoja origjinale luhet me përpunim minimal.

* Stili i figurës - Loja disponohet vetëm në aplikacionet e videove HDMI dhe të transmetimit të videove.

** Stili i figurës - Monitori disponohet vetëm kur videoja me burim HDMI është e zbatueshme për aplikacione kompjuterike.

- Televizori mund të luajë programe HDR nga çdonjëra nga lidhjet HDMI, transmetimet, nga një burim interneti (p.sh. "Netflix") ose nga një pajisje e lidhur memorieje USB.
- Televizori do të kalojë automatikisht në modalitetin HDR me tregues. Televizori mbështet formatet e mëposhtme HDR: Hybrid Log Gamma, HDR10, por varet nëse këto formate HDR disponohen nga ofruesit e përmbajtjeve.

Për përmbajtje HDR (Hybrid Log Gamma dhe HDR10)

Stilet për përmbajtjen HDR (Hybrid Log Gamma dhe HDR10) janë:

- HDR, personal
- HDR i qartë si kristal
- Kinemaja në shtëpi HDR
- HDR ECO
- HDR, film
- HDR Lojë
- Monitor HDR

Rikthen stilin e figurës

Për ta rivendosur stilin në cilësimin fillestar, shkoni te 🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura, më pas zgjidhni Rivendos stilin e figurës.

Cilësimet e kontrastit

Ndriçimi

Optimizimi i nivelit të dritës së ambientit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Kontrasti > Ndriçimi > Optimizimi i nivelit të dritës së ambientit.

Ndize për të reduktuar automatikisht lodhjen e syve në kushte të ndryshme ndriçimi ambientit.

Kontrasti i sfondit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Kontrasti > Ndriçimi > Kontrasti i dritës së pasme.

Rregulloni vlerën e kontrastit të figurës. Mund ta ulni vlerën e kontrastit për të pakësuar konsumin e energjisë.

Modaliteti i kontrastit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Kontrasti > Ndriçimi > Modaliteti i kontrastit.

Zgjidhni Normal, I optimizuar për figurë, I optimizuar për kursim energjie për të caktuar televizorin që të reduktojë automatikisht kontrastin, për konsum më të mirë të energjisë ose për figurë optimale, ose zgjidhni Joaktiv për të çaktivizuar rregullimin.

Niveli i videos

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Kontrasti > Ndriçimi > Niveli i videos.

Rregulloni nivelin e kontrastit të videos.

Detajet e errëta

Gama

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Kontrasti > Detajet e errëta > Gama.

Për të caktuar një cilësim jolinear për dritën dhe kontrastin e figurës.

Niveli i të zezës

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Kontrasti > Dark details > Niveli i të zezës.

Për të caktuar nivelin e të zezës së figurës.

Shënim: Vendosja e nivelit të së zezës shumë larg vlerës referencë (50) mund të rezultojë në kontrast më të ulët (detaji i errët zhduket ose figura e zezë bëhet gri).

Përmirësimi i kontrastit

Niveli i përforcimit dinamik

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Kontrasti > Përmirësimi i kontrastit > Niveli i përforcimit dinamik.

Zgjidhni Joaktiv, Maksimum, Mesatar, ose Minimum për të caktuar nivelin në të cilin televizori përforcon automatikisht detajet në zonat e errëta, mesatare dhe të çelëta të figurës.

Shënim: Nuk ofrohet kur diktohet sinjal HDR. Nuk ofrohet në modalitetin Monitor.

Kontroli HDR

Cilësimet e efektit HDR

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Kontrasti > Kontrolli HDR > Efekti HDR10/Efekti HLG.

Mund të rregulloni nivelin e efektit HDR në Joaktiv, Më shumë detaje, I balancuar ose Më shumë ndriçim për përmbajtjet HDR.

Cilësimet e ngjyrave

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Ngjyra.

Ngopja

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Ngjyra > Ngopja.

Për të rregulluar vlerën e fortësisë së ngjyrave.

Shënim: nuk disponohet kur stili i figurës është Monitor or Monitor HDR.

Rregullimi i përforcimit të ngjyrave

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Ngjyra > Përforcimi i ngjyrave.

Zgjidhni Maksimum, Mesatar, Minimum ose joaktiv për të caktuar nivelin e intensitetit të ngjyrës dhe të detajeve në ngjyrat e ndezura.

Shënim: nuk disponohet kur stili i figurës është Monitor / Monitor HDR

Rregullimi i gamës së gjerë të ngjyrave

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Ngjyra > Gama e gjerë e ngjyrave.

Për të aktivizuar/çaktivizuar gamën e gjerë të ngjyrave. Vlen vetëm për disa modele televizorësh.

Rregullimi i temperaturës së ngjyrave

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Ngjyra > Temperatura e ngjyrës > Pika e bardhë.

Zgjidhni E ngrohtë, Normale, E ftohtë ose E personalizuar për të caktuar temperaturën e preferuar të ngjyrave.

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Ngjyra > Temperatura e ngjyrës > Kalibrimi me 2 pika të bardha.

Personalizo kalibrimin e pikës së bardhë sipas temperaturës së ngjyrës të zgjedhur në figurë.

Qartësia

pikës së bardhë

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Qartësia > Përmirësimi.

Për të rregulluar vlerën e qartësisë së figurës.

Përforcimi i teksturës

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Qartësia > Përforcimi i teksturës.

Aktivizoni për një qartësi të lartë në skajet dhe detajet e linjave.

Zhurma e figurës

Pakësim i zhurmës

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Zhurma e figurës > Reduktimi i zhurmës

Zgjidhni Joaktiv, Maksimum, Mesatar, ose Minimum për të caktuar nivelin për heqjen e zhurmës në përmbajtjen e videove. Zhurma ka pamjen e pikave të vogla lëvizëse në figurën në ekran.

Reduktimi i artefakteve

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Zhurma e figurës >

Reduktimi i artefakteve

Zgjidhni **Joaktiv**, **Maksimum**, **Mesatar**, ose **Minimum** për shkallë të ndryshme të zbutjes së kuadratizimeve në përmbajtjen e videove dixhitale. Kuadratizimet kanë pamjen e blloqeve të vogla ose të skajeve të dhëmbëzuara në figurat e ekranit.

* Shënim: Cilësimet **Reduktimi i Artefaktit** nuk disponohen kur burimi i hyrjes është rezolucion 4K.

Cilësimet e shpejta të figurës

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Figura](#) > [Cilësimet e shpejta të figurës](#)

- Gjatë instalimit për herë të parë, caktuat disa cilësime figure duke ndjekur disa hapa të lehtë. Këta hapa mund t'i ribëni me menynë [Cilësimet e shpejta të figurës](#).
- Zgjidhni cilësimin e figurës që preferoni dhe vazhdoni te cilësimi vijues.
- Për ta realizuar këtë, sigurohuni që televizori mund të sintonizohet me një kanal televiziv ose mund të shfaqë programe nga një USB e lidhur.

Cilësimet e ekranit

Formati i figurës

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Ekran](#) > [Formati i figurës](#)

Nëse figura nuk e mbush të gjithë ekranin dhe nëse shiritat e zinj shfaqen sipër, poshtë ose në të dyja anët, mund ta rregulloni figurën që ta mbushë plotësisht ekranin.

Për të zgjedhur një nga cilësimet bazë për të mbushur ekranin...

- **Ekran i gjerë** – e zmadhon automatikisht figurën në ekran të plotë 16:9. Formatin e kuadrit të përmbajtjes së figurës mund të ndryshojë.
- **Mbush ekranin** – e zmadhon automatikisht figurën që të mbushë ekranin. Deformimi i figurës është minimal, titrat mbeten të dukshme. Nuk është i përshtatshëm për hyrje nga kompjuteri. Disa formate ekstreme figure mund të vazhdojnë të shfaqin shirita të zinj. Formatin e kuadrit të përmbajtjes së figurës mund të ndryshojë.
- **Përshtat sipas ekranit** – e zmadhon automatikisht figurën, pa e deformuar, që të mbushë ekranin. Shiritat e zinj mund të jenë të dukshëm. Nuk është i përshtatshëm për hyrje nga kompjuteri.
- **Original** – e zmadhon automatikisht figurën për t'u përshtatur sipas ekranit në formatin origjinal të kuadrit. Nuk humbet asnjë përmbajtje të dukshme.

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Ekran](#) > [Formati i figurës](#) > [I avancuar](#)

Për të formatuar manualisht figurën...

- **Zhvendosje** – zgjidhni mbi shigjetat për ta zhvendosur figurën. Mund ta zhvendosni figurën vetëm kur është e zmadhuar.
- **Zmadhim** – zgjidhni mbi shigjetat për ta zmadhuar.
- **Zgjate** – zgjidhni mbi shigjetat për ta zgjatur figurën vertikalisht ose horizontalisht.
- **Zhbërje** – zgjidhni për t'u kthyer te formati i figurës me të cilin filluat.

Disa zgjedhje të cilësimit të formati të figurës mund të mos disponohen në disa kushte. Për shembull, në transmetimin e videove, aplikacionet "Android", modalitetin e lojërave etj.

Cilësimet e zërit

Stili i tingullit

Zgjedhja e një stili

Për rregullim të lehtë të zërit, mund të zgjidhni një cilësim të paracaktuar.

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Tingulli](#) > [Stili i zërit](#)

Stilet e disponueshme të zërit janë:

- **Argëtim** — Ideal për shikimin e filmave
- **Muzikë** — Ideal për të dëgjuar muzikë
- **Dialog** — Ideal për ligjërime
- **Personal** — Zgjidhni për të rregulluar cilësimet e preferuara të zërit

Cilësimet personale të zërit

Nxitje vokale

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Zëri](#) > [Cilësimet personale](#) > [Nxitje vokale](#)

Rregulloni sasinë e përmbajtjes së dialogut.

Balancuesi

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Zëri](#) > [Cilësimet personale](#) > [Balancuesi](#)

Shtypni butonat me shigjeta/të navigimit për të rregulluar cilësimet e balancuesit.

Rikthe të gjitha në vlerat standarde

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Zëri](#) > [Cilësimet personale](#) > [Rikthe të gjitha në vlerat standarde](#)

Rivendosni të gjitha cilësimet personale në cilësimet fillestare të fabrikës.

EasyLink 2.0

Kontrolli i cilësimeve të zërit të sistemit të fonisë HDMI me anë të EasyLink 2.0

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Tingulli > EasyLink 2.0.

YJu mund të përshtatni cilësimet individuale të zërit të sistemit të fonisë HDMI Cilësimet e shpeshta ose Cilësimet > Tingulli > EasyLink 2.0. Kjo është e zbatueshme vetëm me sistemin e fonisë HDMI që përputhet me EasyLink 2.0. Opsionet e cilësimit janë të ndryshme në varësi të mënyrës se si mund të mbështesë sistemi i zërit Easylink 2.0 HDMI.

Përshtatja e nivelit të basit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Tingulli > EasyLink 2.0 > Basi.

Shtyp tastet Shigjeta / navigimi për të rregulluar nivelin e basit. Opsioni disponohet kur Stili i zërit nuk është caktuar në I personalizuar.

Përshtatja e nivelit të altos

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Tingulli > EasyLink 2.0 > Alto.

Shtyp tastet Shigjeta / navigimi për të rregulluar nivelin e altos. Opsioni disponohet kur Stili i zërit nuk është caktuar në I personalizuar.

Barazuesi i personalizimit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Tingulli > EasyLink 2.0 > Barazuesi i personalizimit.

Brezat e frekuencës që përshtaten kur Stili i zërit është caktuar te I personalizuar. Shtypni butonat me shigjeta/të navigimit për të rregulluar nivelin e Balancuesit AI. Ky cilësim disponohet vetëm kur pajisja e lidhur është e përputhshme me televizorin për këtë funksion.

Tingulli rrethues

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Zëri > EasyLink 2.0 > Zë rrethues / Modalitet rrethues

Zgjidhni një efekt zëri rrethues nga llojet e paracaktuara*.

- Shtim – Shtim i zërit, për të shfrytëzuar plotësisht të gjithë altoparlantët.
- Standard – Dalja e altoparlantëve ndjek kanalet origjinale.
- AI i zërit rrethues – Efekt optimal i zërit rrethues duke përdorur analizën e AI.

* Disa prej sistemeve të zërit HDMI Easylink 2.0 mbështetin vetëm Modalitet rrethues për të aktivizuar

ose çaktivizuar efektin e zërit rrethues virtual.

DRC

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Tingulli > EasyLink 2.0 > DRC.

Zgjidh kontrollin e preferuar të diapazonit dinamik (DRC).

- Automatik – Diapazoni dinamik përshtatet në mënyrë automatike.
- Aktiv – Optimizon diapazonin dinamik.
- Joaktiv – Çaktivizon përshtatjen e diapazonit dinamik

Altoparlantët e lartësisë

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Tingulli > EasyLink 2.0 > Altoparlantët e lartësisë.

Zgjidhni lëvizjen e preferuar të altoparlantëve të lartësisë. Ky cilësim disponohet vetëm kur pajisja e lidhur është e përputhshme me televizorin për këtë funksion.

- Automatik – Lëvizja dinamike ndjek përmbajtjet.
- Aktiv – Gjithmonë ngritur.
- Joaktiv – Pozicioni i ulur.

Zgjedhja e shkallës së zërit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Tingulli > EasyLink 2.0 > Shkalla e zërit.

Zgjidhni një përjetim për dëgjimin. Ky cilësim disponohet vetëm kur pajisja e lidhur është e përputhshme me televizorin për këtë funksion.

- Automatik – Cilësimi dinamik ndjek përmbajtjet.
- Aktive – Shkallë zëri përfshirëse. E përshtatshme për të parë filma.
- Fikur – Faza e tingujve të qartë kristal. E përshtatshme për të dëgjuar muzikë dhe dialogë.

Basi

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Zëri > EasyLink 2.0 > Basi.

Rregulloni nivelin e basit.

Dolby Atmos

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Zëri > EasyLink 2.0 > Dolby Atmos.

Rregulloni nivelin e volumit të Dolby Atmos.

DTS TruVolume

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Zëri > EasyLink 2.0 > DTS TruVolume.

Zgjidhni nivel të qëndrueshëm volumi.

Modaliteti i natës

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Zëri > EasyLink 2.0 > Modaliteti i natës.

Zgjidhni nivel dëgjimi të qetë e komod.

Volum automatik

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Zëri > EasyLink 2.0 > Volum automatik.

Kontrolloni nivelin e dëgjimit të zërit.

Ekрани

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Zëri > EasyLink 2.0 > Ekрани.

Caktojeni për të fikur automatikisht ekranin.

Rikthe të gjitha në vlerat standarde

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Tingulli > EasyLink 2.0 > Rikthe të gjitha në standard.

Rikthen të gjitha cilësimet e zërit të EasyLink 2.0 në cilësimet fillestare të fabrikës.

Vendosja televizive

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Tingulli > Vendosja e televizorit

Zgjidhni Në bazament ose Në murpër riprodhimin më të mirë të zërit sipas cilësimet.

Cilësimet e avancuara të zërit

Kontrolli i volumit

Volum automatik

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Tingulli > I avancuar > Volumi automatik

Zgjidhni Aktiv për të balancuar automatikisht ndryshimet e befta të volumit. Zakonisht kur ndërroni kanalet. Zgjidhni Modaliteti i natës për një përvojë më të rehatshme dhe të qetë dëgjimi.

Volumi me koeficient

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Tingulli > I

avancuar > Volumi individual

Cilësimi i volumit individual mund të përdoret për të rregulluar balancin e ndryshimit të nivelit të zërit ndërmjet kanalit televiziv dhe hyrjes së burimit HDMI. Shtyp tastet **Shigjeta / navigimipër** të rregulluar volumin e altoparlantëve të televizorit

* Shënim: Volumi individual disponohet kur burimi i hyrjes është caktuar në HDMI ose në burime analoge dhe dalja e audios është caktuar në **Altoparlantët e televizorit** ose **Sistemi i zërit HDMI**.

Cilësimet e daljes së zërit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Tingulli > I avancuar > Dalja e audios

Caktoje televizorin që ta luajë zërin në televizor ose në sistemin e lidhur audio.

Mund të zgjidhni se ku dëshironi ta dëgjoni zërin e televizorit dhe si dëshironi ta komandoni.

- Nëse zgjidhni opsionin **Altoparlantët e televizorit**, altoparlantët do të qëndrojnë gjithnjë aktivë. Për këtë modalitet zbatohen të gjitha cilësimet e lidhura me zërin.

- Nëse zgjidhni **Wired headphones**, zëri do të luhet përmes kufjeve.

- Nëse zgjidhni **Optike**, altoparlantët e televizorit fiken dhe tingulli do të luhet përmes pajisjes së lidhur me Dalja e zërit dixhital - Optike.

- Nëse zgjidhni **Altoparlantët e televizorit + Kufje me tel**, zëri do të luhet përmes altoparlantëve të televizorit dhe kufjeve.

Me pajisjen e zërit të lidhur me "HDMI CEC", zgjidhni **Fonia HDMI**. Televizori çaktivizon altoparlantët e vet kur luhet zë nga pajisja.

Për të rregulluar volumin e altoparlantëve të televizorit dhe kufjeve, shtypni **Volumi** dhe shtypni shigjetat **>** (djathtas) ose **<** (majtas) për të zgjedhur burimin e daljes që dëshironi të rregulloni.

Shtypni **Volumi +** ose **-** për të rregulluar nivelin e volumit të burimit të zgjedhur të daljes.

Cilësimet e daljes dixhitale

Cilësimet e daljes dixhitale ofrohen për sinjale zëri dalëse SPDIF (optike) dhe HDMI ARC.

Formati i daljes dixhitale

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Tingulli > I avancuar > Format i daljes dixhitale

Caktoni sinjalin e daljes së zërit të televizorit që të përshtatet me kapacitetet e zërit të sistemit të lidhur të kinemasë.

- **Stereo (i pakompresuar)**: Nëse pajisjet e luajtjes së zërit nuk kanë procesim zëri shumëkanalësh, zgjidhni

të dalin vetëm materiale stereo në pajisjet e luajtjes së zërit.

- **Shumëkanalësh:** Zgjidhni të nxirrni vetëm material zanor shumëkanalësh (sinjal i kompresuar zëri shumëkanalësh) në stereo pajisjet e luajtjes së zërit.
- **Shumëkanalësh (shmangie):** Zgjidhni për të dërguar transmetimin origjinal të biteve nga HDMI ARC në sistemin të zërit të lidhur me HDMI.

- Sigurohuni që pajisjet e luajtjes së zërit të mbështesin funksionin "Dolby Atmos".

- Dalja SPDIF (DIGITAL AUDIO OUT - Dalja e zërit dixhital) do të çaktivizohet gjatë transmetimit të materialeve "Dolby Digital Plus".

Nivelimi i daljes dixhitale

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Tingulli > I avancuar > Nivelimi i daljes dixhitale

Rregulloni nivelin e lartësisë së zërit nga pajisja e lidhur me daljen e zërit dixhital (SPDIF) ose HDMI.

- Zgjidhni **Më shumë** për një volum më të lartë.
- Zgjidhni **Më pak** për një volum më të lehtë.

Vonesa e daljes dixhitale

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Tingulli > I avancuar > Vonesa e daljes dixhitale

Për disa sisteme kinemaje mund të nevojitet rregullimi i vonesës së sinkronizimit të audios për të kryer sinkronizimin e zërit me figurën. Zgjidhni **Joaktiv** nëse është caktuar vonesë zëri në sistemin e kinemasë.

Shmangia e daljes dixhitale (mundësohet vetëm kur "Vonesa e daljes dixhitale" është caktuar "Aktive")

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Tingulli > I avancuar > Shmangia e daljes dixhitale

- Nëse nuk mund ta caktoni vonesën në sistemin Kinemaja në shtëpi, mund të caktoni televizorin që të sinkronizojë zërin.
- Mund të caktoni një zhvendosje që kompenson kohën që i nevojitet sistemit Kinemaja në shtëpi për përpunimin e zërit të figurës së televizorit.
- Mund ta caktoni vlerën nga 0 deri në 60 ms.

"Ambilight"

Stili i Ambilight

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Ambilight > Stili i Ambilight

Mund të zgjidhni mënyrën e ndjekjes së "Ambilight" ose të zgjidhni **Joaktiv** për ta çaktivizuar atë.

Zgjidhni një nga stilet që ndjekin dinamikën e figurës në ekranin e televizorit.

- **AI** – Zgjidhni AI për ndërrimin inteligjent të stilit Ambilight bazuar në përmbajtjen video.
- **Standard** – Ideal për shikim të përditshëm televizori.
- **Sporte** – Ideal për programet sportive.
- **Kinema** – Ideal për filma dhe argëtim në shtëpi.
- **Luajtja e lojërave** – Ideal për të luajtur lojëra.
- **Muzikë** – Për dëgjim muzike dhe ndjekje të dinamikave në sfond.
- **Ngjyrë fikse** – Zgjidhni një ngjyrë statike që dëshironi.
- **Mbështetni ekipin tuaj** – Zgjidhni një flamur ekipi që shkëlqen përmes Ambilight.

Ndjekja e aplikacionit

Ky funksion disponohet vetëm kur kontrolloni Ambilight me aplikacionin **Philips Smart TV**.

Personalizimi i Ambilight

Personalizimi i Ambilight

🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Ambilight > Personalizimi i Ambilight / Personalizimi i Ambilight (stili aktual i zgjedhur)

Mund të personalizoni stilin aktual sipas preferencave tuaja.

- **Përshtatësja e dhomës eko** – Aktivizoni ose çaktivizoni rregullimin automatik të ndriçimit sipas kushteve të dhomës.
- **Ndriçimi** – Për të caktuar nivelin e ndriçimit të Ambilight.
- **Ngopja** – Për të caktuar nivelin e ngopjes së Ambilight.
- **Dinamik** – Për të caktuar shpejtësinë e efektit dinamik të Ambilight.
- **Ambilight në përmbajtje të errët** – Zgjidhni ndriçimin minimal të Ambilight ndërsa shfaqet përmbajtje e errët.

Cilësimet e personalizuar për ngjyrën fikse dhe stilin e muzikës

Kur 🏠 (Kreu) > Cilësimet > Ambilight > Stili i Ambilight caktohet në **Ngjyrë fikse**, mund të personalizoni stilin:

- **Zgjedhja e ngjyrës fikse** – Zgjidhni ngjyrën tuaj të preferuar statike nga paleta e ngjyrave dhe sintonizojeni përmes shiritave të ngjyrave sipas preferencës suaj.
- **Efektet dinamike** – Shtoni efekte dinamike në

ngjyrën e zgjedhur.

Kur **🏠 (Kreu)** > Cilësimet > Ambilight > Stili Ambilight caktohet në Muzikë, mund të zgjidhni profile të paracaktuara muzike të Ambilight nga **Zgjedhja e stilit muzikor**:

- Lumina – Ideale për të parë video muzikore.
- Disko – Ideale për të dëgjuar muzikë retro me zë të lartë.
- Ritëm – Ideale për të dëgjuar muzikë ritmike.

Rikthe të gjitha në vlerat standarde

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Ambilight > Personalizimi i Ambilight / Personalizimi i Ambilight (stili aktual i zgjedhur) > Rivendos të gjitha në vlerat standarde

Rivendosni të gjitha cilësimet e personalizimit të Ambilight në cilësimet fillestare të fabrikës.

Ambilight Suite

Hyrje

Ambilight Suite është një qendër e integruar kontrolli për të përdorur komplet veçorinë Ambilight në jetën tuaj të përditshme. Shtypni tastin **☰ Menyja e shpejtë/MENYJA** në telekomandë për të gjetur Menyja e shpejtë, zgjidhni **Ambilight Suite** dhe shtypni **OK** për të hapur qendrën e kontrollit. Në të kundërt, mund të shkoni te **🏠 (Kreu)** > Cilësimet > Ambilight > Ambilight Suite dhe të shtypni **OK** për të hapur Ambilight Suite.

Ambilight Suite mund të kalojë midis stileve **Sallon**, **Gjumë** dhe **Lindje dielli** për skenarë të ndryshëm; çdo stil ka zërat e vetë të cilësimit të shpejtë për të rregulluar cilësimet sipas nevojës.

Sallon

Modaliteti "Sallon"

Modaliteti "Sallon" i televizorit ju lejon të ndizni Ambilight kur televizori është në gjendje gatishmërie. Kështu mund të ndriçoni dhomën me "Ambilight". Mund të zgjidhni një temë nga ikonat e poshtme me ngjyra të ndryshme të paracaktuara të Ambilight ose të personalizoni temën tuaj për të gjallëruar atmosferën e dhomës dhe për t'u relaksuar.

Zgjidhni një nga ngjyrat e paracaktuara nga ikonat e poshtme dhe shtypni **OK** për të rregulluar cilësimet e detajuara të ngjyrës së zgjedhur.

Nis tani

Për të nisur menjëherë modalitetin "Sallon" me ngjyrën e zgjedhur Ambilight.

Ngjyra

Opsioni disponohet vetëm kur zgjidhet "Ngjyrë personale". Mund të zgjidhni ngjyrën tuaj të preferuar për "Drita e sallanit" nga paleta e ngjyrave dhe ta sintonizoni përmes shiritave të ngjyrave sipas preferencës suaj.

Efektet dinamike

Aktivizoni efektet dinamike për ngjyrën e zgjedhur Ambilight.

Ndriçimi

Zgjedhja e nivelit të ndriçimit të "Lounge light".

Kohëzgjatja

Caktoni kohëzgjatjen (në minuta) të modalitetit "Sallon".

Cakto si standard

Caktoni ngjyrën aktuale të zgjedhur Ambilight dhe cilësimet përkatëse si cilësim standard të modalitetit "Sallon".

Gjumë

Modaliteti i gjumit

Modaliteti i gjumit simulon përdimin e diellit për t'ju ndihmuar të qetësoheni para se të flini. Në fund të simulimit, televizori do të kalojë automatikisht në gjendje gatishmërie. Mund të zgjidhni një temë me ngjyrë Ambilight dhe tingull natyre ose të personalizoni temën tuaj për ta përgjumur veten.

Zgjidhni një nga temat e paracaktuara nga ikonat e poshtme dhe shtypni **OK** për të rregulluar cilësimet e detajuara të temës së zgjedhur.

Nis tani

Për të nisur menjëherë modalitetin e gjumit me temën e zgjedhur.

Ngjyra

Rregulloni ngjyrën Ambilight të temës së zgjedhur.

Efektet dinamike

Aktivizoni efektet dinamike për ngjyrën e zgjedhur Ambilight.

Ndriçimi

Caktoni ndriçimin fillestar të modalitetit të gjumit.

Kohëzgjatja

Caktoni kohëzgjatjen (në minuta) të modalitetit të gjumit.

Cakto si standard

Caktoni temën aktuale të zgjedhur dhe cilësimet përkatëse si cilësim standard të modalitetit të gjumit.

Lindje dielli

Alarmi i lindjes së diellit

Alarmi i lindjes së diellit përdor "Ambilight", muzikën dhe informacione për motin për një përvojë të re zgjimi.

- Televizori zgjohet në orën dhe ditën e zgjedhur nga ju.
- Ndiz Ambilight me ekran dhe muzikë me ngjyra të zbehura.
- Kaloni ngadalë në parashikimin e motit me sfond të përputhshëm.

Nga ikonat e poshtme, zgjidhni ikonën **Shto alarm** për të caktuar një alarm të ri, zgjidhni ikonën **Cilësimet** për të rregulluar cilësimet e alarmit, zgjidhni një alarm tashmë të vendosur për të kontrolluar detajet e cilësimit.

Cakto alarmin

Për të aktivizuar ose çaktivizuar alarmin.

Koha

Cakto orën e alarmit.

Përsërit

Caktoni që të aktivizohet alarmi në mënyrë të përsëritur.

Tema e sfondit

Caktoni që të tregojë parashikimin e motit ose zgjidhni nga kategoritë e fotografive.

Muzikë

Caktoni këngën që luhet gjatë zgjimit.

Aktivizo volumin

Caktoni volumin e muzikës gjatë zgjimit.

Shih paraprakisht

Shihni paraprakisht efektin e zgjimit.

Nëse televizori është në gjendje gatishmërie dhe arrihet koha e alarmit, televizori do të zgjohet nga gjendja e gatishmërisë. Aktivizimi i ngadaltë i ekranit të zgjimit, Ambilight është aktiv, muzika aktivizohet ngadalë dhe më pas shfaqen informacione për motin me sfondin.

Për të dalë nga alarmi i lindjes së diellit, shtypni **Në gatishmëri / Aktive**, **← Kthehu** ose tastin **🏠 (Kreu)** në telekomandë.

- **🔔 Në gatishmëri / Aktive**: del nga "Alarmi i lindjes së diellit" dhe e kalon televizorin në gjendje gatishmërie.
- **← Pas** : del nga "Alarmi i lindjes së diellit" dhe kalon te burimi i televizorit i shikuar së fundi.
- **🏠 (Kreu)**: del nga "Alarmi i lindjes së diellit" dhe kalon te hapësi.
- Nëse nga "Alarmi i lindjes së diellit" nuk kalohet në një aplikacion tjetër brenda 30 minutash nga zgjimi i lindjes së diellit, televizori do të fiket automatikisht në gjendje gatishmërie.

Shënim:

Mbajeni aktive lidhjen me internetin në mënyrë që alarmi i "Sunrise" të funksionojë siç duhet. Alarmi i lindjes së diellit nuk mund të funksionojë kur modaliteti i orës së televizorit është caktuar në manual. Shkoni te menyja e cilësimeve dhe ndryshoni modalitetin e orës në automatik. Alarmi nuk do të funksionojë nëse "Vendndodhja" është caktuar në "Dyqan".

Mbështetni ekipin tuaj

Mund të caktoni që Ambilight të ndjekë flamurin e ekipit që zgjidhni.

Për të caktuar flamurin e ekipit në cilësimin e Ambilight:

- 1 - Shtypni tastin **AMBILIGHT**.
- 2 - Zgjidhni **Mbështetni ekipin tuaj** dhe shtypni **OK**.
- 3 - Zgjidhni një flamur ekipi dhe shtypni **OK** që ekipi juaj të shfaqet përmes TV Ambilight.

4 - Shtypni ← Prapa për të dalë pse për të ruajtur zgjidhjen tuaj.

Cilësimet e avancuara të "Ambilight"

Ngjyra e murit pas televizorit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Ambilight > I avancuar > Ngjyra e murit pas televizorit

- Neutralizoni ndikimin e një muri me ngjyra në ngjyrat Ambilight
- Zgjidhni ngjyrën e murit pas televizorit dhe televizori do t'i ndryshojë ngjyrat e "Ambilight" për t'u shfaqur siç janë synuar.

Zbehe deri në fund

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Ambilight > I avancuar > Fikja graduale

Caktoje Ambilight që të çaktivizohet menjëherë ose të fiket ngadalë kur fiket televizori. Fikja graduale ju jep kohë për të ndezur dritat në dhomën e ndenjes.

Nisja automatike e dritës së sallorit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Ambilight > I avancuar > Nisja automatike e dritës së sallorit

Aktivizoni dritën e sallorit automatikisht pasi televizori kalon në gjendje gatishmërie.

Me valë dhe rrjetet

Rrjeti i shtëpisë

Për të përdorur të gjitha funksionalitetet e "Smart TV Philips", ky i fundit duhet të jetë i lidhur me internetin.

Lidhni televizorin me një rrjet shtëpie me lidhje interneti të shpejtësisë së lartë. Televizori mund ta lidhni me rrugëzuesin e rrjetit me anë të valëve ose me tel.

Lidhu në rrjet

Lidhja me valë

Çfarë ju duhet

Për të lidhur me valë televizorin me internetin nevojitet një rrugëzues Wi-Fi me lidhje në internet. Përdorni lidhje të shpejtësisë së lartë (brezgjerë) me internetin.



Kryerja e lidhjes - Me valë

🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Lidhjet me valë dhe rrjetet > Me tel ose "Wi-Fi" > Lidhja me rrjetin > Me valë (Wi-Fi)

1 - Në listën e rrjeteve të gjetura zgjidhni emrin e rrjetit tuaj me valë. Nëse rrjeti nuk gjendet në listë pasi emri është i fshehur (keni çaktivizuar transmetimin e SSID së rrugëzuesit), zgjidhni funksionin "Shto rrjet të ri" për ta shkruar vetë emrin e rrjetit.

2 - Vendos kodin e enkriptimit. Nëse e keni dhënë më parë kodin e enkriptimit për këtë rrjet, mund të zgjidhni OK për ta kryer menjëherë lidhjen.

3 - Pasi lidhja të kryhet me sukses do të shfaqet një mesazh.


Ndezja ose fikja e Wi-Fi

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Lidhjet me valë dhe rrjetet > Me tel ose me Wi-Fi > Wi-Fi aktiv/joaktiv

Lidhja me tel

Çfarë ju duhet

Për të lidhur televizorin me internetin, nevojitet një rrugëzues rrjeti me lidhje me internetin. Përdorni lidhje të shpejtësisë së lartë (brezgjerë) me internetin.



Kryerja e lidhjes

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Lidhjet me valë dhe rrjetet > Me tel ose me Wi-Fi > Lidhja me rrjetin > Me tel

1 - Lidhni rrugëzuesin me televizorin me kabllo rrjeti

(kabllo "Ethernet").

2 - Sigurohuni që rrugëzuesi të jetë ndezur.

3 - Televizori kërkon vazhdimisht për lidhje në rrjet.

4 - Pasi lidhja të kryhet me sukses do të shfaqet një mesazh.

Nëse lidhja nuk arrihet, mund të kontrolloni konfigurimin e DHCP së rrugëzuesit. DHCP duhet të jetë aktive.

**Për zbatimin e rregulloreve EMC, përdorni një kabllo të izoluar "FTP Cat. 5E Ethernet".

Cilësimet e lidhjes me valë dhe të rrjeteve

Kontrollo rrjetin

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Lidhjet me valë dhe rrjetet > Me tel ose me Wi-Fi > Kontrollo rrjetin

Kontrolloni gjendjen e lidhjes së rrjetit.

Shiko Cilësimet e rrjetit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Lidhjet me valë dhe rrjetet > Me tel ose me Wi-Fi > Shiko cilësimet e rrjetit

Këtu mund të shikoni të gjitha cilësimet aktuale të rrjetit. Adresa IP dhe MAC, fuqia e sinjalit, shpejtësia, mënyra e enkriptimit etj.

Konfigurimi i rrjetit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Lidhjet me valë dhe rrjetet > Me tel ose me Wi-Fi > Konfigurimi i rrjetit

Nëse jeni përdorues i avancuar dhe dëshironi ta instaloni rrjetin me adresë statike IP, caktojini televizorin në IP statike.

Konfigurimi i IP-së statike

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Lidhjet me valë dhe rrjetet > Me tel ose me Wi-Fi > Konfigurimi i IP-së statike

1 - Zgjidhni Konfigurimi i IP statike dhe konfiguroni lidhjen.

2 - Mund të caktoni numrin për Adresën e IP, Maskës së rrjetit, Portëkalimit, DNS 1, ose DNS 2.

Ndiz me LAN

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Lidhjet me valë dhe rrjetet > Me tel ose me Wi-Fi > Ndiz me LAN

Nëse është në gjendje pritjeje, televizorin mund ta ndizni nga celulari inteligjent ose tableta. Cilësimi Ndiz

me LAN duhet të aktivizohet.

Aktivizoni me pajisjet shtëpiake

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Lidhjet me valë dhe rrjetet > Me tel ose me "Wi-Fi" > Aktivizoni me pajisjet shtëpiake

Lejoni që pajisjet shtëpiake të ndezin televizorin nga gjendja e pritjes. Kjo mund të ndikojë në konsumin e energjisë nga televizori gjatë gjendjes së pritjes.

Riprodhimi dixhital i mediave - DMR

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Lidhjet me valë dhe rrjetet > Me tel ose Wi-Fi > Riprodhuesi i mediave dixhitale - DMR

Nëse skedarët media nuk luhen në televizor, sigurohuni që "Riprodhuesi i multimedive dixhitale" është aktiv. Si cilësim fabrike, DMR është aktiv.

Ndezja e lidhjes Wi-Fi

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Lidhjet me valë dhe rrjetet > Me tel ose me Wi-Fi > Wi-Fi aktiv/joaktiv

Mund ta aktivizoni ose çaktivizoni lidhjen Wi-Fi në televizor.

Emri i rrjetit televiziv

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Lidhjet me valë dhe rrjetet > Me tel ose me Wi-Fi > Emri i rrjetit televiziv

Nëse keni më shumë se një televizor në rrjetin e shtëpisë, mund t'i jepni një emër unik këtij televizori.

Kushtet e përdorimit

🏠 (kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Kushtet e përdorimit

Mund t'i shikoni përmbajtjet e Kushteve të përdorimit, të cilat shfaqen kur e lidhni televizorin për herë të parë me internetin.

Cilësimet e privatësisë

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Cilësimet e privatësisë

Mund t'i shikoni përmbajtjet e Cilësimeve të privatësisë, të cilat shfaqen kur e lidhni televizorin për herë të parë me internetin.

Cilësimet për "Netflix"

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Lidhjet me valë dhe rrjetet](#) > [Me tel ose me Wi-Fi](#) > [Cilësimet e Netflix](#)

Me cilësimet e Netflix, mund të shikoni numrin ESN ose të çaktivizoni një pajisje me Netflix.

Spastrimi i memories së internetit

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Lidhjet me valë dhe rrjetet](#) > [Me tel ose me Wi-Fi](#) > [Spastrimi i memories së internetit](#)

Me spastrimin e memories së internetit do të spastroni regjistrimin e serverit "Philips" dhe cilësimet e klasifikimit prindëror, identifikimet në aplikacionet e videotekave, të gjitha funksionet e "Philips App Gallery", faqeshënuesit dhe historikun e internetit. Aplikacionet interaktive MHEG mund të ruajnë në televizor edhe të ashtuquajturit "skedarë personalizimi". Edhe këta skedarë do të spastrohen.

Kontrulli i televizorit me Matter

Lidhni televizorin me rrjetin e shtëpisë inteligjente Matter

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Lidhjet me valë dhe rrjetet](#) > [Me tel ose me Wi-Fi](#) > [Kontrulli i televizorit me Matter](#)

Matter shërben si themeli për pajisjet e lidhura dhe si protokoll për të lidhur pajisjet dhe sistemet e përputhshme. Mund të shtoni televizorin tuaj në rrjetin e shtëpisë inteligjente Matter duke skanuar kodin QR ose duke vendosur kodin e konfigurimit.

Cilësimet e përgjithshme

Cilësimet në lidhje me lidhjet

Cilësimet e tastierës USB

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Cilësimet e përgjithshme](#) > [Cilësimet e tastierës USB](#)

Për të instaluar tastierën USB, ndizni televizorin dhe lidhni tastierën USB me një nga lidhjet USB në televizor. Kur televizori e dikton tastierën për herë të parë, mund të zgjidhni modelin e saj dhe të testoni zgjedhjen tuaj.

Cilësimet e mausit

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Cilësimet e përgjithshme](#) > [Cilësimet e mausit](#)

Rregullimi i shpejtësisë së lëvizjes së mausit USB.

Ndezja/fikja dhe energjia

Caktimi i "Sjellja për të qëndruar ndezur"

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Cilësimet e përgjithshme](#) > [Ndezja/fikja dhe energjia](#) > [Mënyra e ndezjes](#)

Caktoni televizorin që të qëndrojë te Kryefaqja ose te Burimi i fundit kur të ndizet.

Caktimi i ekranit fikur për të kursyer konsumin e energjisë

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Cilësimet e përgjithshme](#) > [Ndezja/fikja dhe energjia](#) > [Ekran i fikur](#)

Zgjidhni Ekran i fikur, ekran i televizorit është i fikur, për të ndezur përsëri ekranin e televizorit, shtypni çdo buton (përveç **AMBILIGHT**, **🔊** Volumi + ose - , Luaj **▶**, Pushim **⏸** dhe tastit 123) në telekomandë.

Caktimi i televizorit që të kalojë automatikisht në pritje pas një kohe të paracaktuar

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Cilësimet e përgjithshme](#) > [Ndezja/fikja dhe energjia](#) > [Kohëmatësi i gjumit](#)

Caktojini televizorin të kalojë automatikisht në pritje pas një kohe të paracaktuar. Mund ta caktoni kohën deri në 180 minuta në intervale prej 10 ose 30 minutash. Nëse caktohet në Joaktiv, kohëmatësi çaktivizohet. Mund ta fikni gjithmonë më herët televizorin ose të ricaktoni kohën gjatë numërimit mbrapsht.

Caktimi i fikjes me orar të televizorit

[🏠 \(kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Cilësimet e përgjithshme](#) > [Ndezja/fikja dhe energjia](#) > [Kohëmatësi i fikjes](#)

Zgjidhni kohëmatësin e gjendjes joaktive dhe televizori do të fiket automatikisht për të kursyer energji. Vlera e cilësimit Joaktiv çaktivizon fikjen automatike.

- Televizori do të fiket nëse merr sinjal televiziv, por nuk shtypni ndonjë tast në telekomandë gjatë një periudhe 4-orëshe.
- Televizori fiket nëse nuk merr sinjal televiziv apo komandë nga telekomanda për 10 minuta.
- Nëse e përdorni televizorin si monitor ose nëse për të parë televizor përdorni një marrës dixhital (një dekodues - STB) dhe nuk e përdorni telekomandën e televizorit, duhet ta çaktivizoni këtë fikje automatike për të caktuar vlerën në Joaktive.

Caktoni fikjen automatike të kohëmatësit kur televizori nuk ka sinjal

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Cilësimet e përgjithshme](#) >

Ndezja/fikja dhe energjia > Nuk ka kohëmatës të sinjalit

Televizori do të fiket automatikisht nëse nuk ka sinjal të disponueshëm pas 10/15/20 minutash.

Lidhja HDMI-CEC - EasyLink

Lidhni pajisje që mbështesin "HDMI CEC" me televizorin - mund t'i komandoni me telekomandë. "EasyLink HDMI CEC" duhet të aktivizohet në televizor dhe në pajisjen e lidhur.



Aktivizimi i "EasyLink"

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > EasyLink > Aktiv

Telekomandimi i pajisjeve që mbështesin "HDMI CEC".

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Telekomanda EasyLink > Aktive

Shënim:

- "EasyLink" mund të mos funksionojë me pajisje të markave të tjera.

- Funkzioni "HDMI CEC" ka emra të ndryshëm në marka të ndryshme. Disa shembuj janë: "Anynet", "Aquos Link", "Bravia Theatre Sync", "Kuro Link", "Simplink" dhe "Viera Link". Jo të gjitha markat përputhen plotësisht me "EasyLink". Emrat e markave të "HDMI CEC" të përmendura si shembuj janë pronë e pronarëve të tyre përkatës.

Cilësimet e ruajtësit të ekranit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Cilësimet e ruajtësit të ekranit > Ruajtësi i ekranit

Zgjidhni Tematika e sfondit për të aktivizuar ruajtësin e ekranit. Zgjidhni Joaktiv për ta çaktivizuar ruajtësin e ekranit.

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Cilësimet e ruajtësit të ekranit > Kur të fillojë

Vendosni kohëzgjatjen (në minuta) që televizori nuk përdoret përpara se të aktivizohet ruajtësi i ekranit.

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Cilësimet e ruajtësit të ekranit > Shqyrto

Shtypni OK për ta parë paraprakisht ruajtësin e ekranit.

Vendndodhja - Shtëpi ose dyqan

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Vendndodhja

- Zgjedhja e vendndodhjes së televizorit
- Zgjidhni **Dyqan**, stili i figurës rikthehet në **I qartë si kristal**, dhe mund të rregulloni cilësimet e dyqanit.
- Modaliteti i dyqanit është për ekspozim në dyqane.

Konfigurimi për dyqan

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Konfigurimi për dyqan

Nëse televizori është caktuar në **Dyqan**, mund të shikoni stemat e funksioneve ose mund të caktoni disponimin e një demonstrimi specifik për përdorim në dyqan.

Rregullimi i figurës dhe zërit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Konfigurimi në dyqan > Figura dhe zëri

Zgjidhni **I optimizuar për dyqan** ose **Cilësimet të personalizuar** për cilësimet e figurës dhe audios.

Stemat dhe shiriti

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Konfigurimi në dyqan > Stemat dhe banderola

Caktoni për të shfaqur Stemat e funksioneve dhe Shirit promocional.

Nisja automatike e "Demo Me"

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Konfigurimi për dyqan > Nisja automatike e Demo Me / Nisja automatike e demonstrimit të Ambilight

Ndizni ose fikni nisjen automatike të "Demo Me" apo nisja automatike e demonstrimit të "Ambilight".

Zëri POS

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Cilësimet e përgjithshme](#) > [Konfigurimi për dyqan](#) > [Zëri POS](#)

Ndizni ose fikni "Zëri POS". Kjo veçori synohet për tregtarët.

Samba Interactive TV

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Cilësimet e përgjithshme](#) > [Samba Interactive TV](#)

Samba TV e përmirëson televizorin duke njohur me zgjuarsi përmbajtjen në ekran. Duke e aktivizuar, njëherësh pranon dhe miraton kushtet e shërbimit dhe rregulloren e privatësisë së "Samba TV".

Samba Interactive TV ju mban të përditësuar me tendencat më të fundit televizive dhe ju ndihmon të zbuloni filma dhe shfaqje të reja. Duke analizuar atë çfarë shikoni në televizor, ne ofrojmë rekomandime dhe njohuri të tjera përmes aplikacioneve të tilla si Samba TV Mobile. Samba TV gjithashtu mundëson, drejtpërdrejt ose përmes partnerëve, ofrimin e përmbajtjes më të rëndësishme ose të personalizuar, duke përfshirë reklamat. Mund të aktivizosh ose çaktivizosh Samba TV në opsionin Cilësimet e privatësisë në cilësimet e sistemit të televizorit.

Menaxho demonstrimet

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Aplikacionet](#) > [Demo me](#) > [Menaxho demonstrimet](#)

Nëse televizori është caktuar në **Dyqan**, mund të menaxhoni videot demonstruese në aplikacionin **Demo me**.

Luajtja e videove demonstruese

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Aplikacionet](#) > [Demo me](#) > [Menaxho demonstrimet](#) > [Luaj](#)
Zgjidhni dhe luani një skedar videoje demonstruese.

Kopjimi i skedarit të demonstrimit

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Aplikacionet](#) > [Demo me](#) > [Menaxho demonstrimet](#) > [Kopjo në USB](#)
Kopjoni skedarin e demonstrimit në njësinë USB.

Fshirja e skedarit të demonstrimit

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Aplikacionet](#) > [Demo me](#) > [Menaxho demonstrimet](#) > [Fshini](#)
Fshini skedarin e demonstrimit nga televizori.

Konfigurimi i demonstrimit

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Aplikacionet](#) > [Demo me](#) > [Menaxho demonstrimet](#) > [Konfigurimi](#)
Caktoni televizorin **Televizori kryesor** ose **Televizori dytësor**.

Shkarkimi i një skedari të ri demonstrimi

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Aplikacionet](#) > [Demo me](#) > [Menaxho demonstrimet](#) > [Shkarko të ri](#)
Nëse konfigurimi caktohet te **Televizori kryesor**, mund të shkarkoni një skedar të ri demonstrimi.

Cilësimi i vonesës automatike

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Aplikacionet](#) > [Demo me](#) > [Menaxho demonstrimet](#) > [Cilësimi i vonesës automatike](#)
Caktoni kohën e vonesës automatike nga 15 sekonda deri 5 minuta.

Zgjedhja e përsëritjes automatike

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Apl.](#) > [Demo me](#) > [Menaxho demonstrimet](#) > [Zgjedhja për vetëpërsëritje](#)
Zgjidhni një skedar demonstrimit për ta luajtur në përsëritje automatike.

Rivendosja e cilësimeve të televizorit dhe riinstalimi

Rivendosja e të gjitha vlerave të cilësimeve në cilësimet fillestare të televizorit

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Cilësimet e përgjithshme](#) > [Cilësimet e fabrikës](#)

Riinstalimi i plotë dhe rivënia e statusit të televizorit si në herën e parë që e ndezët

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Cilësimet e përgjithshme](#) > [Riinstalimi i televizorit](#)

Jepni kodin PIN dhe zgjidhni **Po** dhe televizori do të riinstalohet plotësisht. Të gjitha cilësimet do të rivendosen dhe kanalet e instaluar do të zëvendësohen. Instalimi mund të zgjasë disa minuta.

Cilësimet e kyçjes

Caktimi dhe ndryshimi i kodit

[🏠 \(Kreu\)](#) > [Cilësimet](#) > [Bllokimi për fëmijët](#) > [Caktimi i kodit](#), [Ndryshimi i kodit](#)

Caktimi i kodit të ri ose rivendosja e kodit të ndryshuar. Për të kyçur ose shkyçur kanalet dhe programet përdoret kodi PIN i kyçjes për fëmijët.

Vini re: Nëse keni harruar kodin PIN, mund ta anashkaloni kodin aktual duke përdorur **8888** e të vendosni një kod të ri.

Kyçja për program

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Bllokimi për fëmijët > Klasifikimi prindëror

Cakto moshën minimale për shikimin e programeve të klasifikuara.

Bllokimi i aplikacioneve

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Bllokimi për fëmijët > Bllokimi i aplikacioneve

Mund të kyçni aplikacione të papërshtatshme për fëmijë. Kyçja e aplikacioneve do të kërkojë një kod PIN kur përpigëni të nisni një aplikacion me klasifikimin 18+. Kjo kyçje vlen vetëm për aplikacionet e klasifikuara 18+ nga aplikacionet e "Philips".

Cilësimet e rajonit dhe gjuhës

Gjuha

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Rajoni dhe gjuha > Gjuha

Ndryshimi i gjuhës së menysë dhe mesazheve të televizorit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Rajoni dhe gjuha > Gjuha > Gjuha e menysë

Caktimi i gjuhës së preferuar të audios

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Rajoni dhe gjuha > Gjuha > Audio parësore, Audio dytësore

Kanalet televizive dixhitale mund të transmetojnë audio në disa gjuhë të folura për një program të caktuar. Mund të caktoni një gjuhë të preferuar kryesore dhe një gjuhë dytësore të audios. Nëse ofrohet audio në ndonjë nga këto gjuhë, televizori do të kalojë te kjo audio.

Caktimi i gjuhës së preferuar të titrave

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Rajoni dhe gjuha > Gjuha > Titra kryesore, Titra dytësore

Kanalet dixhitale mund të ofrojnë disa gjuhë titrash për një program. Mund të caktoni një gjuhë të preferuar kryesore dhe një gjuhë dytësore titrash. Nëse titrat ofrohen në njërin prej këtyre gjuhëve, televizori do të shfaqë titrat që keni zgjedhur.

Caktimi i gjuhës së preferuar të teletekstit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Rajoni dhe

gjuha > Gjuha > Teleteksti kryesor, Teleteksti dytësor

Disa transmetues televizivë dixhitalë ofrojnë disa gjuhë teleteksti.

Ora

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Rajoni dhe gjuha > Ora

Korrigjimi automatik i orës

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Rajoni dhe gjuha > Ora > Modaliteti i orës automatike

- Cilësimi standard për orën e televizorit është **Automatike**. Informacioni i orës vjen nga transmetimi i kohës së koordinuar botërore UTC.
- Nëse ora nuk është e saktë, mund ta caktoni **Sipas shtetit**.
- Kur zgjidhni **Sipas shtetit**, mund të caktoni kohën për **Automatike**, **Ora standarde**, ose **Ora verore**.

Korrigjimi manual i orës

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Rajoni dhe gjuha > Ora > Modaliteti i orës automatike > Manuale

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Rajoni dhe gjuha > Ora > Data, Koha

Kaloni në menynë e mëparshme dhe zgjidhni **Data** dhe **Ora** për të rregulluar vlerën.

Shënim:

- Nëse asnjëri nga cilësimet automatike nuk e tregon orën saktë, mund ta caktoni manualisht.
- Cilësimi "Modaliteti i orës automatike" do të kthehet në opsionin "Automatik" pasi televizori fiket dhe ndizet përsëri.

Caktimi i brezit orar ose i shmangies kohore në rajonin tuaj

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Rajoni dhe gjuha > Ora > Brezi orar


Zgjidhni një nga brezat orar.

10.3. Cilësimet Eco

Cilësimet për kursimin e energjisë

MENU > Cilësimet Eco > Kursimi i energjisë





Shtypni butonin MENU në telekomandë për të gjetur

Menynë e shpejtë, zgjidhni Cilësimet Eco për të vendosur opsionet. Zgjidhni dhe konfirmoni për të aplikuar cilësimet Eco në televizor. Kjo mund të rivendosë disa nga cilësimet origjinale të figurës dhe të reduktojë disi ndriçimin e Ambientlight*. Kini parasysh se ky cilësim mund të ndikojë në përvojën e televizorit. Ikona e gjethes jeshile  do të shtohet kur të aplikohen cilësimet Eco.

* Cilësimi "Ambilight"* ofrohet vetëm për modelet që mbështesin funksionin "Ambilight".

Caktimi i ekranit fikur për të kursyer konsumin e energjisë

MENU > Cilësimet Eco > Ekran i fikur

Zgjidhni Ekran i fikur, ekran i televizorit është i fikur, për të ndezur përsëri ekranin e televizorit, shtypni çdo buton (përveç , ) Volumi + ose - , Luaj , Pushim  dhe tastit 123) në telekomandë.

Caktimi i fikjes me orar të televizorit

MENU > Cilësimet Eco > Kohëmatësi i fikjes

Zgjidhni kohëmatësin e gjendjes joaktive dhe televizori do të fiket automatikisht për të kursyer energji. Vlera e cilësimit Joaktiv çaktivizon fikjen automatike.

- Televizori do të fiket nëse merr sinjal televiziv, por nuk shtypni ndonjë tast në telekomandë gjatë një periudhe 4-orëshe.
- Televizori fiket nëse nuk merr sinjal televiziv apo komandë nga telekomanda për 10 minuta.
- Nëse e përdorni televizorin si monitor ose nëse për të parë televizor përdorni një marrës dixhital (një dekodues - STB) dhe nuk e përdorni telekomandën e televizorit, duhet ta çaktivizoni këtë fikje automatike për të caktuar vlerën në Joaktive.

Caktoni fikjen automatike të kohëmatësit kur televizori nuk ka sinjal

MENU > Eco settings > Nuk ka kohëmatës të sinjalit

Televizori do të fiket automatikisht nëse nuk ka sinjal të disponueshëm pas 10/15/20 minutash.

11. Asistenca

11.1. Cilësimet e asistencës

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Asistenca

Me funksionin Asistenca të aktivizuar, televizori është gati për përdorim nga persona të shurdhër, me vështirësi dëgjimi, të verbër ose me shikim të pjesshëm.

Aktivizimi i cilësimeve të asistencës

🏠 (Kreu) > Cilësimet
> Asistenca > Asistenca > Aktive.

Asistenca për persona me vështirësi në dëgjim

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Asistenca > Për vështirësi në dëgjim > Aktive

- Disa kanale dixhitale televizive transmetojnë audio dhe titra të përshtatura për personat me vështirësi në dëgjim ose të shurdhër.
- Kur ndizet, televizori kalon automatikisht në audion dhe titrat e përshtatura, nëse ofrohen.

"Asistenca" për persona të verbër ose me shikim të pjesshëm

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Asistenca > Përshkrimi i audios > Përshkrimi i audios > Aktive

Kanalet dixhitale televizive mund të transmetojnë komente të posaçme për audion ku përshkruhet çfarë është duke ndodhur në ekran.

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Asistenca > Përshkrimi i audios > Volumi i përzier, Efektet audio, Ligjërimi

- Zgjidhni **Volumi i përzier** që të mund të kombinoni volumin e audios normale me komente për audion. Shtypni shigjetat **▶** (djathtas) ose **◀** (majtas) për të përshtatur vlerën.
- Caktoni **Efektet zanore** në **Aktiv** për efekte të mëtejshme zanore në audion e komenteve si p.sh. stereo ose zë në ulje.
- Zgjidhni **Ligjërim** për të caktuar preferencën e ligjërimin në **Përshkrues** ose **Titra**.

Përmirësimi i dialogut

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Asistenca > Përmirësimi i dialogut

Rrisni kuptueshmërinë e dialogut dhe komentareve. Ofrohet vetëm kur cilësimi i zërit **Clear dialogue** është Aktiv dhe transmetimi audio është AC-4.

Udhëzimi zanor

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Aksesit universal > Udhëzimi zanor

Ndizeni për të aktivizuar veçorinë e udhëzimit zanor duke përdorur motorin tekst-në-ligjërim. Veçoria disponohet vetëm në gjuhë të zgjedhura.

Caktoni shpejtësinë e ligjërimin ose volumin e ligjërimin

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Aksesit universal > Shpejtësia e ligjërimin / Volumi i ligjërimin

Kur është aktivizuar 🏠 (Kreu) > Cilësimet > Aksesit universal > Udhëzimi zanor, zgjidhni **Shpejtësia e ligjërimin** or **Volumi i ligjërimin** për të caktuar shpejtësinë ose volumin me të cilin flitet teksti.

Zmadhimi i tekstit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Asistenca > Zmadhimi i tekstit

Aktivizojeni për të zmadhuar tekstet në ekran.

11.2. Më shumë cilësime aksesit

Cilësimet e tastierës dhe mausit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Cilësimet e tastierës USB

Për të instaluar tastierën USB, ndizni televizorin dhe lidhni tastierën USB me një nga lidhjet USB në televizor. Kur televizori e dikton tastierën për herë të parë, mund të zgjidhni modelin e saj dhe të testoni zgjedhjen tuaj.

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Cilësimet e mausit

Rregullimi i shpejtësisë së lëvizjes së mausit USB.

Cilësimet e kufjeve me tela dhe me valë

Mund të lidhni një palë kufje në 🎧 lidhjen në pjesën anësore të televizorit. Lidhja është minifole 3,5 mm. Volumin e kufjeve mund ta rregulloni veçmas.

Për të luajtur zërin e televizorit në kufje me Bluetooth® me valë, duhet ta çiftoni pajisjen me

televizorin.

Për të çiftuar një pajisje me Bluetooth® me televizorin:

- 1 - Ndizeni pajisjen me Bluetooth® dhe vendoseni brenda rrezes së televizorit.
- 2 - Zgjidhni **🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Lidhjet me valë dhe Rrjetet** dhe shtypni **➤** (djathtas) për të hyrë në meny.
- 3 - Zgjidhni **Bluetooth > Kërkimi për pajisje me "Bluetooth"**, dhe shtypni **OK**.
- 4 - Zgjidhni **Kërkim** dhe shtypni **OK**. Ndiqni udhëzimet në ekran. Pajisjen do ta çiftoni me televizorin dhe ky do ta ruajë lidhjen. Mund të duhet të shkëputni një pajisje të çiftuar në fillim nëse është arritur numri maksimal i pajisjeve të çiftuara.
- 5 - Zgjidhni llojin e pajisjes dhe shtypni **OK**.
- 6 - Nëse është e nevojshme, shtypni vazhdimisht **◀** (majtas) për të mbyllur menynë.

Mund të zgjidhni se ku dëshironi ta dëgjoni zërin e televizorit dhe si dëshironi ta komandoni.

- Nëse zgjidhni opsionin **Altoparlantët e televizorit**, altoparlantët do të qëndrojnë gjithnjë aktivë. Për këtë modalitet zbatohen të gjitha cilësimet e lidhura me zërin.
- Nëse zgjidhni **Wired headphones**, zëri do të luhet përmes kufjeve.
- Nëse zgjidhni **Altoparlantët e televizorit + Kufje me tel**, zëri do të luhet përmes altoparlantëve të televizorit dhe kufjeve.

Cilësimet e titrave

Për të aktivizuar titrat, shtypni **OPSIONET** dhe zgjidhni **Titrat**.

Mund t'i kaloni titrat në **Titra aktive** ose **Titra joaktive**. Përndryshe mund të zgjidhni **Automatike**.

Nëse informacionet e gjuhës janë pjesë e transmetimit dixhital dhe programi i transmetuar nuk është në gjuhën tuaj (gjuha e caktuar në televizor), televizori mund të shfaqë automatikisht titrat në një nga gjuhët tuaja të preferuara.

Gjuhët e preferuara të titrave mund t'i zgjidhni te **Gjuha e titrave**. Nëse nuk ofrohet asnjëra nga gjuhët e preferuara të titrave, mund të zgjidhni një gjuhë tjetër që ofrohet. Nuk e zgjidhni dot këtë opsion nëse nuk ofrohet asnjë gjuhë titrash.

12. Smart TV and Aplikacionet

ekranin e televizorit.

- Disa përbërës shtesë (si p.sh. për të parë faqe ose video) nuk ofrohen në televizor.
- Faqet e internetit shfaqen me radhë dhe në ekran të plotë.

12.1. Konfigurimi i "Smart TV"

Herën e parë që hapni "Smart TV", duhet të konfiguroni lidhjen. Lexoni dhe bini dakord me kushtet për të vazhduar.

Faqja kryesore e "Smart TV" është lidhja juaj me internetin. Mund të merrni filma me qira në internet, të lexoni gazeta, të shikoni video dhe të dëgjoni muzikë, si dhe të bëni pazar në internet apo të shikoni programe televizive kur të dëshironi me "Televizorin në internet".

"TP Vision Europe B.V." nuk mban përgjegjësi në lidhje me materialet dhe cilësinë e materialeve të ofruara nga ofruesit e shërbimit të materialeve.

12.2. Dyqani i aplikacioneve

Hapni skedën Aplikacionet te Kryefaqja e ekranit për të shfletuar aplikacionet, koleksionin e faqeve të internetit të përshtatura për televizor.

Gjeni një aplikacion për video në "YouTube", një gazetë kombëtare, një album fotografik në internet, etj. Ka aplikacione për të marrë një video me qira nga një videotekë në internet dhe aplikacione për të parë programet që keni humbur. Nëse aplikacioni tek **Aplikacionet** nuk përmban atë që kërkonte, provoni "Rrjetin e gjerë botëror" dhe lundroni në internet në televizor.

Kategoritë e aplikacioneve

Ju mund t'i renditni aplikacionet tek **Aplikacionet** në kategori të ndryshme si **Të reja**, **Video**, **Argëtim**, **Lajme** ose **Stil i jetesës**.

Aplikacionet e paraqitura

Në këtë dritare "Philips" paraqet një sërë aplikacionesh të rekomanduara për ju. Mund t'i zgjidhni dhe instaloni për të pasuruar televizorin tuaj Smart.

Internet

Aplikacioni "Internet" hap "Rrjetin e gjerë botëror" në televizor.

Në të, ju mund të shikoni çdo faqe interneti, por shumica prej tyre nuk janë të përshtatshme për

13. "Netflix"


Nëse keni një abonim anëtarësimi në Netflix, mund të shijoni Netflix në këtë televizor. Televizori duhet të jetë i lidhur me internetin.

Për të hapur Netflix, shtypni **NETFLIX** për të hapur aplikacionin Netflix. "Netflix" mund ta hapni menjëherë nga një televizor në pritje.

www.netflix.com

14. Amazon Prime Video

Me anëtarësimin "Amazon Prime", ju përfitoni akses ndaj mijëra filmash dhe serialësh televizive popullore, duke përfshirë shfaqje origjinale ekskluzive.

Shtypni tastin  për të hapur aplikacionin Amazon Prime Video. Televizori duhet të jetë i lidhur me internetin për të përdorur aplikacionin. Për më shumë informacion rreth "Amazon Prime Video", vizitoni www.primevideo.com.

15. YouTube

"YouTube" ofron një platformë për të lidhur botën. Shikoni dhe zbuloni video popullore të ngarkuara nga përdorues të "YouTube" anembanë botës. Përdorni aplikacionin "YouTube" për të eksploruar subjektet më të fundit rreth muzikës, lajmeve dhe më shumë.

Shtypni ikonën e aplikacionit për të hapur aplikacionin "YouTube". Televizori duhet të jetë i lidhur me internetin për të përdorur aplikacionin. Për më shumë informacion rreth "YouTube", vizitoni www.youtube.com.

16. Alexa

16.1. Rreth "Alexa"

Televizori juaj mbështet funksionet e komandave zanore të "Amazon Alexa".

Rreth "Alexa"

"Alexa" është një shërbim zëri i bazuar në re kompjuterike i cili disponohet në pajisjet "Alexa Echo" nga "Amazon" dhe prodhuesit e pajisjeve. Me Alexa, mund të ndizni/fikni televizorin, të ndërroni kanalet, të ndryshoni volumin dhe më shumë.

Për të kontrolluar televizorin me Alexa do të të duhet:

- Televizori inteligjent "Philips" që mbështet "Alexa"
- Llogaria e "Amazon"
- Aplikacioni Alexa* (versioni për celular/tabletë)
- Lidhja me rrjetin me valë ose me tel

"Amazon", "Alexa" dhe të gjitha stemat përkatëse janë marka tregtare të "Amazon.com, Inc." ose filialeve të saj. Amazon Alexa disponohet në gjuhë dhe shtete të zgjedhura.


Disponueshmëria e shërbimit varet nga rajoni. Një pjesë ose i gjithë softueri/shërbimet e instaluar në produkt apo që aksesohen nëpërmjet tij mund të ndryshohen, të ndërpriten, të hiqen, të pezullohen apo të përfundohen pa njoftim.

16.2. Përdorimi i "Alexa"

Për të përdorur "Alexa", fillimisht duhet të konfiguroni shërbimin e klientit të "Alexa" në televizorin inteligjent "Philips". Filloni konfigurimin duke hapur aplikacionin "Amazon Alexa" nga kryefaqja në televizor. Ndiqni udhëzimet dhe plotësoni hapat e mëposhtëm:

- Zgjidhni një llogari në Amazon dhe identifikohuni.
- Në pajisjen tuaj celulare, lidhni llogarinë dhe zbuloni pajisjet tuaja.
- Kthehuni në televizor për të përfunduar konfigurimin.

Konfigurimi në televizor për "Alexa"

- 1 - Shtypni  **Kreu** dhe hapni aplikacionin "Amazon Alexa".
- 2 - Aplikacioni "Alexa" (versioni për pajisje celulare ose ueb) duhet të jetë gati për të filluar konfigurimin.
- 3 - Ndiqni udhëzimet në ekran për t'u identifikuar në llogarinë tuaj në Amazon dhe pranoni kushtet e Politikës së privatësisë.

- 4 - Në pajisjen celulare, identifikohuni aplikacionin "Amazon Alexa" me të njëjtën llogari të "Amazon".
 - 5 - Në fund të ekranit të konfigurimit, mund të zgjidhni Përfundoi për të filluar përdorimin e "Alexa".
-

16.3. Komandat zanore të "Alexa"

Këtu jepen disa gjëra për të provuar:

NDEZJA/FIKJA E TELEVIZORIT

"Alexa, turn on Living Room TV" (Alexa, ndiz televizorin e dhomës së ndenjjes) (shih shënimin më poshtë)

"Alexa, turn off TV" (Alexa, fik televizorin)

Shënim: Ndezja e televizorit do të funksionojë vetëm nëse në televizor është aktivizuar cilësimi i ndezjes nga Alexa, nëpërmjet aplikacionit "Amazon Alexa".

NDRYSHIMI I KANALIT

"Alexa, next channel on TV" (Alexa, kanali i radhës në televizor)

"Alexa, change channel to 5 on TV" (Alexa, kalo kanalin te 5 në televizor)

NDRYSHIMI I VOLUMIT

"Alexa, set volume to 15 on Living Room TV" (Alexa, cakto në 15 volumin te televizori i dhomës së ndenjjes)

"Alexa, turn down the volume" (Alexa, ul volumin)

"Alexa, volume up" (Alexa, rrit volumin)

ÇAKTIVIZIMI OSE AKTIVIZIMI I ZËRIT TË TELEVIZORIT

"Alexa, çaktivizo zërin e televizorit në dhomën e ndenjjes"

"Alexa, aktivizo zërin"

NDRYSHIMI I BURIMIT TË HYRJES

"Alexa, ndërro hyrjen, vendos "Blu-ray" në televizorin e dhomës së ndenjjes"

"Alexa ndërro hyrjen, vendos HDMI 1"

KONTROLLI I LUAJTJES

"Alexa, play on TV" (Alexa, luaj në televizor)

"Alexa, pause TV" (Alexa, vendos televizorin në pauzë)

KONTROLLI I AMBILIGHT (shih shënimin më poshtë):

"Alexa, turn on Ambilight" (Alexa, ndiz Ambilight)

"Alexa, turn off Ambilight" (Alexa, fik Ambilight)

Shënim: Komandat zanore të mbështetura nga Ambilight mund të varen nga modelet specifike të televizorëve.

HAPJA E APLIKACIONEVE OSE SHKURTOREVE**

"Alexa, launch Prime Video on Living Room TV"

(Alexa, hap Prime Video në televizorin e dhomës së ndenjjes)

"Alexa, go to Settings on Kitchen TV" (Alexa, shko te cilësimet tek televizori i kuzhinës)

"Alexa, go Home on TV" (Alexa, shko te 'Kreu' në televizor)

SHTETET E MBËSHTETURA

Mbretëri e Bashkuar, Irlandë**, Francë, Gjermani, Austri**, Itali, Spanjë, Brazil.

GJUHËT E MBËSHTETURA

Anglisht (Britani e Madhe), anglisht (SHBA), frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, portugalisht (Brazil), spanjisht (SHBA).

** Gjuhët e mbështetura mund të mos jenë të disponueshme për ato shtete.

17. Google Assistant

Televizori juaj mund të punojë me "Google Assistant". "Google Assistant" ju mundëson të përdorni zërin tuaj për të komanduar televizorin tuaj – p.sh. për të ndryshuar volumin, kanalet dhe të tjera.

Shënim: "Google Assistant" nuk ofrohet në të gjitha gjuhët dhe shtetet.

Për të aktivizuar "Google Assistant" në televizorin tuaj, ju nevojitet:

- Një pajisje "Google Home", si p.sh. "Google Home Mini"
- Lidhja me internetin në televizor
- Llogaria "Google"
- Aplikacioni "Google Home" (versioni për celular/tabletë)

Konfigurimi i komandimit të televizorit me "Google Assistant"

1 - Ndiqni udhëzimet në ekran për të pranuar "Rregullorja e privatësisë" për përdorimin e funksionit të komandimit me zë të "Google Assistant" në këtë televizor.

2 - Zgjidhni një emër për televizorin në mënyrë që "Google Assistant" ta identifikojë atë.

3 - Identifikohu në llogarinë në "Google". Nëse keni tashmë një llogari "Google", identifikohuni aty. Nëse nuk keni, krijoni një llogari dhe identifikohuni. Pasi të jeni identifikuar me sukses, zgjidhni "Merr kodin" për të marrë kodin e pajisjes për këtë televizor për të regjistruar pajisjen tuaj.

4 - Në celular/tabletë, kërkoni për aplikacionin "Google Home" në dyqanin e aplikacioneve (iOS dhe Android). Shkarkoni dhe hapni aplikacionin "Google Home". Identifikohuni me të njëjtën llogari "Google" që është përdorur për të regjistruar televizorin. Ju duhet ta konfiguroni aplikacionin "Google Home" në celular/tabletë që të komandoni televizorin me komanda zanore.

5 - Tek aplikacioni "Google Home", zgjidhni "Konfiguro pajisje" dhe më pas zgjidhni "Funksionon me Google" dhe kërkoni televizorin inteligjent "Philips". Identifikohuni për ta lidhur llogarinë tuaj "Google" dhe për të aktivizuar komandimin e televizorit në aplikacionin "Google Home".

6 - Mund të përdorësh "Google Assistant" për ta ndezur televizorin me anë të komandës zanore. Për këtë, televizori duhet të qëndrojë në modalitet të posaçëm energjie kur është në gjendje pritjeje. Kjo mund të sjellë konsum pak më të lartë në gjendje pritjeje.

Je gati për të përdorur pajisjen tënde "Google Home"

për ta komanduar këtë televizor. Ja disa gjëra që mund të provoni:

- Fik televizorin
- Kalo te kanali 10 në televizor
- Kanali poshtë në televizor
- Hiq zërin në televizor

Shënim: Nëse dilni nga "Google Assistant", nuk do të jeni më në gjendje të përdorni komandat zanore në këtë televizor. Do t'ju duhet të ribëni sërish "Konfigurimi i komandimit të televizorit me "Google Assistant" për ta përdorur sërish këtë funksion.

"Google Assistant" ofrohet në gjuhë dhe shtete të zgjedhura, ku gjuhët Anglisht-MB dhe Gjermanisht-DE mbështeten që në fillim. Lista e gjuhëve/shteteve të mbështetura do të zgjerohet me kalimin e kohës. Për listën më të fundit të mbështetjes së gjuhëve dhe shteteve kontaktoni me kujdesin për klientin.

Disponueshmëria e shërbimit varet nga rajoni. Një pjesë ose i gjithë softueri/shërbimet e instaluara në produkt apo që aksesohen nëpërmjet tij mund të ndryshohen, të ndërpriten, të hiqen, të pezullohen apo të përfundohen pa njoftim.

18. Softueri

18.1. Përditëso softuerin

Kërkimi për përditësime

Përditësimi nga interneti

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Përditësimi i softuerit > Kërkimi për përditësime > Internet (Rekomandohet)

Kërkoni vetë përditësimin e softuerit.

- Nëse televizori është lidhur me internetin, mund të merrni një mesazh për përditësimin e softuerit të televizorit. Nevojitet lidhje interneti me shpejtësi të lartë (përshtatës me bandë të gjerë). Nëse merrni mesazh të tillë, ju rekomandojmë ta kryeni përditësimin.
- Gjatë përditësimit të softuerit nuk ka figurë dhe televizori do të fiket dhe rindizet. Kjo mund të ndodhë disa herë. Përditësimi mund të zgjasë disa minuta.
- Prisni derisa të shfaqet sërish figura në televizor. Mos shtypni butonin e energjisë 🔌 në televizor ose në telekomandë gjatë përditësimit të softuerit.

Përditësimi nga USB

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Përditësimi i softuerit > Kërkimi për përditësime > USB

- Për ta ngarkuar softuerin në televizor, ju nevojitet një kompjuter me lidhje të shpejtë interneti dhe një pajisje memorieje USB.
- Përdorni një pajisje memorieje USB me hapësirë të lirë 1.2 GB. Sigurohuni që mbrojtja ndaj shkrimit të mos jetë aktive.

1 - Nisja e përditësimit në televizor

Zgjidhni **Përditësimi i softuerit > Kërkimi i përditësimeve > USB** dhe më pas shtypni **OK**.

2 - Identifikimi i televizorit

Futni memorien USB në një nga lidhjet e USB në televizor.

Zgjidhni **Nisje** dhe shtypni **OK**. Te pajisja e memories USB do të shkruhet një skedar identifikimi.

3 - Shkarkimi i softuerit të televizorit

- Futni memorien USB në kompjuter.

- Në pajisjen e memories USB gjeni skedarin **update.html** dhe klikojeni dy herë.

- Klikoni **Dërgo ID-në**.

- Nëse disponohet softuer i ri, shkarkoni skedarin **.zip**.

- Pas shkarkimit, shpaketoni skedarin dhe kopjoni skedarin **autorun.upg** në pajisjen e memories USB.

- Këtë skedar mos e vendosni në dosje.

4 - Përditësimi i softuerit të televizorit

Futeni sërish në televizor memorien USB. Përditësimi do të fillojë automatikisht.

Televizori fiket vetë për 10 sekonda dhe rindizet automatikisht. Prisni.

Mos. . .

- e përdorni telekomandën
- e hiqni pajisjen e memories USB nga televizori
- shtypni 🔌 dy herë
- shtypni butonin e energjisë në televizor

Televizori fiket vetë (për 10 sekonda) dhe rindizet automatikisht. Prisni.

Softueri i televizorit u përditësua. Mund ta përdorni sërish televizorin.

Për të parandaluar përditësimin aksidental të softuerit të televizorit, fshini skedarin **autorun.upg** nga pajisja e memories USB.

Përditësimet lokale

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Përditësimi i softuerit > Kërkimi i përditësimeve > USB > Përditësimet lokale. . .

Për shitësit dhe përdoruesit ekspertë.

18.2. Versioni i softuerit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Përditësimi i softuerit > Të dhënat e softuerit aktual

Për të parë versionin aktual të softuerit të televizorit.

18.3. Përditësimi automatik i softuerit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Përditësimi i softuerit > Përditësimi automatik i softuerit

Aktivizimi i përditësimit automatik të softuerit për të përditësuar softuerin e televizorit automatikisht. Lëreni televizorin në pritje.

Kur cilësimi aktivizohet, përmirësimi shkarkohet kur televizori është i ndezur dhe instalohet 15 minuta pasi televizori ka kaluar në pritje (për sa kohë që nuk ka asnjë alarm të planifikuar).

Kur cilësimi çaktivizohet, në ekran shfaqet mesazhi "Përmirëso tani" / "Më vonë".

18.4. Shfaqja e historikut të përditësimeve të softuerit

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Përditësimi i softuerit > Shfaqja e historikut të përditësimeve të softuerit

Shfaqni listën e versioneve të softuerit që janë përditësuar me sukses në televizor.

19. Mjedisore

19.1. Etiketa evropiane e energjisë

Etiketa evropiane e energjisë ju informon mbi kategorinë e efikasitetit energjetik të këtij produkti. Sa më ekonomike të jetë klasa e efikasitetit të energjisë të këtij produkti, aq më pak energji konsumon. Në etiketë mund të gjeni klasën e efikasitetit të energjisë dhe konsumin mesatar të energjisë të produktit gjatë përdorimit. Gjithashtu, mund të gjeni vlerat e konsumit të energjisë për këtë produkt duke shkuar në faqen e "Philips" për shtetin tuaj, në adresën www.philips.com/tvsupport

19.2. Numri i regjistrimit i EPREL

32PQS6901 : 2582651

40PQS6901 : 2582681

32PQS6951 : 2682025

19.3. Fundi i përdorimit

Eliminimi i produkteve dhe i baterive të vjetra

Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe përbërës të cilësisë së lartë, të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.



Nëse produkti mban simbolin e koshit me rrota me kryq, do të thotë se mbulohet nga direktiva evropiane 2012/19/BE.



Informohuni rreth sistemeve të veçuara vendase të grumbullimit për produktet elektrike dhe elektronike.

Veproni sipas rregullave vendase dhe mos i hidhni produktet e vjetra në të njëjtin vend me mbeturinat normale të shtëpisë. Hedhja e pajisjes së vjetër në mënyrën e duhur ndihmon në parandalimin e pasojave negative të mundshme për mjedisin dhe për shëndetin e njerëzve.

Produkti mban bateri që mbulohen nga Rregullorja Evropiane (BE) 2023/1542, të cilat nuk mund të hidhen me mbeturinat e zakonshme të shtëpisë.



Mësoni rreth rregullave vendase në lidhje me grumbullimin e veçuar të baterive, pasi hedhja e duhur e tyre parandalon pasojat negative në mjedis dhe në shëndetin e njerëzve.

20. Specifikimet

20.1. Energjia

Specifikimet e produktit mund të ndryshojnë pa njoftim paraprak. Për më detaje mbi specifikimet e këtij produkti, shihni www.philips.com/tvsupport

Energjia

- Rrjeti elektrik: AC 100-240 V
 - Temperatura e ambientit: 5°C deri në 35°C
-

20.2. Marrja

- Hyrja e antenës: Koaksiale 75 om (IEC75)
- Bandat e marrësit: Hyperband, S-Channel, UHF, VHF
- DVB: DVB-T/T2, DVB-C (kabllor) QAM
- Luajtja e videos analoge: SECAM, PAL
- Luajtja e videos dixhitale: MPEG2 SD/HD (ISO/IEC 13818-2), MPEG4 SD/HD (ISO/IEC 14496-10), HEVC*
- Luajtja e audios dixhitale (ISO/IEC 13818-3)
- Hyrja e antenës satelitore: Tip "F", 75 om
- Rrezja e frekuencës së hyrjes: 950 deri 2150 MHz
- Rrezja e nivelit të hyrjes: 25 deri 65 dBm
- DVB-S/S2 QPSK, shpejtësia e modulimit 2 deri 45 M simbole, SCPC dhe MCPC
- Koka LNB: Mbështetet 1 deri në 4 koka LND me "DiSEqC 1.0", zgjedhje polariteti 14/18 V, zgjedhje bande 22 kHz, modalitet përforcimi të sinjalit, rryma e kokës LNB maks. 300 mA

* Vetëm për DVB-T2, DVB-S2

20.3. Rezolucioni i ekranit

Madhësia diagonale e ekranit

- 80 cm / 32 inçë

Rezolucioni i ekranit

- 1920 x 1080
-

20.4. Rezolucioni i mbështetur i hyrjes

Rezolucioni i mbështetur i kompjuterit/videos

Rezolucioni — shpejtësia e rifreskimit

Hyrjet e videos - Shpejtësia maksimale e kuadrove është 60 Hz (televizori mund të jetë në modalitetin "Video"/"Lojë"/"Kompjuter")

- 640 x 480 - 60 Hz
 - 576p - 50 Hz
 - 720p - 50 Hz, 60 Hz
 - 1920 x 1080p - 24 Hz, 25 Hz, 30 Hz, 50 Hz, 60 Hz
-

Rezolucioni vetëm për videon e mbështetur

Rezolucioni — shpejtësia e rifreskimit

Hyrjet e videos (televizori mund të jetë në modalitetin "Video" ose "Lojë")

- 480i - 60 Hz
 - 576i - 50Hz
 - 1080i - 50 Hz, 60 Hz
 - 720p - 50 Hz, 60 Hz
 - 1080p - 24Hz, 25Hz, 30Hz, 50Hz, 60Hz
-

20.5. Tingulli

- Fuqia dalëse (RMS): 32" - 12W; 40" - 16W
 - Dolby MS12
 - Përmirësim i dialogut Dolby
 - Bass+
 - Niveluesi i volumit Dolby / Modaliteti Natën
 - Nxitje vokale
 - Balancuesi
-

20.6. Multimedia

Lidhjet

- USB 2.0
- Ethernet LAN RJ-45
- Wi-Fi 802.11n, me një brez

Sistemet e mbështetura të skedarëve për USB

- FAT, NTFS

Formatet e luajtjes

- Kodeku video: AVI, MKV, HEVC, H.264/MPEG-4 AVC, MPEG1, MPEG2, MPEG4, VP9, HEVC (H.265), AV1
 - Kodeku zanorë: MP3, WAV, AAC, FLAC
-

- Titrat:
 - Formati: SRT, SMI, SSA, SUB, ASS, TXT
 - Enkodimet e shkronjave: Evropa Perëndimore, Turqisht, Evropa Qendrore, Cirilike, Greqisht, UTF-8 (Unicode), Hebraisht, Arabisht, Baltik
- Shkalla maksimale e mbështetur e të dhënave:
 - MPEG-4 AVC (H.264) mbështetet deri në profilin e lartë në nivelin 5.1. 30 Mbps
 - H.265 (HEVC) mbështeten deri në profilin Kryesor / Kryesor 10 deri në nivelin 5.1 40 Mbps
- Kodeku i figurës: JPEG, GIF, PNG, BMP, HEIF

I certifikuar për Wi-Fi

Televizori është pajisje e certifikuar për "Wi-Fi".

20.7. Lidhja

Anash televizorit

- Foleja e ndërfaqes së përbashkët: CI+/CAM
- Kufjet - minifole stereo 3,5 mm
- Hyrja HDMI 3
- Hyrja HDMI 2
- Hyrja HDMI 1 - ARC
- USB 1 - USB 2,0
- USB 2 - USB 2,0
- Dalja e audios - lidhje optike Toslink
- Antena (75 om)
- Sintonzuesi satelitor
- Rrjet LAN - RJ45

21. Diagnostikimi

21.1. Këshilla

Nëse nuk mund të gjeni një zgjidhje për problemin e televizorit tuaj te Diagnostikimi, mund të shkoni te **Ndihma > Manuali i përdorimit** për të gjetur faqen më përkatëse në manualin e përdorimit.

Nëse manuali i përdorimit nuk i përgjigjet pyetjes suaj, mund të shkoni në faqen e mbështetjes në internet të "Philips".

Për të zgjidhur problemet e televizorit Philips, mund t'i drejtoheni ndihmës që ofrojmë në internet. Mund të zgjidhni gjuhën tuaj dhe të jepni numrin e modelit të produktit.

Shkoni te www.philips.com/tvsupport.

Te faqja mbështetëse në internet mund të gjeni numrin e telefonit të kontaktit me ne për shtetin tuaj, si edhe përgjigjet për pyetjet e shpeshta (FAQ). Në disa shtete mund të bisedoni me një nga bashkëpunëtorët tanë për t'i bërë pyetjet drejtpërdrejt apo për të dërguar një pyetje me email. Softuerin e televizorit apo manualin mund ta shkarkoni për ta lexuar në kompjuter.

"Ndhma e televizorit" në tabletë, celular inteligjent ose kompjuter

Për t'i zbatuar më lehtë sekuencat e zgjeruara të udhëzimeve, "Ndhmën për televizorin" mund ta shkarkoni në format PDF, për ta lexuar në celularin inteligjent, në tabletë ose në kompjuter. Përndryshe, mund të printoni faqen përkatëse "Ndhma" nga kompjuteri.

Për të shkarkuar "Ndhma" (manualin e përdorimit) shkoni te www.philips.com/tvsupport

21.2. Aktivizimi

Televizori nuk ndizet


- Hiqni kordonin elektrik nga priza. Prisni për një minutë dhe futeni sërish në prizë. Sigurohuni që kordoni elektrik është lidhur në mënyrë të sigurt. Provoni ta ndizni sërish.
- Lidhni televizorin me një prizë tjetër të rrjetit elektrik dhe provoni ta ndizni.
- Shkëputni të gjitha pajisjet e lidhura nga televizori dhe provoni ta ndizni.
- Nëse është ndezur drita e pritjes, televizori mund të

mos i përgjigjet telekomandës.

Tingull kërcitës gjatë ndezjes ose fikjes

Gjatë ndezjes apo kalimit të televizorit në modalitet pritjeje, skeleti i tij lëshon një tingull kërcitës. Tingulli kërcitës shkaktohet nga zgjerimi dhe tkurrja normale e televizorit kur nxehet dhe ftohet. Kjo nuk ndikon në performancë.

Pas shfaqjes së ekranit të ndezjes "Philips", televizori kthehet në modalitet pritjeje

Kur televizori është në pritje, shfaqet ekрани i ndezjes i "Philips" dhe më pas kthehet në modalitet pritjeje. Kjo është sjellje normale. Kur televizori shkëputet dhe rilidhet me rrymën elektrike, ekрани i ndezjes do të shfaqet në ndezjen tjetër. Për ta kaluar televizorin nga pritja në aktiv, shtypni  (Në pritje / Aktiv) në telekomandë ose në televizor.

Drita e pritjes vazhdon të pulsojë

Hiqni kordonin elektrik nga priza. Prisni 5 minuta dhe lidhni sërish. Nëse pulsimi ndodh sërish, kontrolloni te **Ndhma > Informacioni i kontaktit** dhe kontaktoni kujdesin ndaj klientit të Philips.

Televizori fiket vetvetiu

Nëse televizori fiket befas, mund të jetë aktivizuar cilësimi **Fikja me orar**. Me opsionin **Fikja me orar** televizori fiket pas 4 orësh nëse nuk merr sinjale nga telekomanda. Për të shmangur këtë fikje automatike, mund ta çaktivizoni si opsion. Gjithashtu, televizori fiket automatikisht nëse për 10 minuta nuk merr sinjal televiziv apo komandë nga telekomanda.

21.3. Telekomanda

Televizori nuk përgjigjet ndaj komandave të telekomandës

- Ndezja e televizorit kërkon pak kohë. Gjatë kësaj kohe nuk reagon ndaj komandave të telekomandës apo të televizorit. Kjo është sjellje normale.
 - Telekomandës mund t'i kenë rënë bateritë. Ndërronini bateritë me të reja.
-

21.4. Kanalet

Gjatë instalimit nuk u gjet asnjë kanal dixhital

- Kontrolloni nëse televizori ishte lidhur me një antenë ose po përdor një sinjal operatori. Kontrolloni lidhjet kablllore.
- Kontrolloni nëse shteti ku po instaloni televizorin ka kanale të disponueshme dixhitale.

- Kontrolloni nëse keni zgjedhur sistemin e duhur DVB (transmetimet dixhitale me video). Zgjidhni DVB-T (tokësor) kur përdorni një antenë ose një antenë të përbashkët, zgjidhni DVB-C (kabllor) nëse përdorni shërbim kabllor televiziv.

- Kryeni sërish instalimin dhe kontrolloni nëse keni zgjedhur shtetin dhe sistemin e duhur.

Gjatë instalimit nuk u gjet asnjë kanal analog

- Kontrolloni nëse televizori ishte lidhur me një antenë. Kontrolloni lidhjet kabllore.
- Kontrolloni nëse keni zgjedhur sistemin e duhur DVB (transmetimet dixhitale me video). Zgjidhni DVB-T (tokësor) kur përdorni një antenë ose një antenë të përbashkët.

- Kryeni sërish instalimin dhe zgjidhni **Kanalet dixhitale dhe analoge** gjatë instalimit.

Disa kanale janë zhdukur, nuk gjenden dot të gjitha

ose disa kanalet të instaluar më parë

- Kontrolloni nëse keni zgjedhur **Listën e kanaleve** ose **Listën e preferencave** të duhur që përdorni normalisht.
- Disa kanale mund të jenë lëvizur ose fshirë nga transmetuesi. Në listën normale të kanaleve, provoni të kërkoni për atë që mungon. Nëse kanali është ende i disponueshëm, mund ta riktheni në listën e preferencave.

- Një kanal mund të fshihet nga lista gjatë **Përditësimit automatik të kanaleve**. Këto përditësime automatike kryhet gjatë natës nëse televizori është në pritje. Në listën e kanaleve do të fshihen kanalet që nuk ekzistojnë më dhe do të shtohen kanale të reja. Në veçanti, një kanal mund të fshihet pasi televizori mund të mos e gjejë gjatë kërkimit. Mund të mos transmetojë gjatë natës

Për të shmangur fshirjen e kanaleve nga **Përditësimi automatik i kanaleve** për shkak se televizori nuk arrin t'i gjejë, megjithëse këto kanale ekzistojnë ende, mund të çaktivizoni opsionin **Përditësimi automatik i kanaleve**.

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Kanalet > Instalimi i antenës/kabllorit, Instalimi i satelitëve* > Përditësimi automatik i kanaleve

* Instalimi i satelitëve është vetëm për modelet që mbështesin funksione satelitore.

Kanali DVB-T2 HEVC

- Shihni specifikimet teknike për t'u siguruar që televizori mbështet DVB-T2 HEVC në shtetin tuaj dhe riinstaloni kanalin DVB-T.

21.5. Satelit

Televizori nuk i gjen satelitët që dua ose televizori instalon të njëjtin satelit dy herë

Sigurohuni që në fillim të instalimit të jetë caktuar

numri i saktë i satelitëve të "Cilësimet". Televizori mund ta caktoni të kërkojë për një, dy ose 3/4 satelitë.

Koka LNB dyshe nuk gjen dot satelit të dytë

- Nëse televizori gjen njërin satelit, por nuk mund të gjejë të dytin, rrotullojeni me disa gradë antenën parabolike. Pozicionojeni në mënyrë që të marrë sinjalin më të fortë të satelitit të parë. Kontrolloni treguesin e fuqisë së sinjalit në ekran.

- Kontrolloni nëse cilësimet janë caktuar në opsionin "Dy satelitë".

Ndryshimi i cilësimeve të instalimit nuk e zgjidhi problemin

Të gjitha cilësimet, satelitët dhe kanalet ruhen vetëm pas përfundimit të instalimit.

Janë zhdukur të gjitha kanalet satelitore

Nëse përdorni një sistem "Unicable", mund të ndodhë që një tjetër marrës sateliti në sistemin tuaj "Unicable" të jetë duke përdorur të njëjtin numër brezi.

Disa kanale satelitore duket se janë zhdukur nga lista e kanaleve

Nëse disa kanale rezultojnë të jenë zhdukur apo zhvendosur, transmetuesi mund të ketë ndryshuar vendndodhjen e transponderit të këtyre kanaleve. Për të rivendosur pozicionet e kanaleve të lista e kanaleve, mund të provoni të përditësoni paketat e kanaleve.

Nuk heq dot një satelit


Paketat e pajtimit nuk mundësojnë heqjen e satelitëve. Për të hequr satelitin, duhet të kryeni sërish instalimin e plotë dhe të zgjidhni një paketë tjetër.

Ndonjëherë sinjali i marrjes është i dobët

- Kontrolloni nëse antena satelitore është montuar mirë. Erërat e forta mund ta lëvizin.
- Bora dhe shiu mund të përkeqësojnë marrjen e sinjalit.

21.6. Figura

Nuk ka figurë / figura del e deformuar

- Kontrolloni nëse televizori është lidhur me një antenë ose po përdor një sinjal operatori. Kontrolloni lidhjet kabllore.
- Kontrolloni nëse është zgjedhur burimi/hyrja e duhur në menynë "Burimet". Shtypni  **Burimet** dhe zgjidhni burimin/hyrjen që ju nevojitet.

- Kontrolloni nëse pajisja e jashtme ose burimi është lidhur siç duhet.

- Kontrolloni nëse ka marrje të dobët sinjali.

- Kontrolloni nëse figura është caktuar në vlerë minimale. Zgjidhni **Stili i figurës**, zgjidhni një stil dhe

shtypni OK.

- Për të kontrolluar nëse televizori është prishur, provoni të luani një videoklip. Shtypni **☰ Menyja e shpejtë / Menyja e televizorit > Ndhma > Diagnostikimi i televizorit > Kontrolllo televizorin**. Nëse videoklipi qëndron i zi, telefonojini "Philips". Prisni derisa të mbarojë klipi dhe zgjidhni **Informacioni i kontaktit në menynë "Ndhma"**. Telefonojini numrit të telefonit për shtetin ku ndodheni.

Ka zë, por nuk ka figurë

- Kaloni në burimet të tjera videoje dhe më pas rikthehuni në burimin aktual.
- Zgjidhni **Stili i figurës dhe zgjidhni një stil dhe shtypni OK**.

- Rivendosni stilin e figurës, zgjidhni sërish **Stili i figurës**, më pas zgjidhni **Rivendos stilin e figurës**.
- Për të rivendosur të gjitha cilësimet e televizorit, shkoni te **🏠 (Kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Riinstalimi i televizorit**.
- Kontrolloni lidhjet e pajisjeve të burimit/hyrjes.

Marrja e dobët e sinjalit

Nëse figura në televizor është e deformuar ose me cilësi të paqëndrueshme, sinjali hyrës mund të jetë i dobët. Sinjali i dobët dixhital ka pamjen e një figure që copëzohet në kuadrate dhe ngrin herë pas here. Një sinjal i keq dixhital përkeqësohet shumë më shpejt se një sinjal i keq analog.

- Kontrolloni nëse kabloja e antenës është lidhur siç duhet.
- Altoparlantët e mëdhenj, pajisjet e patokëzuara të zërit, dritat e neonit, ndërtesat e larta dhe objekte të tjera të mëdha mund të ndikojnë në cilësinë e marrjes së sinjalit kur përdorni antenë. Përpiquni ta përmirësoni cilësinë e marrjes duke ndryshuar drejtimin e antenës ose duke i larguar pajisjet nga televizori. Moti i keq mund ta përkeqësojë marrjen.
- Kontrolloni nëse të gjitha lidhjet, në drejtim të dhe nga pajisjet tuaja, janë të lidhura siç duhet.
- Nëse marrja vetëm të një kanal është e dobët, sintonizojeni kanalit me **Analog: instalim manual**. (Vetëm për kanalet analoge)

- Kontrolloni nëse sinjali hyrës dixhital është mjaftueshëm i fuqishëm. Ndërsa shikoni një kanal dixhital, shtypni **OPSIONET** dhe zgjidhni **Statusi** dhe shtypni OK. Kontrolloni **Fuqia e sinjalit dhe Cilësia e sinjalit**.

Figurë e dobët nga një pajisje

- Sigurohuni që pajisja është lidhur siç duhet. Sigurohuni që cilësimi i videos dalëse të pajisjes të jetë në rezolucionin më të lartë të mundshëm, nëse është e zbatueshme.
- Riktheni stilin e figurës ose kaloni në një stil tjetër.

Cilësimet e figurës ndryshojnë pas pak

Sigurohuni që **Vendndodhja** të jetë caktuar te **Shtëpi**. Në këtë modalitet mund të ndryshoni dhe të

ruani cilësimet.

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Vendndodhja

Shfaqet një shirit

Nëse shfaqet herë pas here një shirit promocioni ose **Stili i figurës** kthehet automatikisht në **I ndezur gjatë ndezjes**, televizori është në vendndodhjen **Dyqan**. Caktoni vendndodhjen e televizorit në **Kreu** për përdorim në shtëpi.

🏠 (Kreu) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Vendndodhja

Figura nuk përshtatet me ekranin / Përmasë e gabuar ose e paqëndrueshme e figurës / Pozicioni i figurës është i pasaktë

- Nëse përmasat e figurës - formati i kuadrit - nuk përshtatet me ekranin, dhe në pjesën e sipërme e të poshtme ose majtas dhe djathtas ekranit shfaqen shiritat të zinj, shtypni **🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Format i figurës > Mbush ekranin**.
- Nëse përmasat e figurës ndryshojnë vazhdimisht, shtypni **🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Format i figurës > Përshtat sipas ekranit**.
- Nëse figura është në pozicion të pasaktë në ekran, provoni të kontrolloni rezolucionin e sinjalit dhe llojin e daljes së pajisjes së lidhur, shtypni **🏠 (Kreu) > Cilësimet > Figura > Format i figurës > Origjinal**.

Figura e kompjuterit nuk është e qëndrueshme

Sigurohuni që kompjuteri përdor shpejtësinë e freskimit dhe rezolucionin që mbështet.

21.7. Tingulli

Nuk ka zë ose zëri ka cilësi të dobët

- Kontrolloni nëse cilësimet e zërit të televizorit janë në rregull duke shtypur tastin **🔊** e volumit ose **🔇** të heqjes së zërit.
- Nëse përdorni një marrës dixhital (dekodues), kontrolloni që volumi në këtë marrës të mos jetë caktuar në 0 ose pa zë.
- Kontrolloni që televizori - sinjali zanor - të jetë i lidhur siç duhet me sistemin e kinemasë, nëse përdorni një sistem të tillë për zërin e televizorit. Kontrolloni nëse e keni lidhur kabllon HDMI me një **lidhje HDMI ARC/eARC** në sistemin e kinemasë në shtëpi.
- Sigurohuni që dalja e zërit e televizorit të jetë lidhur me hyrjen e zërit në sistemin e kinemasë. Tingulli duhet të dëgjohet nga altoparlantët e HTS (Sistemi i kinemasë në shtëpi).

Zë me zhurmë të lartë

Nëse shikoni video nga kompjuteri ose njësia e lidhur "Flash USB", zëri nga sistemi i kinemasë mund të dalë

i deformuar. Kjo zhurmë dëgjohe kur skedari audio ose video ka zë DTS, por sistemi i kinemasë nuk ka procesim zëri DTS. Këtë cilësim mund ta rregulloni duke caktuar opsionin **Formati i daljes dixhitale të televizorit të Stereo**.

Shtypni **▲ (Kreu) > Cilësimet > Tingulli > I avancuar > Formatit i daljes dixhitale**

21.8. HDMI

HDMI

- Vini re se mbështetja HDCP (mbrojtja e materialeve dixhitale të shpejtësisë së lartë) mund ta zgjasë kohën që i duhet televizorit për shfaqjen e materialit nga pajisja HDMI.

- Nëse televizori nuk e njeh pajisjen HDMI dhe nuk shfaq figurë, kalojeni burimin nga pajisja aktuale te një tjetër dhe kthejeni sërish te pajisja e parë.

- Nëse zëri ndërpritet herë pas here, sigurohuni që cilësimet e daljes nga pajisja HDMI të jenë të sakta.

HDMI "EasyLink" nuk funksionon

- Kontrolloni që pajisjet HDMI mbështesin "HDMI-CEC". Veçoritë e EasyLink funksionojnë vetëm me pajisjet që mbështesin HDMI-CEC.

Nuk shfaqet ikona e volumit

- Kjo është diçka normale kur lidhet një pajisje audio "HDMI-CEC" dhe përdorni telekomandën e televizorit për të rregulluar nivelin e volumit nga pajisja.

21.9. USB

Nuk shfaqen foto, video dhe muzika nga pajisja USB

- Kontrolloni nëse pajisja ruajtëse USB caktohet në përputhje me kategorinë e ruajtjes masive, siç përshkruhet në dokumentet e pajisjes ruajtëse.

- Kontrolloni nëse pajisja ruajtëse USB përputhet me televizorin.

- Kontrolloni nëse formatet e skedarëve të audios dhe të videos mbështeten nga televizori. Për më shumë informacion, kontrolloni te **Ndihma > Manuali i përdorimit > Specifikimet > Multimedia**.

Luajtje me ndërprerje e skedarëve USB

- Performanca e transferimit e pajisjes ruajtëse USB mund ta kufizojë shpejtësinë e transferimit të të dhënave te televizori gjë që shkakton luajtje jo të mirë.

21.10. Wi-Fi dhe Internet

Rrjeti "Wi-Fi" nuk u gjet ose sinjali është i çrregullt

- Kontrolloni nëse muret mbrojtëse në rrjetin tuaj lejojnë përdorimin e lidhjes me valë të televizorit.
- Nëse rrjeti me valë nuk funksionon siç duhet në shtëpinë tuaj, provoni instalimin e rrjetit me tela.

Interneti nuk funksionon

- Nëse lidhja me rrugëzuesin është në rregull, kontrolloni lidhjen e rrugëzuesit me internetin.

Lidhja e kompjuterit me internetin është e ngadaltë

- Shikoni manualin e përdorimit të rrugëzuesit me valë për informacion mbi rrezën në mjedisin brenda, shpejtësinë e transferimit dhe faktorë të tjerë të cilësisë së sinjalit.

- Për rrugëzuesin përdorni lidhje të shpejtësisë së lartë (brezgjërë) me internetin.

DHCP

- Nëse lidhja nuk kryhet, mund të kontrolloni konfigurimin e DHCP (protokolli dinamik i konfigurimit të hostit) të rrugëzuesit. DHCP duhet të jetë aktive.

21.11. Gjuhë e gabuar e menysë

Ktheni gjuhën në gjuhën tuaj

1 - Shtypni **▲ Kreu** dhe zgjidhni **Cilësimet** nëpërmjet ikonës në këndin e sipërm djathtas.

2 - Shtypni 9 herë **▼** (djathtas) dhe shtypni **OK**.

3 - Shtypni përsëri **OK** për të vendosur **Gjuha**, zgjidhni elementin e parë **Gjuha e menysë** dhe shtypni **OK**.

4 - Zgjidhni gjuhën dhe shtypni **OK**.

22. Siguria dhe kujdesi

22.1. Siguria

E rëndësishme

Përpara përdorimit të televizorit, lexoni dhe kuptoni të gjitha udhëzimet mbi sigurinë. Garancia nuk vlen nëse ndodhin dëme nga mosndjekja e udhëzimeve.

Rreziku i goditjes elektrike ose zjarrit

- Asnjëherë mos e ekspozoni televizorin ose telekomandën ndaj shiut ose ujit. Asnjëherë mos vendosni enë të lëngshme, të tilla si vazo, pranë televizorit ose telekomandës.
- Nëse lëngjet derdhen në ose në televizor, shkëputeni televizorin menjëherë nga priza.
- Kontaktoni Philips TV Consumer Care për të kontrolluar televizorin përpara përdorimit.
- Mos i ekspozoni asnjëherë televizorin, telekomandën apo bateritë ndaj nxehtësisë së lartë.
- Mos i vendosni asnjëherë pranë qirinjve të ndezur, flakës ose burimeve të tjera të nxehtësisë, duke përfshirë dhe dritën e drejtpërdrejtë të diellit.
- Mos futni asnjëherë objekte në vrimat e ajrimit ose në vrima të tjera në televizor.
- Mos vendosni asnjëherë objekte të rënda mbi kordonin elektrik.
- Shmangni ushtrimin e forcës mbi spinat elektrike. Spinat e liruara mund të shkaktojnë shkëndija ose zjarr. Sigurohuni që mbi kordonin elektrik nuk ushtrohet presion kur rrotulloni ekranin e televizorit.
- Për ta shkëputur televizorin nga rrjeti elektrik, spina e televizorit duhet të jetë e shkëputur. Kur e hiqni nga priza, tërhiqni gjithmonë spinën dhe asnjëherë kordonin. Sigurohuni që të mund ta arrini gjithmonë spinën, kordonin elektrik dhe prizën.

Rreziku i lëndimit të personave ose i dëmtimit të televizorit

- Nevojiten dy persona për ta ngritur dhe lëvizur televizorin që peshon më shumë se 25 kg (ose 55 lbs).
- Nëse televizori montohet në bazament, përdorni vetëm bazamentin e dhënë. Sigurojeni mirë bazamentin në televizor.
- Vendoseni televizorin mbi një sipërfaqe të sheshtë e të niveluar që mund të mbajë peshën e përbashkët të televizorit dhe të bazamentit.
- Kur e montoni në mur, sigurohuni që ky montim e mban peshën e televizorit. TP Vision nuk mban

përgjegjësi për montimin e pasaktë në mur që mund të shkaktojë aksident, lëndim ose dëmtim.

- Disa pjesë të këtij produkti janë prej xhami. Lëvizeni me kujdes për të shmangur lëndimin ose dëmtimin.

Rreziku i dëmtimit të televizorit!

Përpara se ta futni televizorin në prizë, sigurohuni që voltazhi i korrentit të përputhet me vlerën e stampuar në pjesën e pasme të televizorit. Mos e futni asnjëherë televizorin në prizë nëse kanë voltazh të ndryshëm.

Rreziqet e qëndrueshmërisë

Ky produkt është projektuar dhe synohet për përdorim personal dhe konsumatori në një mjedis të brendshëm shtëpiak, përveç rastit kur bihet dakord ndryshe me shkrim me prodhuesin. Mosndjekja këtij rekomandimi ose e udhëzimeve të ofruara në manualin e përdorimit të produktit dhe dokumentacionin mbështetës të produktit mund të shkaktojë dëmtim të produktit dhe ta bëjë garancinë të pavlefshme.

Televizori mund të rrëzohet duke shkaktuar lëndime të personale ose vdekje. Shumë lëndime, veçanërisht ndaj fëmijëve, mund të shmangen duke marrë masa paraprake të thjeshta si p.sh.:

- GJITHMONË sigurohuni që televizori nuk zgjatet jashtë buzës së mobilies ku mbështetet.
- Përdorni GJITHMONË dollapë, bazamente ose metoda montimi të rekomanduara nga prodhuesi i televizorit.
- Përdorni GJITHMONË mobilie që mund të mbështesin me siguri televizorin.
- Mësojini GJITHMONË fëmijët për rreziqet e hipjes mbi mobilie për të arritur tek televizori ose komandat e tij.
- Pozicionojini GJITHMONË kordonët dhe kabllot e lidhur me televizorin në mënyrë që të mos pengoheni, të mos tërhiqen apo të kapen.
- Mos e vendosni ASNJËHERË televizorin në një vend të paqëndrueshëm.
- Mos e vendosni ASNJËHERË televizorin mbi mobilie të larta (për shembull, mbi bufe ose rafta librash) pa i fiksuar të dyja në mur ose në një mbështetëse të përshtatshme.
- Mos e vendosni ASNJËHERË televizorin mbi pëlhurë ose materiale të tjera që mund të ndodhen ndërmjet televizorit dhe mobilies mbështetëse.
- Mos vendosni ANSJËHERË artikuj që mund të nxisin fëmijët të ngjiten, si p.sh. lodra dhe telekomanda, mbi televizor ose mbi mobilet ku është vendosur televizori.

Nëse televizori ekzistues do të ruhet ose zhvendoset, duhet të merren parasysh të njëjtët faktorë si më sipër.

Rreziku i baterive

- Mos e gëlltit baterinë. Ka rrezik për djegie kimike.
- Telekomanda mund të ketë bateri si petë/në formë monedhe. Nëse ajo gëlltitet, mund të shkaktojë djegie të brendshme të rënda në vetëm 2 orë dhe mund të rezultojë në vdekje të personit.
- Mbajni bateritë e reja dhe të përdorura larg nga fëmijët.
- Nëse dhomëza e baterisë nuk mbyllet në mënyrë të sigurt, ndalo përdorimin e produktit dhe mbaje larg nga fëmijët.
- Nëse mendon se bateritë mund të jenë gëlltitur ose futur në brendësi të ndonjë pjese të trupit, kërko menjëherë kujdes mjekësor.
- Rrezik shpërthimi ose zjarri nëse bateria zëvendësohet me një lloj të pasaktë.
- Zëvendësimi i baterisë me një lloj të pasaktë mund të zhvlerësojë një masë mbrojtëse (për shembull, në rastin e disa llojeve të baterive me litium).
- Hedhja e një baterie në zjarr ose në një sobë të nxehtë apo shtypja dhe prerja mekanike e një baterie, gjë e cila mund të rezultojë në shpërthim.
- Lënia e baterisë në një ambient rrethues me temperaturë jashtëzakonisht të lartë, e cila mund të rezultojë në shpërthim ose rrjedhje të lëngut ose gazit të ndezshëm.
- Bateria e ekspozuar ndaj presionit jashtëzakonisht të ulët të ajrit, e cila mund të rezultojë në shpërthim ose rrjedhje të lëngut ose gazit të ndezshëm.

Rreziku i mbinxehjes

Mos e instaloni asnjëherë televizorin në hapësirë të mbyllur. Lini gjithmonë një hapësirë të paktën 20 cm ose 8 inç rreth televizorit për ajrim. Sigurohuni që perdet, ose sende të tjera, të mos i mbulojnë kurrë vrimat e ajrimit të televizorit.

Stuhitë me vetëtima

Shkëputeni televizorin nga priza dhe antena përpara stuhive me vetëtima.

Gjatë stuhive me vetëtima, mos prekni kurrë asnjë pjesë të televizorit, kordonit elektrik ose kabllos së antenës.

Rreziku i dëmtimit të dëgjimit

Evitoni përdorimin e kufjeve me volum të lartë ose për periudha të zgjatura kohore.

Temperaturat e ulëta

Nëse televizori transportohet në temperatura nën 5°C (ose 41°F), shpaketojeni dhe prisni derisa temperatura e tij të përkojë me temperaturën e dhomës pastaj vendoseni në prizë.

Lagështia

Në raste të rralla, në varësi të temperaturës dhe të lagështisë, mund të ketë kondensim të lehtë në pjesën e brendshme të xhamit të përparmë (në disa modele të televizorit). Për ta parandaluar këtë, mos e ekspozoni televizorin ndaj dritës së drejtpërdrejtë të diellit, nxehtësisë ose lagështisë së tepërt. Nëse ndodh kondensim, do të zhduket vetë pas pak orësh pune të televizorit.

Lagështia nga kondensimi nuk e dëmton televizorin dhe nuk shkakton keqfunksionim.

22.2. Kujdesi për ekranin

Pastrimi

- Mos e prekni, shtyni, fshini ose godisni ekranin me objekte.
- Hiqeni televizorin nga priza përpara se ta pastroni.
- Pastrojeni televizorin dhe kornizën e tij me një leckë të butë e të lagur dhe fshijeni lehtë. Mos përdorni asnjëherë substanca si alkooli, kimikatet ose solucionet pastruese për shtëpinë.
- Për të shmangur deformimet dhe zbehjen e ngjyrës, fshijini pikat e ujit sa më shpejt të jetë e mundur.
- Shmangini figurat statike sa më shumë të jetë e mundur. Figurat statike janë figura që mbeten në ekran për periudha të gjata. Ato përfshijnë menyte në ekran, shiritat e zinj, ekranet e orës etj. Nëse ju duhet të përdorni figura statike, reduktoni kontrastin dhe ndriçimin e ekranit për të shmangur dëmtimin e tij.

23. Kushtet e përdorimit

2026 © TP Vision Europe B.V. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Ky produkt ka ardhur në treg nga "TP Vision Europe B.V," ose një nga filialet e saj, të përmendura në vijim si "TP Vision", i cili është prodhuesi i produktit. "TP Vision" është garant në lidhje me televizorin që vjen me këtë broshurë. "Philips" dhe emblema në formë mburoje e "Philips" janë marka të regjistruara tregtare të "Koninklijke Philips N.V."

Specifikimet mund të ndryshojnë pa njoftim. Markat tregtare janë pronë e Koninklijke Philips N.V ose të pronarëve përkatës. "TP Vision" ruan të drejtën e ndryshimit të produkteve në çdo kohë, pa qenë e detyruar të përshtatë furnizimet e mëparshme sipas këtyre ndryshimeve.

Materiali i shkruar që vjen i pakeluar me televizorin dhe manuali i ruajtur në memorien e televizorit ose i shkarkuar nga faqja e "Philips" në internet www.philips.com/tvsupport konsiderohen të përshtatshëm për përdorimin e synuar të sistemit.

Materiali në këtë manual konsiderohet i përshtatshëm për përdorimin e synuar të sistemit. Nëse produkti ose komponentët e tij apo procedurat e veçanta përdoren për qëllime të ndryshme nga ato të specifikuara në këtë dokument, duhet të merret konfirmimi për vlefshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tyre. TP Vision garanton se vetë materiali nuk shkel asnjë nga patentat e Shteteve të Bashkuara. Nuk jepet asnjë garanci e mëtejshme, e shprehur apo e nënkuptuar. TP Vision nuk mban përgjegjësi për ndonjë gabim në përmbajtjen e këtij dokumenti dhe as për ndonjë problem që vjen si rrjedhojë e përmbajtjes në këtë dokument. Gabimet që raportohen te Philips do të përshtaten dhe do të publikohen sa më shpejt të jetë e mundur në faqen e mbështetjes në internet të Philips.

Kushtet e garancisë – Rrezik lëndimi, dëmtim i televizorit ose zhvlerësim i garancisë!

Mos tentoni kurrë ta rregulloni vetë televizorin. Përdoreni televizorin dhe aksesoret vetëm siç është synuar nga prodhuesi. Shenja e kujdesit e printuar në pjesën e pasme të televizorit tregon rrezik goditjeje elektrike. Mos e hiqni kurrë kapakun e televizorit. Për shërbime ose riparime, kontaktoni gjithmonë qendrën e kujdesit ndaj klientit për televizorë Philips. Numrin e telefonit e gjeni te dokumentet e printuara që jepen me televizorin. Ose konsultohuni me faqen tonë të internetit www.philips.com/tvsupport dhe zgjidhni shtetin ku ndodheni nëse nevojitet. Veprimet e ndaluara shprehimisht në këtë manual ose rregullimet

dhe procedurat e montimit që nuk rekomandohen ose nuk autorizohen në këtë manual e bëjnë garancinë të pavlefshme.

Karakteristikat e pikselëve

Ky produkt televizori ka një numër të madh pikselësh me ngjyra. Megjithëse ka piksela efikase në shkallën 99.999% e lart, në ekran mund të shfaqen vazhdimisht pika të zeza ose pika të shndritshme (të kuqe, të gjelbra ose blu). Kjo është veçori strukturore e ekranit (brenda standardeve të zakonshme industriale) dhe jo keqfunksionim. Për rrjedhojë, mbani parasysh se kjo nuk është objekt i riparimit, ndërrimit ose rimbursimit brenda dhe/ose jashtë periudhës së garancisë.

Karakteristikat e dritës së pasme

Të gjithë televizorët Philips kanë kaluar përmes kontrolleve dhe testeve të rrepta përpara dërgimit te ju. Ju sigurojmë se ne i kushtojmë rëndësinë më të madhe cilësisë së televizorëve tanë, në mënyrë që të mos përballeni me ndonjë pakënaqësi në shikim teksa shikoni në televizorin tuaj. Megjithatë, ju lutemi të mbani parasysh se rrjedhja e dritës së pasme ("efekti Mura") dhe/ose pabarazia e dritës në sfond e cila mund të vihet re vetëm tek imazhet e errëta ose vetëm në një dhomë pa dritë dhe shumë të errët, konsiderohet se është brenda specifikimeve të televizorit. Këto raste nuk tregojnë një përkeqësim dhe as nuk konsiderohen si defekt i televizorit. Si rezultat, na vjen keq t'ju informojmë që pretendimet e kësaj natyre për garancinë, shërbimin pa pagesë, ndërrimin ose rimbursimin nuk mund të pranohen brenda periudhës së garancisë dhe/ose jashtë saj.

Pajtueshmëria me CE

Me anë të këtij dokumenti, "TP Vision Europe B.V." deklaron se ky televizor është në përputhje me kërkesat themelore dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivave 2014/53/BE (RED), 2011/65/BE (RoHS), 2019/882 (EAA) dhe ESPR Regulation (BE) 2024/1781 (Rregullorja (BE) 2019/2021).

Pajtueshmëria me UKCA

Nëpërmjet këtij dokumenti, TP Vision Europe B.V. deklaron se ky televizor është në përputhje me kërkesat themelore dhe dispozitat e tjera përkatëse të Rregulloreve "Për pajisjet radio" 2017, Rregulloren "Për ekodizajnin e produkteve në lidhje me energjinë dhe informacionin për energjinë" (Ndryshim) (Dalja nga BE) 2019 dhe Rregulloren "Për kufizimin e përdorimit të disa substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike" 2012.

Pajtueshmëria me EMF-në

TP Vision prodhon dhe shet shumë produkte të synuara për konsumatorët, të cilat në përgjithësi, si çdo aparat elektronik, mund të lëshojnë dhe të marrin sinjale elektromagnetike. Një nga parimet kryesore të punës së "TP Vision" është marrja e të gjitha masave të nevojshme të shëndetit e sigurisë për produktet, në pajtim me të gjitha kërkesat përkatëse ligjore dhe për

të qenë brenda standardeve për fushat elektromagnetike (EMF), që janë në fuqi në kohën e prodhimit të produkteve.

"TP Vision" i përkushtohet zhvillimit, prodhimit dhe tregtimit të produkteve që nuk kanë pasoja negative mbi shëndetin. TP Vision konfirmon që, nëse produktet e tij përdoren sipas përdorimit të tyre të synuar, ato janë të sigurta për përdorim në përputhje me provat shkencore që ofrohen në ditët e sotme. "TP Vision" luan një rol aktiv në krijimin e standardeve ndërkombëtare të sigurisë dhe për fushat elektromagnetike, duke bërë kështu të mundur parashikimin e zhvillimeve të mëtejshme në standardizimin për aplikimin e hershëm në produkte.

24. Të drejtat e autorit

24.1. HDMI

Termet "HDMI", "HDMI High-Definition Multimedia Interface", veshja e HDMI dhe logoja HDMI janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të "HDMI Licensing Administrator, Inc."



24.2. HEVC Advance

Mbulohet nga një ose më shumë pretendime të patentave HEVC të listuara në patentlist.accessadvance.com.
Garanci për të ardhmen me dekodim të avancuar HEVC.



24.3. Dolby Audio

Prodhuar me licencë nga Dolby Laboratories. Dolby, Dolby Audio dhe simboli me dy "D" janë marka të regjistruara tregtare të Dolby Laboratories Licensing Corporation.



24.4. Wi-Fi Alliance

Logoja e "Wi-Fi CERTIFIED™" është markë tregtare e regjistruar e "Wi-Fi Alliance®".



24.5. Markat e tjera tregtare

Të gjitha markat e tjera tregtare të regjistruara dhe të paregjistruara janë pronë e zotëruesve përkatës.

25. Burim i hapur

25.1. Softueri me burim të hapur

Ky televizor përmban softuer me burim të hapur. Nëpërmjet kësaj, "TP Vision Europe B.V." ofron dërgimin, pas kërkesë, të një kopjeje të plotë të kodit përkatës burimor për paketat e softuerëve me burim të hapur, të cilat mbrohen nga e drejta e autorit dhe përdoren në këtë produkt për të cilin oferta kërkohet nga licencat përkatëse.

Kjo ofertë vlen deri në tre vite pas blerjes së produktit për këdo pas marrjes së këtij informacioni.

Për të marrë kodin burimor, shkruani në anglisht në . . .

open.source@tpv-tech.com

25.2. Licenca e burimit të hapur

Rreth licencës së burimit të hapur

README (skedari informues) për kodin burimor të pjesëve të TP Vision Europe B.V. TV që përfshihen në licencat e burimit të hapur.

Ky është një dokument që përshkruan shpërndarjen e kodit burimor të përdorur te TP Vision Europe B.V. TV, që përfshihet në General Public Licence GNU ose Lesser General Public Licence (LGPL), ose në çdo licencë tjetër burimi të hapur. Udhëzimet mbi marrjen e kopjeve të këtij softueri mund t'i gjeni tek "Udhëzime për përdorimin".

"TP Vision Europe B.V." NUK JEP ASNJË GARANCI, TË SHPREHUR APO TË NËNKUPTUAR, DUKE PËRFSHIRË GARANCITË E TREGTUESHMËRISË APO TË PËRSHTATSHMËRISË PËR NJË QËLLIM TË CAKTUAR, NË LIDHJE ME KËTË SOFTUER. TP Vision Europe B.V. nuk ofron mbështetje për këtë softuer. Për sa më lart nuk ju prekin garancitë dhe të drejtat juridike në lidhje me produktet e blera nga "TP Vision Europe B.V." Kjo vlen vetëm për kodin burimor që ju është vënë në dispozicion.

Open Source

apr (1.7.0)

The Apache Portable Runtime Library provides a predictable and consistent interface to underlying platform-specific implementations, with an API to which software developers may code and be assured of predictable if not identical behavior regardless of the platform on which their software is built, relieving them of the need to code special-case conditions to work around or take advantage of platform-specific deficiencies or features.

Source: <https://github.com/apache/apr>

bind (9.11.36)

BIND (Berkeley Internet Name Domain) is a complete, highly portable implementation of the Domain Name System (DNS) protocol.

Source: <https://github.com/isc-projects/bind9>

busybox (1.31.1)

BusyBox combines tiny versions of many common UNIX utilities into a single small executable. It provides replacements for most of the utilities you usually find in GNU fileutils, shellutils, etc. The utilities in BusyBox generally have fewer options than their full-featured GNU cousins; however, the options that are included provide the expected functionality and behave very much like their GNU counterparts. BusyBox provides a fairly complete environment for any small or embedded system.

Source: <https://www.busybox.net/downloads/>

binutils (2.31.510)

The GNU Binutils are a collection of binary tools. The main ones are:

ld - the GNU linker.

as - the GNU assembler.

Source: <https://www.gnu.org/software/binutils/>

bzip2 (1.0.6)

bzip2 is a free and open-source file compression program that uses the Burrows–Wheeler algorithm. It only compresses single files and is not a file archiver. It was developed by Julian Seward, and maintained by Mark Wielaard and Micah Snyder.

Source: <https://sourceware.org/bzip2/>

c-ares (1.10.1)

c-ares is a C library for asynchronous DNS requests (including name resolves)

Source: <https://c-ares.org/>

cario (1.16.0)

Cairo is a 2D graphics library with support for multiple

output devices. Currently supported output targets include the X Window System (via both Xlib and XCB), Quartz, Win32, image buffers, PostScript, PDF, and SVG file output. Experimental backends include OpenGL, BeOS, OS/2, and DirectFB.
source <https://www.cairographics.org/>

dbus (1.11.2)

D-Bus is a simple system for interprocess communication and coordination.

The "and coordination" part is important; D-Bus provides a bus daemon that does things like:

- notify applications when other apps exit
- start services on demand
- support single-instance applications

Source: <https://github.com/freedesktop/dbus>

e2fsprogs (1.43.3)

e2fsprogs (sometimes called the e2fs programs) is a set of utilities for maintaining the ext2, ext3 and ext4 file systems. Since those file systems are often the default for Linux distributions, it is commonly considered to be essential software

Source: <http://e2fsprogs.sourceforge.net/>

expat (2.2.9)

xml parser; Expat is an XML parser library written in C. It is a stream-oriented parser in which an application registers handlers for things the parser might find in the XML document (like start tags). An introductory article on using.

This piece of software is made available under the terms and conditions of the Expat license, which can be found below.

Source: <http://expat.sourceforge.net/>

fuse (2.9.7)

JBoss Fuse is an open source ESB with capabilities based on Apache Camel, Apache CXF, Apache ActiveMQ, Apache Karaf and Fabric8 in a single integrated distribution.

Source <https://github.com/jboss-fuse/fuse>

gdb (8.2.1)

GDB, the GNU Project debugger, allows you to see what is going on 'inside' another program while it executes -- or what another program was doing at the moment it crashed.

Source: <https://www.sourceware.org/gdb/>

glibc (2.30.0)

Any Unix-like operating system needs a C library: the library which defines the "system calls" and other basic facilities such as open, malloc, printf, exit...The GNU C library is used as the C library in the GNU system and most systems with the Linux kernel
This piece of software is made available under the terms and conditions of the glibc license, which can be found below.

Source: <http://www.gnu.org/software/libc/>

gstreamer (1.18.3)

The GStreamer team is excited to announce a new major feature release of your favourite cross-platform multimedia framework!

Source: <https://gstreamer.freedesktop.org/>

libasound (1.1.8)

The Advanced Linux Sound Architecture (ALSA) provides audio and MIDI functionality to the Linux operating system. ALSA has the following significant features:

Efficient support for all types of audio interfaces, from consumer sound cards to professional multichannel audio interfaces.

Fully modularized sound drivers.

SMP and thread-safe design (PLEASE READ THIS).

User space library (alsa-lib) to simplify application programming and provide higher level functionality.

Support for the older Open Sound System (OSS) API, providing binary compatibility for most OSS programs.

Source: https://www.alsa-project.org/wiki/Main_Page

Libcurl (7.79.1)

HTTP client;libcurl is a free and easy-to-use client-side URL transfer library, supporting FTP, FTPS, HTTP, HTTPS, SCP, SFTP, TFTP, TELNET, DICT, LDAP, LDAPS, FILE, IMAP, SMTP, POP3 and RTSP. libcurl supports SSL certificates, HTTP POST, HTTP PUT, FTP uploading, HTTP form based upload, proxies, cookies, user+password authentication (Basic, Digest, NTLM, Negotiate, Kerberos4), file transfer resume, http proxy tunneling and more!

This piece of software is made available under the terms and conditions of the Libcurl license, which can be found below.

Source: <http://curl.haxx.se/>

libevent (1.4.13)

The libevent API provides a mechanism to execute a callback function when a specific event occurs on a file descriptor or after a timeout has been reached.

Furthermore, libevent also support callbacks due to signals or regular timeouts.

source: <https://libevent.org/>

libjpeg-turbo (2.1.1)

libjpeg-turbo is a JPEG image codec that uses SIMD instructions (MMX, SSE2, AVX2, Neon, AltiVec) to accelerate baseline JPEG compression and decompression on x86, x86-64, Arm, and PowerPC systems, as well as progressive JPEG compression on x86 and x86-64 systems. On such systems, libjpeg-turbo is generally 2-6x as fast as libjpeg, all else being equal. On other types of systems, libjpeg-turbo can still outperform libjpeg by a significant amount, by virtue of its highly-optimized Huffman coding routines. In many cases, the performance of libjpeg-turbo rivals that of proprietary high-speed JPEG codecs.

Source: <https://libjpeg-turbo.org/>

libjpeg (6b)

This library is used to perform JPEG decoding tasks. This piece of software is made available under the terms and conditions of the libjpeg license, which can be found below.

Source: <http://www.ijg.org/>

libpng (1.0.1)

libpng -THE reference library for reading, displaying, writing and examining png Image Network Graphics. This piece of software is made available under the terms and conditions of the libpng license, which can be found below.

Source: <http://sourceforge.net/projects/libpng/files/>

libffi (3.2.1)

Compilers for high level languages generate code that follows certain conventions. These conventions are necessary, in part, for separate compilation to work. One such convention is the "calling convention". The "calling convention" is a set of assumptions made by the compiler about where function arguments will be found on entry to a function. A "calling convention" also specifies where the return value for a function is found.

Source: <https://sourceware.org/libffi/>

libjansson (2.13.1)

Jansson is a C library for encoding, decoding and manipulating JSON data. Its main features and design principles are:

Simple and intuitive API and data model

Comprehensive documentation

No dependencies on other libraries

Full Unicode support (UTF-8)

Extensive test suite

Source: <https://github.com/akheron/jansson>

libmicrohttpd (0.9.73)

GNU libmicrohttpd is a small C library that is supposed to make it easy to run an HTTP server as part of another application. GNU Libmicrohttpd is free software and part of the GNU project

Source: <https://www.gnu.org/software/libmicrohttpd/>

libupnp (1.6.10)

The portable SDK for UPnP™ Devices (libupnp) provides developers with an API and open source code for building control points, devices, and bridges that are compliant with Version 1.0 of the Universal Plug and Play Device Architecture Specification and support several operating systems like Linux, *BSD, Solaris and others.

Source: <https://pupnp.sourceforge.io/>

libuuid (1.3.0)

This library is free software; you can redistribute it and/or

modify it under the terms of the Modified BSD License.

The complete text of the license is available at the Documentation/licenses/COPYING.BSD-3 file

Source: <https://sourceforge.net/projects/libuuid/>

Libxml2 (2.9.12)

The "libxml2" library is used in AstroTV as a support for the execution of NCL application. This library was developed for the GNOME software suite and is available under a "MIT" license.

Source: <http://www.xmlsoft.org>

linux_kernel (4.19)

The Linux kernel is a mostly free and open-source,[11] monolithic, modular, multitasking, Unix-like operating system kernel. It was originally authored in 1991 by Linus Torvalds for his i386-based PC, and it was soon adopted as the kernel for the GNU operating system, which was written to be a free (libre) replacement for UNIX.

Source: <https://www.kernel.org/>

mbed TLS (2.26.0)

Mbed TLS is a C library that implements cryptographic primitives, X.509 certificate manipulation and the SSL/TLS and DTLS protocols. Its small code footprint makes it suitable for embedded systems.

Source: <https://github.com/ARMmbed/mbedtls>

ncurses (6.1)

The ncurses (new curses) library is a free software emulation of curses in System V Release 4.0 (SVr4), and more. It uses terminfo format, supports pads and color and multiple highlights and forms characters and function-key mapping, and has all the other SVr4-curses enhancements over BSD curses. SVr4 curses is better known today as X/Open Curses.

Source: <http://www.gnu.org/software/ncurses/>

nghttp2 (1.6.3)

nghttp2 is an implementation of HTTP/2 and its header compression algorithm HPACK in C

Source: <https://nghttp2.org/>

NTFS-3G (7.8)

NTFS-3G is an open source cross-platform implementation of the Microsoft Windows NTFS file system with read-write support. NTFS-3G often uses the FUSE file system interface, so it can run unmodified on many different operating systems. It is runnable on Linux, FreeBSD, NetBSD, OpenSolaris, BeOS, QNX, WinCE, Nucleus, VxWorks, Haiku, MorphOS, and Mac OS X It is licensed under either the GNU General Public License or a proprietary license. It is a partial fork of ntfsprogs and is under active maintenance and development.

This piece of software is made available under the terms and conditions of the NTFS-3G Read/Write

Driver license, which can be found below.

Source: <http://www.tuxera.com>

openssl (1.1.1l)

OpenSSL is an open source implementation of the SSL and TLS protocols. The core library (written in the C programming language) implements the basic cryptographic functions and provides various utility functions. Wrappers allowing the use of the OpenSSL library in a variety of computer languages are available.

Source: <http://www.openssl.org/>

pcre (8.45)

The PCRE library is a set of functions that implement regular expression pattern matching using the same syntax and semantics as Perl 5. PCRE has its own native API, as well as a set of wrapper functions that correspond to the POSIX regular expression API. The PCRE library is free, even for building proprietary software.

<https://www.pcre.org/>

procps (ps, top) (3.3.15)

procps is the package that has a bunch of small useful utilities that give information about processes using the /proc filesystem.

The package includes the programs ps, top, vmstat, w, kill, free, slabtop, and skill.

Source: <http://procps.sourceforge.net/index.html>

SQLite3 (3.36.0)

SQLite is a in-process library that implements a self-contained, serverless, zero-configuration, transactional SQL database engine.

This piece of software is made available under the terms and conditions of the SQLite3 license, which can be found below.

Source: <http://www.sqlite.org/>

util-linux-ng (2.35.2)

Various system utilities.

Source: <http://userweb.kernel.org/~kzak/util-linux-ng/>

wpa_supplicant (2.9)

wpa_supplicant is a WPA Supplicant for Linux, BSD, Mac OS X, and Windows with support for WPA and WPA2 (IEEE 802.11i / RSN). It is suitable for both desktop/laptop computers and embedded systems. Supplicant is the IEEE 802.1X/WPA component that is used in the client stations. It implements key negotiation with a WPA Authenticator and it controls the roaming and IEEE 802.11

authentication/association of the wlan driver.

Source: https://w1.fi/wpa_supplicant/

zlib (1.2.8)

The 'zlib' compression library provides in-memory compression and decompression functions, including

integrity checks of the uncompressed data.

This piece of software is made available under the terms and conditions of the zlib license, which can be found below.

Source: <http://www.zlib.net/>

26. Mohim në lidhje me shërbimet dhe/ose softuerët e ofruar nga palët e treta

Shërbimet dhe/ose softuerët e ofruar nga palët e treta mund të ndryshojnë, të pezullohen apo të ndërpriten pa njoftim paraprak. "TP Vision" nuk mban asnjë përgjegjësi për këto lloj situatash.

&		Formati i daljes dixhitale	36
"Ambilight"	37	Formati i figurës	34
A		Fotot, videot dhe muzika	28
Aksesi universal, Udhëzimi zanor	47	Fundi i përdorimit	58
Aksesi universal, Zmadhimi i tekstit	47	G	
Alexa	53	Gama	32
Altoparlantët e televizorit	36	Gamë e gjerë ngjyrash	33
Ambilight Suite	38	Gjuha e audios	45
Ambilight Suite, Gjumë	38	Gjuha e titrave	45
Ambilight Suite, Lindje dielli	39	Gjuhët e menysë	45
Ambilight Suite, Sallon	38	Google Assistant	55
Aplikacioni "Moments"	30	Guida televizive	27
Aplikacioni Philips Smart TV	13	H	
Asistenca	47	HbbTV	22
Asistenca, efektet zanore	47	HDMI - ARC	13
Asistenca, ligjërimi	47	HDMI - CEC	43
Asistenca, për vështirësi në dëgjim	47	I	
Asistenca, përshkrimi i audios	47	Identifikimi i televizorit	5
Asistenca, volumi i përzier	47	Informacionet e kontaktit	5
B		Informacioni i televizorit	5
Blokimi i aplikacioneve	45	Instalimi i kanalit - Antena	17
Blokimi për fëmijët	44	Instalimi i kanalit - Kabllori	17
Blokimi për fëmijët, caktimi i kodit	44	Instalimi i kanalit - Satelitor	19
Blokimi për fëmijët, ndryshimi i kodit	44	Instalo kanalën - Internet	21
C		IP statike	41
Cilësimet e avancuara të "Ambilight"	40	K	
Cilësimet e avancuara të zërit	36	Kanalet	17
Cilësimet e efektit HDR	33	Kanalet e preferuara	24
Cilësimet e mausit	42	Kanalet e preferuara, Krijimi	23
Cilësimet e përgjithshme	42	Kanalet e preferuara, Modifikimi	23
Cilësimet e privatësisë	41	Kanalet e preferuara, Varg kanalesh	24
Cilësimet e rrjetit	40	Kanalet e transmetimit	26
Cilësimet e ruajtësit të ekranit	43	Kanali, filtri i kanalit	23
Cilësimet e shpejta të figurës	34	Kanali, riemërtimi i kanalit	23
Cilësimet e shpeshta	31	Kartë CI	14
Cilësimet e tastierës USB	42	Klasifikimi prindëror	45
Cilësimet Eco	45	Koha	45
Cilësimet për "Netflix"	41	Kohëmatësi i gjumit	42
Cilësimet personale të zërit	34	Konfigurimi për dyqan	43
D		Kontrasti i sfondit	32
Dalja e zërit dixhital - Optike	13	Kontrasti i televizorit me Matter	42
Data	45	Kopjimi i listës së kanaleve	20
Diagnostikimi	61	Kufjet	36
Diagnostikimi i televizorit	5	Kujdesi për klientin	6
Drejtvendosja sipas pikës së bardhë	33	Kushtet e përdorimit	41
Dyqan	49	Kyçja e kanalit	24
E		L	
EasyLink 2.0	35	Lidhja e pajisjes	12
Ekrani fikur	42	Lidhja, Antena	12
Emri i rrjetit televiziv	41	Lidhja, HDMI	12
Etiketa evropiane e energjisë	58	Lidhja, Kordoni elektrik	10
F		Lidhja, Kufje	13
Figura, qartësia	33	Lidhja, satelitori	12
Fikja me orar	42	Lista e burimeve	16
Fonia HDMI	36	Lista e kanaleve	23
		M	

Manuali i përdorimit	5	Teksti	25
Marja	59	Telekomanda - Sensori infrakuq	8
Mbështetni ekipin tuaj	39	Teleteksti	25
Menyja "Cilësimet e rrjetit"	41	Temperatura e ngjyrës	33
Menyja "Ndihmë"	5	Tingulli, nivelimi automatik i zërit	36
Menyja e daljes dixhitale	36	Tingulli, volumi individual	36
Menyja e daljes së zërit	36	Transmetimi	13
Menyja e kontrastit të figurës	32		
Menyja e shpejtë	31	V	
Menyja e zërit	34	Vendndodhja	43
Merrni mbështetje	5	Vendosja televizive	36
Modaliteti i kontrastit të figurës	32	Versioni i softuerit	56
Modaliteti i orës automatike	45	Vetëdiagnostikim	5
		Vonesa e daljes dixhitale	36
N			
Ndezja/fikja dhe energjia	42	W	
Ndiz me LAN	41	Wi-Fi	41
Niveli i përforcimit dinamik	33		
Niveli i të zezës	33	Z	
Niveli i videos	32	Zhurma e figurës, Reduktimi i artefakteve	33
Nivelimi i daljes dixhitale	36	Zhurma e figurës, Reduktimi i zhurmës	33
Nuk ka kohëmatës të sinjalit	42	Zona kohore	45
O			
Opsionet e kanaleve	21		
Optimizimi i nivelit të dritës së ambientit	32		
Ora	45		
Ora verore	45		
P			
Përditësimi automatik i kanaleve	56		
Përditësimi i softuerit - Interneti	56		
Përditësimi i softuerit - Përditësimet lokale	56		
Përditësimi i softuerit - USB	56		
Përditëso softuerin	56		
Përmirësimi i dialogut	47		
Përmirësimi i kontrastit	33		
Personalizimi i Ambientlight	37		
Probleme	61		
R			
Regjistrimi i televizorit	5		
Riemërtimi apo zëvendësimi i ikonës së pajisjes	16		
Riparimi	6		
Riprodhimi dixhital i mediave - DMR	41		
Rivendosja e cilësimeve	44		
Rrjeti - Me valë	40		
S			
Shfaq historikun e përditësimeve të softuerit	57		
Shiko Cilësimet e rrjetit	41		
Shkyçja e kanalit	24		
Shmangja e daljes dixhitale	36		
Shtëpi ose dyqan	43		
Siguria dhe kujdesi	65		
Sjellja për të qëndruar ndezur	42		
Smart TV	49		
Spastrimi i memories së internetit	41		
Stilet e zërit	34		
Stili i Ambientlight	37		
Stili i figurës	32		
T			



All registered and unregistered trademarks are property of their respective owners.

Specifications are subject to change without notice.

Philips and the Philips' Shield Emblem are trademarks of Koninklijke Philips N.V. and are used under license from Koninklijke Philips N.V.

This product has been manufactured by and is sold under the responsibility of TP Vision Europe B.V., and TP Vision Europe B.V. is the warrantor in relation to this product.

2026© TP Vision Europe B.V. All rights reserved.

www.philips.com/welcome